

Heritage is our Brand



Ky botim realizohet në kuadër të projektit Heritage is Our Brand, që zbatohet nga DMO Albania (lider) & EU Policy Hub (partner)

Financuar nga: Bashkimi Evropian

Të gjitha të drejtat të rezervuara: DMO Albania

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbahen përgjegjës për to.

Website: www.albaniaheritage.com

Eva Kushova
Drejtuese e Projektit

Organizata DMO Albania në partneritet me EU Policy Hub, me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian, ideuan dhe zbatuan projektin “Heritage is our Brand” në një kohë shumë të ngutshme për vendin, kur vlerat e trashëgimisë kulturore identitare shqiptare po humbasin si rezultat i shumë faktorëve si: emigracioni masiv i tre dekadave të fundit; zhvillimi i teknologjisë dhe humbja e vlerës së leximit; mungesa e lidhjes dhe komunikimit mes brezave të vjetër dhe të rinj; mungesa e një arsimi cilësor në shkolla me fokus identitar: humbja e ndikimit të jetës komunitare etj. Ky projekt erdhi si urgjencë për të zgjuar sadopak krenarinë e të rinjve shqiptarë për trashëgiminë jomateriale që është përcjellë deri ditët tona nga paraardhësit tanë.

Për ne si ideatorë, nuk ishte thjesht një projekt, por një mision, jo vetëm për të promovuar disa nga vlerat autentike të shqiptarëve përmes tregimtarisë, por dhe për të nxitur kreativitetin tek artistët e rinj, për të sjellë produkte artistike bazuar në këto vlera.

Thelbi i projektit ishte grumbullimi dhe ritregimi i disa historive të trashëgimisë tonë nga mitologjia, antikiteti, rite e tradita, histori nga mesjeta dhe histori moderne. Një grup ekspertësh, të kontraktuar nga projekti, risolli disa nga historitë më të bukura të periudhave të ndryshme me një tregtimtari të thjeshtuar dhe artistike për gjithë komunitetin. Këto histori iu ofruan artistëve të rinj përmes një thirrjeje për grante të vogla, që t'i kthenin ato në produkte artistike bashkëkohore, si filma, animacione, novela grafike, dokumentarë, shfaqje artistike, instalacione, basorelieve etj.

Kështu ky botim nuk mbetet thjesht në biblioteka apo librari, por shndërrohet në të paktën 15 vepra arti, për t'i dhënë zë dhe jehonë vlerave të trashëgimisë tonë shpirtërore.

Dhe nuk ndalet këtu. Projekti përfshin dhe forum me mësuesit e shkollave të mesme të letërsisë dhe historisë për t'i shpërndarë këto materiale, që ata t'i përdorin gjatë orëve mësimore ekstra-kurrikulare, por edhe si produkte për shfaqjet artistike në shkolla.

Titulli tregon gjithçka që kemi dashur të themi përmes këtij projekti: Trashëgimia është pasuria jonë më e madhe, është reklama më e mirë me të cilën duhet t'i prezantohemi botës.

Shqipëria është ende e paeksploruar tërësisht dhe historia e saj e pathënë siç duhet, për shkak të një izolimi të thellë komunist, dhe një tranzicioni të tejzgjatur.

Përmes këtij projekti mendojmë se po vendosim një gur themeli në promovimin e Shqipërisë si një popull me vlera, një ndër popujt më të vjetër në Ballkan që ka ditur të ruajë gjuhën, zakonet, traditat, ritualet, përrallat e legjendat, që ende ruhen në kujtesën e gjyshërve dhe brezit të tretë. Detyra jonë si shoqëri civile është që përmes projekteve të tilla, të bëjmë të mundur që kjo pasuri të mos humbasë, por të vazhdojë të jetojë dhe të përcillet brez pas brezi.



Rreth Botimit

Projekti "Heritage is our Brand" është konceptuar si një nismë gjithëpërfshirëse që synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të angazhojë brezat e rinj në procesin e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore jo materiale të Shqipërisë. Në thelb, ky projekt është më shumë se një iniciativë kulturore; ai përfaqëson një investim të qëndrueshëm në shpirtin dhe identitetin shqiptar, duke ofruar një platformë për lidhjen e brezave me rrënjët e tyre kulturore.

Përgatitën:

Prof. asoc. dr. Marenglen KASMI
Prof. asoc. dr. Belisa MUKA
Prof. asoc. dr. Andi PINARI

Tiranë, 2025



Përmbajtja:

Hyrje

Metodologjia e ndjekur

Historitë

1. Teuta, mbretëresha e deteve
2. Antigonea, qyteti i dashurisë dhe dhimbjes
3. Një histori ilire: mbreti Gent dhe zbulimi i lules çudibërëse
4. “Të lirë nën emrin tim”, gratë që falin lirinë në Butrint
5. Kërcimi i nimfave rreth flakëve të përjetshme të Nymfeut të Apolonisë
6. Ulpiana (Iustiniana Secunda) dhe dedikimi i Justinianit
7. Kujtimet që ngjalli *balisca* (vera) ilire
8. Via Egnatia, Ad Quitum dhe Marcus Sabidius Maximus
9. Gjiri i Gramës, shpresa e lundëtarëve
10. Fitimtarë në përballjet fizike, Amfiteatri i Dyrrahut
11. Liqeni i Seferanit dhe kushtimet e “të bukurave të dheut”
12. “Mali i mbretërve ilirë”, varret shkëmbore në Selcën e Poshtme
13. Miti i Kadmit në Iliri
14. Shqiponjat arbërore të Komanit
15. Në gjurmët e Gjergj Kastriotit, Kalaja e Petrelës
16. Gjuha që nuk humbi – legjenda e kalorësit gjerman
17. Sazani, ishulli që nuk flet
18. Mali i Tomorrit dhe Baba Tomorri
19. Beja mbi gur, fjala që nuk shkelet
20. Gjama e burrave në Shqipëri, zë i dhimbjes dhe nderit
21. Dollia, bekimi i ngritur në kupë
22. Dragoi dhe Kulshedra, lufta e përjetshme e forcave mitike në Mirditë
23. Flija, shija e traditës dhe mikpritjes së veriut shqiptar
24. Fyejt e Gramshit dhe historia e Tanës
25. Kulla e ngujimit, pritja e heshtur për drejtësi
26. Legjenda: “Vrima e Nuses në Kanionin e Osumit”
27. Lojërat popullore shqiptare, kujtim i gjallë i gëzimit dhe traditës
28. Vallja e Osman Takës, një akt lirie në hijen e vdekjes
29. Xhamia e Gjin Aleksit, ura e besimit ndërmjet kohëve
30. Legjenda e Grykës së Vajës
31. Shenjtëria e Kaprollit, historia e drekës së thyer
32. Nëna Shqipëri, simboli i ndërgjegjes kombëtare
33. Nënë Tereza, shenjtoria e mëshirës
34. Kodikët e Beratit
35. Udha e krushqve, udhëtimi i shenjtë i martesës shqiptare
36. Varri i Ashikut, kujtim i përjetshëm i një dashurie të ndaluar
37. “Zëri që rri varur në gur”, legjenda e vashës në kanionin e Holtës
38. Kepi i Rodonit, një vend i heshtur që ruan historinë, besimin dhe shpresën

39. Argjendarët shqiptarë dhe filigrani: mjeshtëri, identitet, trashëgimi
40. Kostumet popullore shqiptare, kujtesë e gjallë

Hyrje

Projekti *"Heritage is our Brand"* është një nismë e thellë dhe gjithëpërfshirëse që synon të ruajë dhe të promovojë trashëgiminë kulturore jomateriale të Shqipërisë, duke e lidhur atë me identitetin e pasur dhe të shumëllojshëm të popullit shqiptar. Ky projekt është i orientuar drejt angazhimit të brezave të rinj dhe të të gjithë individëve, për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë që ka kaluar nga brezi në brez përmes historive, legjendave dhe traditave që formojnë kulturën e pasur shqiptare. Disa prej këtyre historive përmbledhen në këtë projekt dhe pasqyrojnë elementët e ndryshëm të historisë dhe kulturës shqiptare, duke theksuar lidhjet me natyrën, mitologjinë, moralin dhe vlerat shoqërore.

Në këtë kuadër, trashëgimia kulturore shqiptare është e ndarë në disa kategori kryesore që përfshijnë:

- Lidhjet e thella me historinë dhe identitetin kombëtar
- Trashëgimia mitologjike dhe lidhjet me natyrën
- Traditat dhe besimet popullore
- Trashëgimia e shenjtërisë dhe historisë
- Legjendat dhe mesazhi i ruajtjes së moralit dhe vlerave shoqërore

Ky projekt është një mundësi e artë për të përqendruar vëmendjen tek pasuria e jashtëzakonshme e trashëgimisë kulturore shqiptare dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e saj, duke theksuar rolin e saj në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe shpirtëror. Trashëgimia kulturore shqiptare, e cila përfshin jo vetëm historitë dhe legjendat e pasura, por edhe gjuhën shqipe, është një shtyllë thelbësore e ekzistencës sonë si komb. Gjuha shqipe është më shumë se një mjet komunikimi; ajo është një simbol i fuqishëm i identitetit, i unitetit dhe i vazhdimësisë së kulturës shqiptare përmes shekujve.

Përmes këtyre historive dhe legjendave, ne kemi mundësinë të rikthejmë dhe të ripërtërijmë vlerat, besimet dhe traditat që përbëjnë themelet e shoqërisë shqiptare, për t'u siguruar që ato të vazhdojnë të jetojnë në brezat e ardhshëm. Gjuha shqipe është përcjellësi i këtyre mesazheve dhe vlerave, një forcë që lidh brezat përmes një pasurie të paçmuar fjalësh dhe shprehjesh që mbajnë brenda historinë dhe shpirtin e popullit shqiptar. Ruajtja e gjuhës është, në fakt, një pjesë e ruajtjes së gjithë trashëgimisë kulturore, sepse ajo është ajo që e mban të gjallë lidhjen me të kaluarën dhe e bën të mundur kalimin e kësaj trashëgimie tek brezat e ardhshëm.

Këto histori janë më shumë se thjesht tregime nga e kaluara; ato përfaqësojnë një pasuri të thellë shpirtërore dhe kulturore, të cilat i japin kuptim dhe qëllim jetës dhe vlerave të shqiptarëve. Ato janë një pasqyrë e historisë sonë, një dëshmi e forcës dhe qëndrueshmërisë së popullit shqiptar, që ka kaluar shumë periudha sfiduese, por gjithmonë ka mbajtur gjallë besimin dhe krenarinë për trashëgiminë e tij. Gjuha shqipe është ajo që mban të lidhura këto histori dhe legjenda, duke ruajtur thesaret e mendësisë, filozofisë dhe artit të një kombi që ka krijuar një kulturë të pasur dhe të veçantë.

Në këtë kontekst, projektet si ky ofrojnë mundësinë e një lidhjeje të thellë mes të kaluarës dhe të tashmes. Ato na ndihmojnë të kuptojmë se trashëgimia kulturore nuk është thjesht një koleksion i ngjarjeve të shkuara, por një element aktiv që formëson dhe udhëzon jetën tonë sot. Përmes promovimit dhe ruajtjes së këtyre pasurive, ne i japim brezave të rinj mundësinë

që të kuptojnë dhe respektojnë rrënjët e tyre, duke kontribuar në forcimin e një identiteti të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

Nëpërmjet këtyre historive, mesazhet e vlerave dhe besimeve që janë pasqyruar gjatë shekujve vazhdojnë të jenë një thesar i çmuar që nuk duhet të humbasë. Ato janë një urë lidhëse mes brezave, një formë e ruajtjes së të kaluarës, që është thelbësore për ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme dhe të pasur kulturore. Ruajtja e kësaj trashëgimie nuk është vetëm një detyrë e çdo shqiptari, por një mundësi për të siguruar që historia dhe vlerat e kombit të mbeten të gjalla, duke udhëzuar brezat që do të vijojnë në rrugëtimin e përbashkët për zhvillimin dhe forcimin e shoqërisë.

Metodologjia

Ky projekt ka synuar të sjellë një pasqyrë të pasur dhe të kuptueshme të trashëgimisë kulturore jomateriale shqiptare. Duke u mbështetur në legjenda dhe tregime popullore është mundësuar një lidhje e fortë mes të kaluarës dhe të tashmes. Ndonëse legjendat janë gjithmonë produkt i imagjinatës popullore, ato janë mbushur me mesazhe të fuqishme dhe përçojnë vlera të shëndetshme dhe të qëndrueshme, që lidhen ngushtë me jetën dhe ndjenjat e shoqërisë shqiptare. Çdo histori është trajtuar jo thjesht si një mit, por si një pasuri që ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë dhe që ka një kuptim të thellë brenda saj.

Për këto arsye është përdorur një qasje që lidh historitë me një kontekst të caktuar historik dhe social, duke pasur parasysh që secila legjendë ka lindur në kushte të ndryshme, përmes ndikimeve nga periudha të caktuara. Kështu, çdo histori është trajtuar duke u mbështetur në literaturën dhe studimet shkencore që janë bërë mbi këto ngjarje e periudha historike, duke mundësuar një kontekstualizim të thellë e të qartë të historive të trajtuara.

Po kaq e rëndësishme ishte që legjendat dhe tregimet popullore të përfshiheshin në këtë material, jo si histori të thjeshta, por si pasqyrime të një shoqërie që ka gjetur në to mënyra për të shprehur identitetin, gjuhën, doket e zakonet, shpresën dhe besimet e saj. Legjendat janë gjithashtu një mjet për të ruajtur dhe kaluar ndër breza mesazhe të fuqishme, që ndihmojnë në ndërtimin e identitetit dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Për të siguruar një pasqyrë sa më të saktë dhe të qëndrueshme, kemi mbështetur shpjegimet në burime historike dhe dëshmi të tjera, që ofrojnë një kuptim më të thellë të periudhës që ka sjellë lindjen e secilës histori. Ky proces ka siguruar që përmbledhja e këtyre legjendave të jetë e mbështetur mbi një bazë të besueshme e të kujdesshme, për të ruajtur shpirtin e traditës popullore, e cila shpeshherë i lë vend imagjinatës dhe thjeshtësisë.

Është e rëndësishme të theksojmë që këto legjenda janë jo vetëm pasqyrime të historisë, por edhe mënyra të shprehjes së besimeve, moralit dhe ndjenjave të njerëzve të kohës. Prandaj, këto tregime, ndonëse përmbajnë elementë imagjinarë, janë të lidhura ngushtë me ngjarje dhe situata që kanë ndodhur dhe që kanë pasur një ndikim të madh në shoqërinë dhe kulturën ilire e më pas shqiptare. Kjo qasje ka mundësuar që legjendat dhe tregimet të shpalosin një histori të pasur dhe të kuptuar mirë në kontekstin e kohës së tyre.

Përgatitja e këtyre historive ka pasur për qëllim jo vetëm të sjellë një pasqyrë të trashëgimisë kulturore shqiptare, por edhe të nxisë një reflektim të thellë për vlerat që ato përçojnë. Mesazhet që ato mbartin janë të forta dhe të qëndrueshme, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në formësimin e mentalitetit dhe traditave që mbështesin shoqërinë shqiptare, dhe mbeten të vlefshme dhe të rëndësishme për brezat e rinj.

Për këtë arsye, ky material është një mundësi për të lidhur trashëgiminë kulturore shqiptare me një kontekst historik dhe shoqëror që është gjithashtu i mbështetur në burime të

besueshme, duke i dhënë legjendave dhe tregimeve një dimension të ri dhe të thelluar, që i lidh ato me realitetin e sotëm dhe me nevojën për të ruajtur ato si pasuri të çmuar kulturore. Për çdo histori të përzgjedhur, kemi ndjekur një strukturë të qartë dhe të konsoliduar, e cila përfshin disa elementë kryesorë që sigurojnë një trajtim të plotë, të thelluar dhe të besueshëm. Ky proces është krijuar për të garantuar se çdo histori është shkruar duke respektuar disa hapa dhe parime, për të siguruar një pasqyrë të qartë dhe të besueshme, si:

- Përgatitja e një rishikimi të thelluar të historisë: Para se të sillet çdo histori/ ngjarje, është realizuar një kërkim i detajuar mbi periudhën historike të ngjarjes, duke përfshirë studime dhe burime të besueshme. Kjo ka ndihmuar në krijimin e një konteksti të fortë dhe të bazuar për çdo ngjarje.
- Përzgjedhja e burimeve dhe dokumenteve relevante: Çdo histori është mbështetur në burime të shkruara, dëshmi të trashëgimisë gojore dhe Bibliografia shkencore për të siguruar që ngjarjet të trajtohen në mënyrë të saktë dhe të dokumentuar.
- Ndërlidhja e legjendës me zhvillimet historike: Çdo histori është trajtuar me kujdes, duke u mundësuar lidhje të qarta mes tregimit dhe periudhës historike. Ky është një hap i rëndësishëm për të kuptuar se si legjendat janë formuar në një kohë të caktuar dhe si ato kanë reflektuar shoqërinë e asaj periudhe.
- Kontekstualizimi i ngjarjes dhe mesazhit të saj: Pas përshkrimit të ngjarjes, është bërë një analizë e mesazhit që ajo përcjell dhe rëndësisë së saj në kontekstin e sotëm. Kjo ka mundësuar që historitë të mos jenë thjesht tregime të kaluara, por të lidhen me vlerat dhe normat që mbahen ende të rëndësishme në shoqërinë shqiptare.
- Përdorimi i një stili të qartë dhe të thjeshtë për të arritur publikun e gjerë: Megjithëse historitë janë mbështetur në studime dhe burime historike, ato janë pasqyruar në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për çdo lexues, duke e bërë historinë të përshtatshme për audienca të ndryshme. Në këtë mënyrë, çdo histori është trajtuar duke ndjekur një metodologji të kujdesshme dhe të balancuar, e cila synon që të ruajë një lidhje të fortë me të kaluarën, por gjithashtu të ofrojë një kuptim të thellë dhe të qartë për lexuesit e sotëm.

Historitë e përzgjedhura janë renditur sipas parimit kohor, çka do të thotë se ato janë përzgjedhur dhe trajtuar në një radhë që pasqyrojnë zhvillimin e ngjarjeve dhe periudhave historike. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se renditja kronologjike nuk pasqyron vlerën relativisht më të madhe të një historie në krahasim me një tjetër. Çdo histori, qoftë e hershme apo më e vonshme, ka rëndësinë dhe vlerën e saj të veçantë, dhe secila sjell një mesazh të rëndësishëm që kontribuon në kuptimin e trashëgimisë kulturore dhe identitetit shqiptar. Kjo qasje ka për qëllim të ofrojë një udhërrëfyes të natyrshëm dhe të kuptueshëm për lexuesin, duke i mundësuar të ndjekë rrjedhën e historive dhe legjendave në një kontekst të plotë dhe të balancuar.

Teuta, mbretëresha e deteve

Atë ditë era rrihte me forcë brigjet e Adriatikut të lashtë. Anijet lëkundeshin në port, disa të rënduara me plaçkën e luftës në kthim, të tjerat gati për të nisur luftëtarë të rinj drejt brigjeve të largëta.

Mbreti vdiq dhe këshilli i burrave vendosi: Teuta, e veja e tij, do të udhëhiqte shtetin! Teuta, me gishtrinj të që dridheshin, preku kurorën e ftohtë që mbante mbi kokë. Ishte kurora e Agronit, e cila i dukej e rëndë, një barrë që ja kishin besuar asaj. Hodhi sytë nga Pini i vogël, që qeshte dhe luante me erën. Dukej një çast i qetë, i çuditshëm, si pragu i një stuhie. Ndërkohë dyert u hapën dhe lajmësi hyri.

- Madhëria juaj, një dërgatë nga Roma kërkon audiencë. Thonë se sjellin fjalë paqeje... Paqe. Sa e pakuptimtë tingëllonte kjo fjalë.

Flota e Teutës ishte shpata dhe parzmorja e saj. Ajo u kishte dhënë fuqi kapitenëve të detit për të goditur këdo që guxonte të sfidonte epërsinë ilire. Disa i quanin piratë. Teuta i quante mbrojtës të mbretërisë. Por forca kishte një çmim.

Ndonëse ambasadorët nga Roma mbërritën me flamuj të bardhë, gjuha e tyre ishte e rëndë, fytyrat i kishin të tendosura nga arroganca. Njëri prej tyre, *Lucius Coruncanius*, guxoi t'i priste fjalën. Ai e kërcënoi, e kujtoi se ajo kishte fyer Romën, ndaj do ta pësonte.

Teuta nuk tha asnjë fjalë: heshtja ishte gjykim më i rëndë se çdo kërcënim.

Ambasadorët u larguan nga kështjella të bindur se kishin lënë pas një grua të frikësuar. Por në oborrin pranë portit, diçka ndodhi. Vetëm njëri prej ambasadorëve u kthye në Romë. Tjetri u zhduk. Disa thanë se trupin e gjeti deti, të shtrirë në shkëmbinj, me shikimin ende të ngulur drejt kështjellës. Të tjerë thanë se trupi nuk u gjet kurrë, a thua deti vetë ta kishte përpirë, si hakmarrje e lashtë për fyerjen që iu bë një mbretëreshë që nuk i përkulej askujt.

Roma do ta mbante mend atë heshtje.

Senati romak shpalli luftë: në vitin 229 p.e.s. flotat romake zbarkuan në brigjet ilire me një forcë që këto troje nuk e kishin parë kurrë më parë. Ishte fillimi i Luftës së Parë Ilir-Romake. Teuta luftoi me gjithë fuqinë e saj. U përpoq të mbante nën kontroll mbretërinë dhe aleatët dhe të përballonte stuhinë që po vinte nga perëndimi. Por këtë herë, dallgët e historisë ishin shumë më të mëdha se ato të detit.

E rrethuar dhe pa mbështetje, Teuta u detyrua të dorëzohej. Ilirët humbën territore, humbën lirinë, por jo kujtimin dhe emrin e saj. Teuta është gruaja që sfidoi një perandori, mbretëresha që hyri në histori, edhe pse kanë kaluar shumë e shumë shekuj.

Periudha kohore: Shek. III p.e.s.

Përmbledhja historike e periudhës

Teuta ishte mbretëresha e ilirëve nga fisi i ardianëve, e veja e mbretit Agron, që sundoi për disa vite në fund të shekullit III p.e.s. (230-227). Pas vdekjes së Agronit, ajo mori drejtimin e shtetit ilir si mëkëmbëse e djalit të mitur të Agronit, Pinit, nga martesë e tij me Triteutën (Polyb. *Historiai*, II).

Gjatë sundimit të saj, Teuta sfidoi hapur fuqinë në rritje të Republikës Romake, duke mbështetur lëvizje detare dhe veprime piraterie që çuan në përplasjen e parë ushtarake mes Ilirisë dhe Romës – Luftën e Parë iliro-romake. Edhe pse e detyruar të dorëzohej dhe të pranonte kushte të rënda nga Roma, ajo mbeti në kujtesën historike si një figurë femërore e fuqishme, luftëtare dhe e pamëshirshme ndaj armiqve.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Teuta, mbretëresha e ilirëve, përfaqëson një nga figurat më të fuqishme historike që është mitizuar në kujtesën popullore, veçanërisht në viset bregdetare të Adriatikut. Figura e saj përshkon kufijtë mes historisë dhe legjendës, duke e kthyer një personazh real historik në simbol të fuqisë femërore dhe qëndresës ndaj pushtuesit të huaj. Në traditën gojore dhe kujtesën popullore shqiptare, sidomos në trevat e Shkodrës, Rrjollit, Karaburunit dhe Himarës, Teuta ka marrë përmasat e një figure mitike: ora mbrojtëse, mallkuese e të padrejtëve, dhe frymëzim i qëndresës.

Mesazhi

Kjo pjesë tregon historinë e një gruaje që, përballë një fuqie të madhe si Roma, zgjodhi të mos përkulej, edhe pse e dinte se kjo mund ta çonte drejt humbjes. Ajo e mbrojtë sovranitetin dhe nderin e popullit të saj me vendosmëri, duke përdorur heshtjen si forcë dhe gjestin si qëndrim politik. Teuta humbi betejën me Romën, por fitoi një vend të përjetshëm në kujtesën historike si simbol i guximit dhe dinjitetit.

Bibliografia:

- Ceka, Neritan, Ilirët (Tiranë: Toena, 2012).
- Wilkes, J. John, The Illyrians, Oxford 1992.
- Domi, Mahir. Motivët heroikë dhe mitikë në folklorin shqiptar (Tiranë: SHBLSH, 1987).
- Instituti i Kulturës Popullore. Arkivi "Figura mitike në bregdetin shqiptar", zona e Shkodrës, Himarës dhe Vlorës, intervista të mbledhura në vitet 1976–1982.
 - Regjistrime të gojëdhënave për "Shpellën e Teutës", "Hedhjen e Teutës" dhe "mallkimin e mbretëreshës" në zonat bregdetare.
 - Tregime gojore nga banorët e Karaburunit dhe Rrjollit, të mbledhura nga studiues vendas dhe të përmendura në punimet e ekspeditave folklorike të Universitetit të Shkodrës dhe QSA (fondi oral, i pa botuar tërësisht).

Antigonea, qyteti i dashurisë dhe i dhimbjes

Kohë më parë, në zemrën e thellë të Epirit, mes maleve të larta dhe buzë luginave që gjarpëronin hijshëm, jetonte një princ i ri dhe luftëtar me emrin Pirro. Pasi kaloi vitet e hershme të fëmijërisë pranë mbretit të Taulantëve, Glaukias, Pirro mori rrugën drejt Aleksandrisë – qytetit të dijes dhe fuqisë. Aty, në madhështinë e oborrit mbretëror të Ptolemeut, takoi Antigonën, vajzën e mbretëreshës Berenika, një grua që do të ndryshonte rrjedhën e jetës së tij. Ajo ishte ndryshe nga gratë që kishte njohur deri në atë moment. Antigona fliste me fuqinë e arsyes dhe vështirimin e urtësisë. Ajo njihte gjuhën e librave dhe të yjeve; kishte ecur krah për krah me filozofët dhe kishte qëndruar pranë poetëve.

Pirro, një luftëtar i stërvitur në betejat të shumta, heshti përballë poezisë së shpirtit të saj. Kur Pirro i kërkoi dorën, ajo i besoi zemrës së tij. Bashkë u kthyen në Epir dhe Pirro u kurorëzua mbret. Ndonëse i dashuruar, Pirro ishte lindur për luftë. Antigona qëndroi pranë tij në çdo betejë. Ajo ishte paqja e tij.

Për ta përjetësuar dashurinë për gruan, Pirro vendosi të themelonte një qytet në nder të saj, në kodrën më të lartë që ngrihej mbi luginën e Drinosit.

Qyteti rritej përditë, ashtu siç rritej edhe djali i tyre brenda saj. Një ag mëngjesi, kur mjegulla nuk ishte ngritur ende, Antigona ndjeu se çasti kishte ardhur. Pirro, që e kishte prekur vdekjen qindra herë, u struk si fëmijë dhe dridhej përballë jetës që po vinte. Por Perënditë u kishin përgatitur një fat të zi. Antigona nuk mundi t'i mbijetonte lindjes. Ajo vdiq duke i dhënë jetë djalit të tyre.

Ptolemeu i vogël u rrit ndër rrugicat e Antigonesë, mes gurëve që ende ruanin ngrohtësinë e duarve të nënës së tij. Qyteti gjallonte nga fryma e saj, një frymë dashurie për këto vise të largëta që ajo i quajti shtëpi. Çdo shesh, çdo mur, dukej sikur pëshpëriste emrin e saj.

Ai nuk e njohu kurrë nënën e tij Antigonën, por e shihte në ëndrra, e ndjente praninë e saj në flladin që përkëdhelte kodrat, në freskinë e hijeve të lisave që ngriheshin pranë portave të qytetit, në këngët e vashave sa herë vinte pranvera dhe në dashurinë me të cilën ajo kishte ndërtuar një qytet të tërë për të, para se të largohej përgjithmonë.

Qyteti, i lindur nga dashuria dhe dhimbja, u kthye në strehë të dijes dhe urtësisë, ashtu siç do ta kishte ëndërruar ajo. Sot, rrënojat e Antigonesë qëndrojnë aty të heshtura, por jo të ftohta. Janë kujtimi i një dashurie që nuk u thye nga vdekja, por u lartësua prej saj.

Periodha kohore: Shek. III p.e.s.

Përmbledhja historike e periudhës

Rrënojat e qytetit antik të Antigonesë ndodhen në kreshtën e kodrës së Jermës, në jugperëndim të fshatit të Saraqinisht, rreth 7 km në lindje të qytetit të Gjirokastrës. Ajo është qendra e pellgut të lumit Drino. Antigonea, e themeluar gjatë mbretërimit të Pirros (297–295 p.e.s.), mbretit të famshëm të Epirit, mban emrin e gruas së tij të parë, Antigones, vajza e birësuar e mbretit Ptoleme I i Egjiptit. Sipas Etienit të Bizantit (*shënimi Αντιγόνη*), qyteti bënte

pjesë në rajonin e Kaonisë antike, në një pikë strategjike që kontrollonte kalimet natyrore në luginën e Drinosit, midis Epirit dhe Ilirisë.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Emri i qytetit, Antigonea, është dëshmi e nderimit që Pirroja kishte për Antigonën, por edhe e aleancës së rëndësishme që u krijua nëpërmjet lidhjes martesore me dinastinë ptolemaike (Plutarku, *Pyrrus*). Ishte falë kësaj aleance që ai rimori fronin e Epirit (Pausania 1.11.5). Pirro dhe Antigona patën dy fëmijë: një vajzë – Olympias dhe një djalë, i quajtur Ptoleme Pirro (ose thjesht Ptolemeu), në nder të gjyshit të tij nga nëna, Ptoleme I Soter, themeluesi i dinastisë ptolemaike në Egjipt. Burimet historike dëshmojnë se Antigona nuk i mbijetoi lindjes së djalit dhe vdiq gjatë saj. Mendohet se në nder të kujtimit të gruas së tij të parë, Pirro themeloi qytetin e Antigonesë.

Mesazhi

Kjo pjesë përcjell një mesazh njerëzor që lidhet me dimensionet e shumta të dashurisë: asaj midis një burri e një gruaje, sublimes midis nënës dhe fëmijës së saj. Antigonea është simbol edhe i përballjes njerëzore me dhimbjen dhe humbjen, por edhe i një aleance strategjike midis Egjiptit dhe Epirit, dy fuqi të rëndësishme të kohës. Themelimi i qytetit ishte akt dashurie, kujtese dhe diplomacie njëherazi. Dashuria dhe kujtimi mund të themelojnë qytete, por ato kthehen në trashëgimi të gjalla atëherë kur lidhen me vizionin, politikën dhe historinë.

Bibliografia

- Budina, Dhimoshten. Antigonea: Rezultatet e gërmimeve 1966-1970, Iliria 2 (1972), f. 269-378
- Budina, Dhimoshten, Harta arkeologjike e luginës së Drinosit, Iliria 3 (1974), f. 354-392
- Budina, Dhimoshten, Antigonee d'Épire, Iliria 4 (1976), f. 327–335
- Budina, Dhimoshten, Le lieu et le rôle d'Antigonea dans la vallée du Drino, në P. Cabanes (edt.), L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'antiquité, Actes du colloque Clermont-Ferrand (1987), f. 159–166

Një histori ilire- Mbreti Gent dhe zbulimi i lules çudibërëse

– Ejani, fëmijë... është ora e gjumit! – Gjysh, gjysh, na e trego edhe një herë historinë e mbretit Gent dhe lules çudibërëse që ai zbuloi.

Në brigjet e thepisura të liqenit të Labeatëve, mes maleve që ruajnë në heshtje kujtimet e shekujve, mbretëronte Genti, biri i Ardianëve dhe mbret i Ilirëve. Kur mori kurorën nga i ati, Pleurati, Genti trashëgoi një mbretëri të rrethuar nga armiq. Në brigjet e Adriatikut, romakët kishin nisur marshimin, duke pushtuar një nga një mbretëritë fqinje, si dallgë që godasin pa mëshirë bregun. Por Genti, krenar, refuzoi t'u nënshtrohej. Ushtria e tij kishte luftëtarë trima dhe një flotë të fuqishme. Anijet Liburne, të lehta e të shpejta, çanin detin si shigjeta dhe sulmonin befas, duke lënë pas jehonën e trimërisë ilire.

Genti ishte një udhëheqës i mençur që e njihte fuqinë e dijes po aq sa të shpatës. E adhuronte natyrën dhe shpesh u thoshte bashkëluftëtarëve: “Lufta fitohet më parë me mendje të kthjellët dhe trup të shëndetshëm, pastaj me armë”.

Një ditë, duke ecur në një shteg të thepisur, vuri re një lule të pazakontë, me petale si rrezet e diellit, që qëndronte e vetme mes shkëmbinjve. Mbreti u përkul, e soditi gjatë, dhe në atë çast ndjeu se ajo nuk ishte një lule e zakonshme. Ajo ishte lulja e duhur. Prej rrënjëve të saj u përgatit një melhem që shëroi plagët e shumë luftëtarëve në betejat e përgjakshme kundër romakëve. Nuk vonoi, dhe fama e saj doli përtej trojeve ilire. Ajo që ndër ilirë njihej si “lulja e Mbretit”, më vonë mori emrin Gentiana.

Pas vdekjes së Gentit në mërgim, kur Roma arriti të pushtonte Ilirinë, Gentiana vijoi të lulëzonte në lartësitë e maleve, atje ku ajri është i pastër dhe toka ruan gjurmët e të parëve. Kjo lule ishte dhurata e mbretit për botën. Ajo mbart kujtimin e një epoke kur Iliria qëndronte krenare. Është simbol i urtësisë së Gentit dhe i dashurisë së tij për tokën dhe njerëzit. Sa herë që Gentianat çelin dhe veshin faqet e maleve, zbret një filad i lehtë që pëshpërit: lavdia e Gentit është gjithmonë aty.

Gjyshi u ngrit. Me duart që i dridheshin nga pesha e viteve, i mbuloi të vegjlit me kujdes. Ata tashmë ishin futur në botën e ëndrrave: Liburni trim dhe i mençur luftonte syptatrembur në dritën e hënës dhe yjeve, ndërsa Gentiana fluturonte nga mali në mal, për të shëruar plagët e luftëtarëve që mbronin trojet e të parëve.

Periudha kohore: Shek. II p.e.s

Përmbledhje historike e periudhës

Genti, djali i Pleuratit II, njihet si mbreti i fundit i mbretërisë ilire të Ardianëve dhe qëndroi në fronin e sundimit rreth viteve 181–168 p.e.s., në një periudhë të trazuar historikisht kur Iliria ishte nën presionin e dy fuqive të kohës, nga njëra anë Roma, nga tjetra Maqedonia.

Mbreti Genti njihet për përpjekjet e tij për të ruajtur pavarësinë e Ilirisë, ndërkohë që Republika Romake zgjeronte ndikimin e saj në territoret ballkanike. Gjatë Luftës III Maqedonase kundër Romës (171-168 p.e.s.), ai hyri në aleancë me Perseun, mbretin e Maqedonisë. Genti i shpalli

luftë Romës, por aleanca me Perseun dështoi dhe ushtria e Gentit u mposht nga romakët në betejën e Shkodrës – kryeqendra e labeatëve.

Ndër dëshmitë e shumta arkeologjike që i përkasin periudhës së mbretërimit të tij, në qytetet e Shkodrës dhe të Lisit (Lezha) u prenë dhe qarkulluan disa lloje monedhash me emrin dhe portretin e tij.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Burimet e shkruara flasin për rëndësinë e figurës së mbretit Gent si mbështetës i kulturës dhe shkencës, sidomos i mjekësisë dhe botanikës. Në veprën e tij Plini Plaku (*Naturalis Historia*, 25.34), veçanërisht në librin XXV “Historia natyrore e bimëve të egra”, dëshmon se Genti që i pari që njohu dhe përdori vetitë kuruese të rrënjës së bimës *Gentiana*, e njohur si *Gentiana Lutea*.

Mesazhi

Mbret Genti, i fundit mbret i ilirëve, mishëron qëndresën e një kombi të lashtë përballë ekspansionit të Republikës Romake, e cila do të shndërrohej më pas në themeluesen e qytetërimit perëndimor. Figura e tij i tejkalon kufijtë e historisë ushtarake. Lidhja e tij me natyrën, përkujdesja për dijen dhe trashëgimia e bimës *Gentiana* e ngulitin atë në kujtesën kulturore popullore si një simbol të urtësisë, qëndresës dhe ndërveprimit të njeriut me tokën që e mban gjallë. Ky dimension shumëplanësh e vendos Gentin si një figurë kyçe në trashëgiminë historike e shpirtërore të shqiptarëve.

Bibliografia

- Islami, Selim, Prerjet monetare të Skodrës, Lisit dhe Gentit, Iliria 2 (1972), f. 351-373
- Cabanes, Pierre, Les Illyriens de Bardylis à Genthios: IVe au IIe siècle avant J.-C., Paris 1988
- Gjongecaj, Shpresa, Emisione të reja monetare nga qyteti antik i Shkodrës (Scodra), Iliria 40 (2016), f. 97-109. DOI : <https://doi.org/10.3406/iliri.2016.2517>
- Wilkes, J. John, The Illyrians, Oxford 1992
- Grup autorësh, Ilirët dhe liria tek autorët antikë, Prishtinë 1979

“Të lirë nën emrin tim” - gratë që falin lirinë në Butrint

Dielli po perëndonte në ngushticën e Korkyrës, duke lëshuar një dritë të artë mbi gurët e bardhë të faltores së Asklepit. Qyteti që gumëzhinte gjatë ditës nga britmat e marinarëve, thirrjet e tregtarëve dhe artizanëve, po gjente dalëngadalë qetësinë e merituar në këtë pragmuzg.

Brenda rrethimit të shenjtë, mes lisave të vjetër dhe murit të gurtë që ndante botën e përditshme nga hyjnorja, ishte mbledhur një grup i vogël njerëzish. Drejt tyre, Argeia, një grua në moshë, ecte me hap të sigurt. Prej vitesh kishte menduar për këtë çast. Mbeti e ve në moshë të re dhe trashëgoi një pronë të madhe nga familja e saj tregtare, të cilën e kishte menaxhuar me mençuri e dinjitet, duke fituar respektin e qytetarëve të Butrotit. Veprimi që ajo po përgatitej të ndërmerre nuk ishte i zakonshëm. Ndonëse në Butrot, gra si ajo, trashëgimtare apo të veja që zotëronin skllëvër, kishin nisur të merrnin pjesë në jetën publike në mënyrë të pazakonta për kohën. Disa prej tyre kishin zgjedhur të lironin skllëvërit e tyre.

Atë ditë, në praninë e Asklepit e Zeusit dhe të bashkëqytetarëve të saj, Argeia liroi katër skllëvër. Të gjithë punëtorë të mirë, amvisa të zonja, zejtarë të aftë. Ndër ta ishte edhe i riu Derdas, që ishte bërë pjesë e shtëpisë që kur ishte ende fëmijë. Kur vëllai i Argeas zuri shtratin, Derdas u kujdes për të tre vite radhazi. Në netët e gjata me ethe, ai lutej në heshtje tek Asklepi dhe ndizte pishtarë në altar për shërimin e tij. Dhe shërimi erdhi, ngadalë por i sigurt, ashtu siç erdhi edhe vendimi i Argeias për ta shpërblyer jo vetëm me liri, por dhe me mirënjohje.

- Nën emrin tim, ti nuk je më pronë, i tha ajo, - ti je bir i lirë nën sytë e Zeus *Soter* (shpëtimtarit)

Fjalët e saj u gdhendën në gur, ashtu si qindra akte të tjera lirimi që vishnin tashmë muret e teatrit, hyrjet e faltoreve dhe rrugicat e shenjta të Butrotit. Por kishte diçka që e veçonte këtë mbishkrim nga të tjerët. Mbi të ishte gdhendur emri i një gruaje, pa bashkëfirmëtar mashkull, pa emrin e ndonjë burri që të garantonte aktin. Ishte dëshmi e qartë e kohës dhe vendit, një Butrot që, ndryshe nga shumë qytete të tjera të botës antike, u jepte grave jo vetëm një zë, por edhe një vend në histori.

Në tempullin e Asklepit, tymi i temjanit u përhap në ajër. Argeia u gjuhëzua dhe hodhi një monedhë të artë në altar. Ndërsa u lut për lirinë dhe shëndetin e ish-skllëvërve të saj, pa vegimin e vajzës së vogël që dikur, në këtë sanktuar shihte burrat e qytetit të shkruanin histori. Sot, ajo shkroi e vetme historinë e saj, pa burrë në krahë. Buthrotum, qyteti i hyjnive dhe mbrojtësi i lirisë së fituar me dinjitet, tashmë mbante emrin e saj të gdhendur në gur për brezat që do të vinin.

Periudha kohore: Shek. III-I p.e.s.

Përmbledhje historike e periudhës

Qyteti antik Bouthrotos (Butrot, Butrint), i vendosur në skajin jugor të gadishullit të Ksamilit, ndodhej në një nyje strategjike të rrugëve detare në brigjet e Jonit. Butrinti ishte pjesë e

krahinës epirote të Kaonisë dhe, në periudhën helenistike dhe më vonë në ndikimin romak, u zhvillua si një qendër me rëndësi të madhe kulturore dhe religjioze. Gjatë kësaj kohe, në Butrint dokumentohet gjerësisht praktika e lirit të skllëvërve, e cila kishte vlerë publike, ligjore dhe fetare. Aktet e lirit gdhendeshin në gur dhe vendoseshin në struktura publike si teatrot, faltoret dhe muret e shenjta, duke i dhënë aktit të lirit një përmasë solemne “para syve të perëndive”.

Sqarim: *emrat e personazheve dokumentohen në aktet e lirit të skllëvërve nga Butrinti.*

Kushtet që sollën linden e ngjarjes

Në shoqëritë antike greke dhe romake, roli i gruas ishte zakonisht i kufizuar, i përcaktuar nga një strukturë sociale dhe ligjore që e vendoste atë në periferi të jetës publike. Por, të dhënat e periudhës midis shekujve III–I p.e.s., dëshmojnë një realitet krejt tjetër. Në këtë qytet, janë ruajtur 218 mbishkrime, që dokumentojnë lirin e rreth 600 skllëvërve, të realizuar “në praninë” e perëndive mbrojtëse si *Asklepi* (shumë i njohur në Butrint) dhe *Zeus Soter* (mbrojtës) – duke i dhënë aktit përmasë juridike, religjioze dhe publike. Në shumë prej këtyre mbishkrimeve, figura qendrore është gruaja: ajo vepron si kryefamiljare, administron prona, merr vendime të pavarura dhe nënshkruan akte liri pa pasur nevojë për një tutor mashkull. Këto fakte dëshmojnë për një formë të veçantë të organizimit shoqëror në Butrint – një territor në kufijtë e botës greke, në kapërcyell të epokës romake – ku roli i gruas ishte më i dukshëm, më i pavarur dhe më i institucionalizuar sesa në qytet-shtetet klasike greke. Edhe fati i skllëvërve të liruar në këto akte pasqyron një ndjeshmëri më të theksuar ndaj dinjitetit njerëzor dhe integritetit shoqëror, që e dallon Butrintin nga modelet më konvencionale të antikitetit.

Mesazhi

Historia e Argeias dëshmon se gruaja në Butrint kishte një status të veçantë, ndryshe nga vendi që zakonisht i njihej asaj në shoqëritë greke të kohës. Në një realitet antik ku gruaja shpesh përjashtohej nga jeta publike dhe juridike, çdo akt që tregon se një grua ushtron vullnetin e saj – për të çliruar një skllav, për të mbrojtur një të drejtë, ose për të ndikuar në jetën shoqërore – përbën një dritare të çmuar drejt një realiteti më kompleks dhe më të barazpeshuar gjinor sesa mendohet zakonisht për antikitetin.

E drejta për të liruar skllëvër nuk ishte thjesht një akt humanitar, por një shenjë e qartë e autoritetit moral, ekonomik dhe ligjor që ato gëzonin. Në mjedisin familjar, gruaja shfaqet si qendër e jetës së brendshme: edukatore e brezave, ruajtëse e trashëgimisë fisnore dhe administruuese e ekonomisë shtëpiake. Ajo mund të zotëronte prona, t'i menaxhonte vetë dhe të vepronte si kryefamiljare, duke u njohur edhe si dëshmitare e vlefshme në dokumentet e kohës. Në mjedisin religjioz, gratë kishin pjesëmarrje aktive, shpesh me funksione të larta si priftëresha apo interpretuese të orakujve – role që i jepnin atyre ndikim të ndjeshëm në jetën fetare dhe shoqërore të komunitetit. Në disa raste, kjo përfshirje shtrihej deri në nivelet më të larta të hierarkisë politike dhe fetare.

Ky realitet e vendos Butrintin jo vetëm si një qendër të rëndësishme kulturore dhe juridike, por edhe si një hapësirë ku zëri i gruas dëgjohej dhe vlerësohej, duke na dhënë një tjetër pamje të botës antike – më të larmishme, më të drejtë dhe më njerëzore..

Bibliografia

- Cabanes, Pierre, Vendi i gruas në Epirin antik, *Iliria* 13/2 (1983). f. 193-209. DOI : <https://doi.org/10.3406/iliri.1983.1833>



- CIGME II : Cabanes Pierre, Drini Faik, *Corpus des inscriptions grecques d'Illyrie méridionale et d'Épire 2. Inscriptions de Bouthrotos*, Coll. Etudes épigraphiques 2, Paris, 2007
- Drini, Faik, Budina Dhimosten, Mbishkrime te reja te zbuluara ne Butrint, Iliria 11/1 (1981), f. 227-234 DOI : <https://doi.org/10.3406/iliri.1981.1754>
- Drini, Faik, Ilirët dhe epirotët, (Paralele dhe veçanti), Iliria 19/2 (1989). Mbajtur në simpoziumin *Ilirët dhe Bota antike* / Der Symposium « Die Illyrer und die antike Welt ». f. 55-64. DOI : <https://doi.org/10.3406/iliri.1989.1537>

Kërcimi i nimfave rreth flakëve të përjetshme të Nymfeut të Apolonisë

Pranë Apolonisë hijeshonte një pyll i shenjtë ku toka nxirrte gaz dhe flaka lindte nga thellësia e dheut. Aty gjendej *Nymphaion*-i i Apolonisë. Flakët e përjetshme që dilnin nga burimet e nëndheshme i jepnin vendit një dritë magjepsëse, të artë, që nuk perëndonte kurrë: gjysmëdritë e gjysmëëndërr. Ishte vendi ku nimfat e ujit vallëzonin veshur me tisin e bardhë dhe rrezet e dritës.

Batea, priftëreshë e re, sapo ishte caktuar për t'u kujdesur për harmoninë e vendit dhe për t'i shërbyer Apolonit, hyut të dritës dhe muzikës. Të moshuarit pëshpëritnin nën zë se Batea kish lindur një natë pa hënë, kur flakët e *Nymphaion*-it ishin ngritur aq shumë lart, sa kishin prekur qiellin. Të moshuarit thoshin se kjo ishte një shenjë dhe Batea kishte lindur e bekuar nga vetë nimfat.

Çdo vit, në prag të pranverës, Apolonia gjallërohej nga një festë e shenjtë: *Nymphaia*. Burra të rinj merrnin pjesë në gara në nder të hyjnive të pyllit dhe ujit. Vajzat e gratë me flokët e artë dhe veshjet e stolisura me lule pranvere, vallëzonin rreth flakëve Kërcimin e Nimfave. Kori i vajzave në moshën e martesës magjepsnin të pranishmit duke kënduar koralet e nimfave. Në thellësitë e pyllit, fshehur mes pemëve të larta dhe zërave të kafshëve, kumbonte ëmbël fryma e flautit të Panit. Gjysmë-njeri, gjysmë-dhi, muzikanti hyjnor dilte nga errësira vetëm gjatë festës për të luajtur melodi që depërtonin deri në zemër të qytetit.

Në kulmin e festimeve, jehonte gara muzikore: instrumentistë dhe këngëtarë garonin për lavdinë e Apolonit.

Batea, ndonëse kishte një zë të rrallë nuk merrte pjesë në gara. Kur flakët fillonin të rriteshin, ajo këndonte himnin e fshehtë që e njihte vetëm ajo, e që drithëronte tokën. Ajo e ruante në shpirt me kujdes himnin që ia kishte përcjellë nëna priftëreshë, para se ajo të largohej me natën e pafund. Ishte kënga e natyrës, e vetmja që mbante të ndezura flakët dhe ruante ekuilibrin mes botës së të gjallëve dhe asaj të hyjnive.

Prej kohësh, shumë udhëtarë kishin ardhur nga vise të afërta e të largëta, në përpjekje për të zbuluar burimin e zjarrit të përjetshëm. Por ndër ta, një i huaj i panjohur solli me vete një heshtje të ftohtë, një mungesë ndjeshmërie që e tronditi Batean deri në thellësi të shpirtit. Ai nuk u habit nga festimet, as nga bukuria, harmonia, loja e trupit dhe shpirtit. Nuk e ndjeu muzikën si të tjerët, nuk e dëgjoi zërin e Panit, nuk u magjeps nga nimfat. Kudo ku ai shkelte linte një gjurmë të zezë. Gjithçka që ai prekte vyshkej.

Ndërsa i qasej vendit të shenjtë, natyra nisi të ndryshojë. Flakët u dobësuan, vendin e dritës e zuri errësira. Zëri i Panit nuk dëgjohej më. Në natën më të errët të jetës së saj, Batea kuptoi se shenjtëria e këtij vendi duhej mbrojtur. Ajo e udhëhoqi të huajin në qendër të pyllit, atje ku flaka e vjetër digjej pa pushim. Aty hoqi vellon e saj të bardhë, e vuri në tokë dhe nisi të këndonte për të fundit herë himnin e lashtë.

Një valë e padukshme fryme qiellore e ringjalli zjarrin dhe i zgjoi hyjnitë. Zëri i saj u ngrit mbi flakë dhe çau errësirën me forcë. Nga hija, dolën vajzat e bardha, nimfat, që u bashkuan me Batean në rreth, duke kërcyer rreth zjarrit që arriti qiellin.

Në mëngjes, banorët e Apolonisë e gjetën të huajin të vetëm, gjunjëzuar pranë flakëve, me sytë e mbushur me një dritë që nuk ishte e kësaj bote. Ai nuk fliste, veç shihte i përhumbur flakët e përjetshme. Batea nuk ishte më. Në ujërat e shenjta lundronte një lule e bardhë, një

shenjë që ajo tani ishte bërë njësh me nimfat, me flakën, me këngën e përjetshme të vendit. Që nga ajo ditë vatra e zjarrit u gjallërua dhe nga flakët e përjetshme jehon himni i jetës!

Periudha kohore: Prej shek. VII p.e.s.

Përmbledhje historike e periudhës

Në qytetin antik të Apolonisë, themeluar nga kolonë *korintas* dhe *korkyras* në shek. VII p.e.s. në brigjet e Adriatikut (afër Fierit të sotëm), ka ekzistuar një *nymphaion* – një vend i shenjtë i kushtuar nimfave të ujit, që besohej se banonin në burime të shenjta dhe mbronin jetën, pjellorinë dhe harmoninë natyrore. Ky *nymphaion* ndodhej në një zonë me burime të gazit natyror që digjej vazhdimisht, duke krijuar flakë të përhershme. Ato nuk shuheshin kurrë dhe i jepnin vendit një përmasë mistike, ndaj ai ishte vend adhurimi i nimfave dhe i Apolonit, perëndisë së dritës dhe muzikës.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Nymphaion-i lidhej me një orakull të veçantë, i cili përmendet në tekstet antike, por vendndodhja e tij mbetet ende e panjohur. Tri nimfa, të përfaqësuara shpesh në artin skulpturor të Apolonisë, mendohet se qëndrojnë në origjinën e kësaj fuqie orakullore. Në nderim të tyre, si pjesë e kultit të natyrës dhe hyjnive ujore, zhvilloheshin edhe festimet e njohura si *Nymphaia*, që përfshinin gara gjimnastikore të dokumentuara që nga shekulli II p.e.s. Kushtimi i tyre hyjnive të natyrës, që përfaqësoheshin shpesh përmes korit, si dhe prania e Panit, hyut të muzikës dhe natyrës së egër, muzika e të cilit besohej se dëgjohej deri në qytet, dëshmojnë me gjasë edhe organizimin e një konkursi muzikor. Relieve, monedha dhe figurina të zbuluara në Apoloni paraqesin nimfa që vallëzojnë në rreth me gjeste të hijshme, duke mbajtur instrumente muzikore ose me duart lart përreth një simboli drite – shpesh në shoqërinë e Apolonit.

Në Apoloni, nimfat nuk ishin thjesht figura mitologjike zbukuruese, por qenie që nderoheshin dhe adhuroheshin nga banorët. Kërcimi i tyre rreth flakëve shprehte ciklin e jetës, pranverën, pastrimin shpirtëror dhe bashkëjetesën me hyjnoren – një rit që mishëronte harmoninë mes natyrës dhe njerëzimit.

Sqarim: emri i personazhit kryesor frymëzohet nga emir ilir Bato (Batea).

Mesazhi

Historia e Bateas nuk është thjesht një legjendë për një vend të shenjtë apo për një këngë të harruar. Ajo është një kujtesë e fuqishme se natyra ka shpirt, por nuk ka zë. Ajo flet përmes flakës, përmes ujit, përmes heshtjes dhe pret që dikush ta dëgjojë. Batea bëhet simbol i njeriut që zgjedh të mos e sundojë natyrën, por ta ndiejë dhe ta mbrojë, edhe me çmimin më të lartë, vetësakrifikimin. Në një botë që gjithnjë e më shumë shurdhohet ndaj harmonisë së gjërave të gjalla, kjo histori na kujton se vetëm me këngë të brendshme, dashuri të thellë dhe sakrificë të vërtetë mund të ruajmë dritën që mban gjallë jetën. Flaka e përjetshme nuk është zjarr, por është kujdesi ynë.

Bibliografia:



- *CIGME 1.1* : Cabanes, Pierre, Ceka, Neritan, Corpus des inscriptions grecques d'Illyrie méridionale et d'Épire. I. Inscriptions d'Épidamne-Dyrrachium et d'Apollonia. 1. Inscriptions d'Apollonia, Coll. Etudes épigraphiques 2, Paris, 1995
- Korkuti, Muzafer, Kulti i ujit dhe zjarrit në Iliri (Tiranë: Studime Ilire, 1987).
- Quantin, François, De l'invention d'un lieu sacré à la naissance d'un sanctuaire. L'exemple du Nymphaion d'Apollonia d'Illyrie, në Lafond Yves, Michel Vincent (edt) Espaces sacrés dans la Méditerranée antique, edited by, Presses universitaires de Rennes, 2016, <https://doi.org/10.4000/books.pur.45730>
- Robert. Elsie, Albanian Folktales and Legends (London: I.B. Tauris, 2001).

Ulpiana (Iustiniana Secunda) dhe dedikimi i Justinianit

Unë jam Dardani, shkrues i dorëshkrimeve të shenjta dhe ruajtës i historive që nuk shkruhen në libra, por në gurë, për sytë e atyre që dinë të lexojnë pa fjalë. Atë mëngjes, mësova diçka që nuk më ishte thënë kurrë me zë: “Guri që vihet në themelet e besimit, flet më shumë se çdo dekret!”

Pas tërmetit që kishte përmbysur muret dhe altarët, pluhuri i vjetër po zëvendësohej nga gurë të rinj. Perandori Justiniani, krenar për rrënjët e tij dardane, kishte urdhëruar rindërtimin e qytetit dhe i kishte dhënë atij një emër të ri - *Justiniana Secunda*. Ishte më shumë se një rindërtim: ishte një akt kujtese dhe pushteti, një thirrje që gjaku dardan s’kishte vdekur, por po ngjallej në gurë të freskët dhe mozaikë që ndriçonin në diellin e këtij gadishulli.

Mes ndërtimeve të sapongritura shquhej bazilika e re, në brendësi të të cilës do të zinte vend një mozaik i rrallë, i punuar me kujdes e mjeshtëri. Gurët e vegjël do të zgjidheshin një e nga një nga guroret e qytetit që po ngrihej mbi gërmadhat e të vjetrit, si për të rrënjësuar në vetë themelet e besimit fuqinë që rridhte nga e shkuara.

Heeej URBEM DARDANIAE o heeej (në qytetin e Dardanisë)...

Atë mëngjes të ftohtë pranvere, ndërsa në qytet ndihej ende era e themeleve të sapohedhura, Perandori Justiniani dhe bashkëshortja e tij, Teodora, morën një vendim që do të habiste shumëkënd. Në vend që të mbledhnin popullin në një shesh publik, siç e donte zakoni i lashtë për shpallje të tilla, ata zgjodhën të hynin në heshtje në bazilikën e saponërtuar, larg zhurmës së turmës. Ajo nuk ishte thjesht një ndërtesë për lutjet e tyre. Në të vërtetë, as përkushtimi i bërë atë ditë nuk i drejtohej adhurimit hyjnor. Ishte një akt simbolik, i mbushur me domethënie juridike dhe shpirtërore.

Në një qoshe të errët të bazilikës, Teodora uli kokën ndërsa Justiniani fliste me zë të ulët, por të prerë. Ishte më shumë se një fjalim – ishte pohim për rendin e ri që po ndërtohej. Ishte ai çast, më shumë se çdo ceremoni madhështore, që dëshmonte për ndryshimin e kohës. Ata nuk e zgjodhën rastësisht atë ndërtesë. Ajo ishte më e dukshme, më e përfolura në qytetin e ri. Dhe pikërisht për këtë, u bë vendi i zgjedhur për një akt thellësisht politik. Deklarata e tyre, megjithëse e bërë larg turmës, ishte më publike se çdo fjalim në shesh. Ishte një pikë kthese në marrëdhëniet mes kishës, perandorisë dhe vetë qyteteve. E askush nuk e harroi më. As peshkopët. As qytetarët. As historia.

Heeej URBEM DARDANIAE o heeej (në qytetin e Dardanisë).

Periudha kohore: Shek. VI e.s.

Përmbledhja historike e periudhës

Ulpiana ndodhet në afërsi të fshatit Graçanicë, në juglindje të Prishtinës/Kosovë. Qyteti gjendet në një pozicion strategjik përgjatë rrugëve të rëndësishme antike që lidhnin Dardaninë me provinca të tjera romake. Ai u themelua në shek. II e.s., gjatë periudhës së perandorit Trajan (98-117), dhe mori emrin *Municipium Ulpiana* nga emri i tij familjar, *Ulpus*. Në shek. II–IV dallohet për një zhvillim të madh ekonomik, duke bërë që Ulpiana të jetë një nga qytetet më të rëndësishme të Dardanisë romake. Perandori Justinian I (482-565) ka qenë me origjinë nga provinca e Dardanisë, territoret e Kosovës së sotme. Pas një tërmeti të fuqishëm në shek. V e.s., që e shkatërroi Ulpianën, Justiniani rithemloi qytetin me emrin *Iustiniana Secunda*.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Sipas Prokopit të Çezaresë (De. Aed., IV,1, 28-30) “...në mesin e Dardanëve, që nga lashtësia, ekzistonte një qytet i quajtur Ulpiana. Muri i saj rrethues ishte dëmtuar rëndë dhe kishte humbur funksionin, ndaj u desh të shembej pjesa më e madhe e tij. Justiniani bëri shumë përmirësime në këtë qytet, duke i dhënë pamjen e bukur që ka sot; ai e quajti *Iustiniana secunda*...”

Një zbulim i rëndësishëm arkeologjik, i verës së vitit 2023, lidhet me mbishkrimin e Perandorit Justinian I dhe bashkëshortes së tij, Teodora, i cili u gjet në mozaikun e një kishe të madhe të periudhës së antikitetit të vonë, e ndërtuar nga Justiniani. Teksti përmban dedikimin latin *urbs Dardaniae*, që do të thotë “qyteti i Dardanisë”. Kemi të bëjmë me një nga dedikimet më të rralla të çiftit perandorak në botën latine të periudhës romake të vonë.

Mesazhi

Rëndësia e veçantë e këtij zbulimi për historinë e Dardanisë antike dhe të Kosovës është disaplanëshe: dëshmohet lidhja e drejtpërdrejtë e Perandorit Justinian me vendlindjen e tij. Ky mbishkrim në latinisht sqaron se ishte vetë perandori Justinian që nisi personalisht ndërtimin e qytetit të *Iustiniana Secunda*. Akti shpreh njëherazi krenarinë për rrënjët lokale dhe rifortësimin e identitetit në kuadër të perandorisë. Rëndësia është politike: dedikimi nuk është fetar, pasi përfaqëson dedikimin e parë të njohur për një qytet. Kemi të bëjmë me një vendim politik, i cili është marrë brenda një hapësire kishtare, duke hedhur dritë mbi faktin se gjatë sundimit të Justinianit, roli i kishës evoluoi në një nivel politik.

Bibliografia

- Goddard, Christophe *et alii*, Ulpiana and Late Antique Dardania: Archaeological Investigations and the Rebuilding under Justinian, *Studies in Balkan Archaeology*, 2021
- Hajdari Arben, Goddard Christophe, Berisha Milot, Une nouvelle dédicace de foundation de Justinien et dhe Théodora à *Iustiniana Secunda* (Ulpiana, Graçanica, Kosovo), *Antiquité Tardive* 32 (2024), f. 183-208
- Šašel Kos Marjeta, Ulpiana (Dardania) in Late Antiquity, *Late Antique Archaeology* 2010

Kujtimet që ngjalli *balisca (vera)* ilire

Festa në një vilë të vogël në periferinë e Romës ishte vetëm për pak të ftuar: dy tregtarë verërash nga viset ilire dhe Titus Aelius Varro, një ushtar me flokë të zbardhur dhe sy të thellë. Ai kishte shërbyer për shumë vite si *centurion* (ushtarak) në provinca të ndryshme të perandorisë.

I zoti i shtëpisë bëri shenjë dhe ushqimi e pija u shërbyen me bollëk. Kur mësoi se tregtarët vinin nga viset ilire, Titusi menjëherë hyri në bisedë me ta. Sa herë dëgjonte për Ilirinë, diçka brenda vetes i zgjohej papritmas. Dalëngadalë, iu bë sikur zemra do i shpërthente nga kraharoni.

– Nga cili vend vini? – pyeti ai, duke u përpjekur të mbyste emocionin.

Tregtari më i ri, një burrë me sy të mprehtë dhe mjekër të dendur, iu përgjigj me buzëqeshje.

– Nga Dyrrahu. Sapo kemi sjellë në treg verën më mirë që kemi – baliska e quajmë. Shërbëtori ngriti amforën mbi supe. Sytë e Titusit u fiksuan tek vula që varej në qafën e enës - një shenjë e vogël me gjethe rrushi, në zemër të saj germa D, monogrami i Dyrrahut. Ai e njihte këtë simbol. U zbeh. Një ndjesi e largët sikur po e mbyste, një vegim nga një e kaluar që s'mund të kthehej më. Ndërsa piu gllënjën e parë të verës, iu shfaq silueta e saj dhe në vesh i kumboi e qeshura e saj.

Titusi e njohu Dionën gjatë shërbimit ushtarak disa mujor që bëri në rrethinat e Dyrrahut. Një ditë vere, ndërsa kërkonte rrugën për në kamp e pa atë vajzë të bukur, tek kujdesej, bashkë me të tjerë, për vreshtat e familjes, që njiheshin si më të mirat në zonë. Babai i saj ishte mjeshtri më i njohur i prodhimit të verës “baliska”. Tradita ishte përcjellë nga brez në brez dhe ai e ruante me përkushtim, si një pasuri të shenjtë. Baliska për vreshtarët e Dyrrahut, nuk ishte thjesht një pije, por një lidhje e gjallë me të kaluarën, me tokën që ushqente njerëzit e kësaj zone, dhe me hyjnitë që i bekonin të mbjellat.

Në festë kishte nisur muzika. Kurtizanet dhe valltaret mbushën sallën. Titusit iu kujtua festa e parë mes ilirëve.

– Ju jeni të çuditshëm – u tha ai tregtarëve që dukej se nuk ishin të mësuar me këtë natyrë festimesh. – Në festat tuaja, gratë marrin pjesë si burrat, kuvendojnë e pinë bashkë me ta.

Tregtarët buzëqeshën, por në sytë e tyre ndihej një respekti heshtur për traditat që vinin nga toka e tyre.

– Në fshatin tonë, gratë janë zemra e çdo feste, – tha tregtari më i vjetër. – Ato kujdesen për vreshtat, për verën dhe për historitë që i tregojnë aq bukur. Pa to, festa do të ishte vetëm një ditë e zakonshme.

– Ju ilirët hani ulur dhe dini të festoni deri në agim, pa u turbulluar nga pija si të tjerë. Si arrini vallë ta shquani çastin për t'iu larguar tundimit?

Tregtarët panë njëri-tjetrin në sy me shpoti. Më i riu ngriti kindin e mantelit dhe i tregoi brezin që mbante veshur.

– E kemi traditë vetëkontrollin duke shtrënguar brezin...

Titiusi buzëqeshi. Ai vazhdoi të pinte nga vera e ëmbël dhe ndiente se vegimi i Dionës bëhej gjithnjë e më i gjallë. Ai do kishte dashur të ishte aty në zemër të Ilirisë, pranë Dionës me flokët e valëzuar dhe lëkurën e kristaltë, në çdo festë mes vreshtave të gjelbëruara, mes aromës së verës së re dhe këngëve që ngriheshin drejt qiellit.

Ai do kishte dashur shumë ta linte luftën larg, të jetonin të dy buzë detit dhe të zgjoheshin çdo mëngjes nga muzika e dallgëve. Atë natë nuk donte ta humbte vegimin e Dionës. U ngrit, mori amforën në krahët e tij dhe u largua nga tryeza, me kujtimet që e mbështillnin me ngrohtësi. U afrua tek dritarja dhe ju bë sikur, përtej detit, e pa atë vajzë të bukur ilire që kjo verë e ëmbël ja kujtoi sot. Sa do të donte që atë natë, balisca të mos mbaronte kurrë!

Periodha kohore: Nga fundi i shek. IV p.e.s – shek I e.s.

Përmbledhje historike e periudhës

Vera te ilirët është një element i veçantë i trashëgimisë shpirtërore dhe materiale, që përfshin jo vetëm kulturën e prodhimit (ndonëse e kufizuar), vreshtarinë dhe konsumin e verës, por edhe festimet me karakter shoqëror, mbretëror dhe religjioz. Dëshmitë e para arkeologjike rreth konsumit të verës dokumentohen që nga shek. VI p.e.s. Kontaktet me grekët dhe romakët e thelluan traditën e konsumit të verës, si produkt me vlerë sakrale dhe socializuese, që pihej në raste festimesh komunitare, në festa përkushtuar hyjnive, apo në kuvende.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Paralelisht me gjetje të shumta arkeologjike që lidhen me transportin e verës (amfora), përzierjes dhe takëmeve të servisit që lidhen me konsumin (enë fine të tryezës), dokumentohen të dhëna burimore mbi prodhimet lokale të verës. Kështu, sipas Aristotelit (832a. 22) njohim një prodhim lokal të verës nga mjalti, “tek Ilirët e quajtur taulantë”, e cila bëhej nga hojet e mjaltit dhe rezultonte të ishte një pije shumë e fortë dhe shumë e ëmbël. Nga Plini (XIV. 2) mësojmë se vera më e njohur ilire ishte *balisca*, prodhuar nga rrushi Balisk që kultivohej në territorin e Dyrrahut, e eksportuar në Romë para periudhës së Augustit, dhe që vjetrohej shumë mirë. Ka studiues që mendojnë se vreshtat e Bordosë mund të kenë prejardhje nga ky varietet i Dyrrahut. Banketi ilir dhe veçoritë kryesore krahasuar me traditën greko-romake, përmenden në burimet antike (Theopompus, *FGrH* 115 F 38; *ap.* Ath., 11.476d).

Mesazhi

Kjo pjesë synon të vendosë theksin tek respekti dhe vlerësimi i traditave kulturore, duke nxjerrë në pah dimensionin njerëzor dhe universal që lidhet me ndjenjat e pastra, mallin, kujtesën dhe dëshirën për përkatësi, pavarësisht dallimeve në prejardhje kulturore apo etnike. Përmes kontrastit, teksti synon të nënvizojë elementët të rëndësishëm si mençurinë e heshtur, thelbin njerëzor që ruan ekuilibrin midis gëzimit dhe vetëpërmbytjes, mes ndjeshmërisë dhe përkushtimit.

Kuptimi në kontekstin e sotëm

Ngjarja i tejkalon kufijtë kulturorë duke sugjeruar se vlerat thelbësore njerëzore, si dashuria, ruajtja e traditave, kujdesi për tjetrin, për natyrën, janë universale dhe i tejkalojnë kufijtë gjeografikë dhe kronologjikë. Nëpërmjet figurës së vajzës, përfaqësuar si një vegim i pastër



dhe ideal i dashurisë dhe natyrës, synohet reflektojmë mbi çfarë ka vërtetë rëndësi në jetën njerëzore: ndjenja e përkatësisë, paqes dhe kujtesës së gjallë që jeton në traditën e një populli.

Bibliografia

- Etienne, Roland, L'Origine épirote du vin de Bordeaux antique", në P. Cabanes (edt.), *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité: actes du colloque international de Clermont-Ferrand (22-25 octobre 1984)*, Clermont- Ferrand 1987, f. 239-243.
- Lahi, Bashkim, Kultura e verës si rafinesë në kulturën qytetare ilire – rasti i Lissos, Iliria 36 (2012), f. 173-185
- Shpuza, Saimir, Importi dhe prodhimi i verës dhe vajit në Ilirinë e Jugut, Iliria 33 (2007), f. 219-232



Via Egnatia, Ad Quitum dhe centurioni Marcus Sabidius Maximus

Dielli ishte ngritur mbi kodrat rreth rrugës Egnatia. Stacioni i sapondërtuar Ad Quintum, atë ditë zhurmonte nga hapat e udhëtarëve dhe zërat në gjuhë të përziera nga provinca të ndryshme, ndërsa dielli i pasdites digjte gurët që vishnin oborrin.

Ushtarë të lodhur, tregtarë të ngarkuar me mallra të fisme dhe fshatarë të heshtur rrinin nën hijen e mureve. Disa prisnin radhën për t'u freskuar në termë, të tjerë prisnin karvanët për të vazhduar udhëtimin. Nga hani dëgjoheshin kupa që përplaseshin dhe aroma e mishit të pjekur përhapej në ajër.

Në një tryezë rrinte një burrë i moshuar me shpinën drejt, por vështimin e mbërthyer diku larg. *Marcus Sabidius Maximus* – dikur një djalë i ri e i fuqishëm nga Dyrrahu, tani ishte veçse një i huaj në vendin e tij, me rrudha të thella e duar të shtrembëruara nga koha. Kur një grup udhëtarësh më të rinj i kërkuan t'u tregonte për shpatën e tij dhe rripin me stemën e legjionit, ai buzëqeshi dhe nisi të flasë.

– Nuk e mbaj më për të luftuar,- tha, duke e vështuar tehun e vjetëruar. - Tani është veçse një kujtim...”

Ata e dëgjonin me kureshtje, ndërsa ai fliste me qetësinë e dikujt që s'kërkon të lavdërohet, por thjeshtë të çlirohet nga barra e kujtimeve që i rëndon mbi supet e drobitura. Maksimus e kishte kaluar jetën mes armëve. Ai shtriu dorën drejt kupës dhe piu një gllënjë të vogël. Pastaj i hodhi një sy rripit të legjionit që varej në krah të tij.

– Shpata ma ka shpëtuar jetën tri herë,- shtoi me një zë të butë. – Nga Moesia e Epërme, në Siri, e më pas në Daki. Për trimëritë e mia, vetë Perandori Hadrian më vlerësoi me medalje nderi”.

Medalje nderi për gjithë fitoret...por barrë e rëndë në shpirt për jetët që i kishte prerë përgjysmë. Nuk e dinte më, në ç'fund humnere dergjej ajo medalje trimërie. Ndërsa netët kalonin mes makthesh që zgjasnin deri në agim.

– Nuk ishin të mijat, as luftërat, as betejat! – tha me zë të ulët dhe sytë e mbushur me mallëngjim.

Pas gjithë atyre viteve mes luftërash, ai dëshironte që pjesën e mbetur të jetës ta kalonte në paqe, larg armëve, larg dhimbjes. Zemra e tij e lodhur kërkonte qetësi - një vend ku të dëgjonte zhurmat e jetës jo dhimbjet e saj, të fshihej nën hijet e drurëve dhe t'u dorëzohej tingujve të qetë të natyrës. Dhe Scampa, me kodrat e saj të buta dhe ajrin e pastër, e ftonin të qëndronte në stacionin e tij të fundit, përjetësisht!

Ndërsa nata binte mbi hanin në Ad Quintum, zhurma e kupave dhe të qeshurave përziej me gëzimin dhe lodhjen e udhëtarëve mes lindjes dhe perëndimit, që kishin gjetur strehë aty, pranë rrugës Egnatia. Muret kishin dëgjuar mijëra histori - rrëfime trimërie, humbjeje, ëndrrash dhe dhimbjesh. Teksa qetësia e natës përhapej ngadalë mbi kodrat përreth, stacioni romak mbeti një dëshmitar i heshtur i jetës që vazhdonte të gumëzhinte - me ëndrra, beteja të reja dhe shpresa që gjallëronin.

Periudha kohore: Shek. II e.s.

Përmbledhja historike e periudhës

Via Egnatia ishte një rrugë e lashtë romake që ndiqte luginën e Shkumbinit, e cila u ndërtua në shek. II p.e.s (146-120) nga prokonsulli romak Gaius Egnatius, prej nga e mori dhe emrin. Ajo ishte zgjatim i *Via Appia*, rruga e njohur që lidh Romën me portin e Brindisit. Në territorin tonë kishte dy degëzime: nga Epidamne-Dyrrahu dhe Apolonia, që bashkoheshin në afërsi të qytetit të Skampit (Elbasanit), për të vijuar në Selanik (Thessaloniki), Maqedoninë antike dhe më tej në Kostandinopojë (Stamboll), duke përshkruar Ballkanin, me një gjatësi rreth 1120 km.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Via Egnatia kishte disa stacione: nga degëzimi që niste në Dyrrah, stacioni i dytë ishte *Ad Quintum*, që përkon me kompleksin e termeve dhe nymfeut romak në Bradashesh. Stacionet romake ishin pika të rëndësishme rrugore që shërbenin për pushim, furnizim dhe akomodim të udhëtarëve, ushtarëve dhe postierëve gjatë periudhës së Perandorisë Romake. Në të njëjtën periudhë që ndërtohet stacioni *Ad Quintum*, në shek. 2 e.s., datohet dhe një stelë funerare (ekspozuar në Muzeun Etnografik të Elbasanit), që i përket *Marcus Sabidius Maximus*, nga fisi Aemilia, me origjinë nga Dyrrahu, oficer i lartë në ushtrinë romake. Në fund të jetës ai u vendos në Scampa.

Mesazhi

Nëpërmjet një historie njerëzore, synohet të trajtohen simbolikat e ndryshme që mbart rruga Egnatia. Ajo përfaqëson bashkimin e kulturave dhe qytetërimeve të Lindjes me ato të Perëndimit. Përmes kësaj rruge ka udhëtuar edhe dimensionin shpirtëror, duke përhapur besime të ndryshme. Ajo është po ashtu një trajektore që pasqyron dyzimin e natyrës njerëzore: nga njëra anë, shkatërrimi që sollën luftërat e shumta me legjionet romake; nga ana tjetër, krijimi dhe ndërtimet e reja që sollën zhvillim dhe rindërtim. Kjo rrugë simbolizon transformimin e vazhdueshëm, sepse me lëvizjen e njerëzve, nuk zhvendosen vetëm mallrat, por mbi të gjitha idetë dhe identitetet. Në fund, *Via Egnatia* është një trashëgimi kulturore dhe historike, që lidh të shkuarën me të tashmen e territoreve përmes të cilave kalon.

Bibliografia

- Anamali, Skënder, Ceka Hasan, Deniaux Elisabeth. *Corpus des inscriptions latins d'Albanie*, Rome 2009
- Ceka Neritan, Papajani Lazer. *Nymfeu dhe termet e stacionit Ad Quintum*, Monumentet 4 (1973), f. 29-53
- Fasolo, Michele. *Via Egnatia I. Da Apollonia e Dyrrachium ad Herakleia Lynkestistidos*, Romë, 2003

Gjiri i Gramës – shpresa e lundëtarëve

Era frynte nga juglindja me një egërsi që copëzonte dallgët e Jonit në kreshta shkume. Ndërsa deti, i trazuar dhe i zymtë, përplaste valët me tërbim në brigjet e ashpra të Karaburunit. Qielli, i mbuluar nga re të zeza, ngjante i pashpresë. Mes kësaj furtune, një anije bizantine, me velat e dëmtuara dhe direkun e thyer, luftonte me dallgët. Në bord ndodhej vetë perandori Gjon Paleologu. Kërkonte me ngulm një strehë për t'i shpëtuar shkatërrimit. Aty, mes shkëmbinjve të egër të Karaburunit, një gji i panjohur u shfaq papritmas, duke sjellë një shkëlqim në fytyrat e trazuara të ekuipazhit.

Të nesërmen, stuhia ishte shuar. Dielli ndriçonte faqet e lagura të shkëmbinjve, duke zbuluar mbishkrime të lashta - emra të harruar, lutje të marinarëve, dëshira të mërgimtarëve që kishin ndalur dikur në të njëjtin gji. I heshtur, perandori qëndroi për një kohë të gjatë përballë tyre. Shpresa dhe frika ishin skalitur përjetësisht në gur.

Ato gjurmë i kujtuan se, përballë natyrës dhe fatit, njeriu - qoftë edhe Perandor - është veçse një qenie e brishtë. Ai vendosi të linte edhe vetë një gjurmë në shkëmb. Nuk shkroi një lutje, as një dëshirë, por një dëshmi të thjeshtë: se në vitin e largët 6877 të kalendarit bizantin, ai kishte ndalur aty, si shumë të tjerë, përballë së njëjtës forcë të verbër. Ishte një akt njerëzor, një shenjë se kishte qenë aty, mes stuhisë, frikës dhe shpresës.

Kur anija u bë gati për të vazhduar rrugën, dielli tashmë ngrihej mbi ujërat e qetësuar të Jonit. Gjon Paleologu hodhi një vështrim të fundit drejt mbishkrimit që kishte lënë pas, pastaj u kthye, pa thënë asnjë fjalë, drejt detit të hapur. Udhëtimi drejt Romës kishte nisur - udhëtimi i shpresës së fundit, drejt brigjeve të Adriatikut, ku, në sallat e Vatikanit, Papa Urbani V mbante ende ndezur dritën e ndihmës së vonuar.

Periudha kohore: Nga shek. III p.e.s. – deri në shek. XV e.s. (madje edhe në periudhat moderne)

Përmbledhje e periudhës historike

Gjiri i Gramës, në anën perëndimore të Gadishullit të Karaburunit dhe përballë ishullit të Sazanit, ka qenë i njohur që në antikitet si një strehë natyrore për anijet gjatë motit të keq dhe si vend me ujë të pijshëm të freskët. Emri “Grama” rrjedh nga greqishtja “gramma” që do të thotë shkrim, për shkak të qindra mbishkrimeve të gdhendura në faqet e shkëmbit nga detarë, ushtarë, pelegrinë, kapitenë dhe njerëz të zakonshëm që kalonin aty. Ky gji, me vendndodhjen e tij të izoluar në jug të Karaburunit, përfaqëson një nga rastet më unike të bashkëveprimit midis detit, njeriut dhe besimit në trashëgiminë shpirtërore shqiptare. Kjo është një temë që,

ndonëse e rrënjësuar në fakte historike, ka fituar përmasa mitike dhe sakrale në kujtesën kolektive të detarëve shqiptarë dhe më gjerë.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Gjiri fillimisht ka qenë shfrytëzuar si gurore. Mbishkrimet, mbi 1500 të tilla, të gdhendur në falezën e Gjirit të Gramës, nuk janë më të hershëm se shek. III p.e.s. Më të vonat datojnë në periudhën mesjetare; më tej ka mbishkrime latine të periudhës perandorake dhe mesjetare. Mbishkrimet përgjithësisht u drejtohen Dioskurëve – Kastorit dhe Poluks – hyjni shpëtimtare e mbrojtëse të detarëve dhe anijeve. Sipas formulës, shkruesi i kërkon ndihmë për njerëz të ndryshëm, anëtarë familjeje, bashkëudhëtarë, bashkëskllevër ose bashkëluftëtrë. Udhëtarët vijnë nga vise të afërta, por edhe të largëta, si Azia e Vogël : Ilion, Fokea, Heraklea, Ponti apo Palestina: Sebastia.

Në tërësinë e mbishkrimeve dokumentohen emra të personazheve të njohur historikë, siç është rasti i rivalit të Cesarit, Cnaeus Pompeius (ngjarjet e viteve 49-48 p.e.s.). Dokumenti më interesant i përket periudhës mesjetare, vitit 1369 e.s. dhe lidhet me praninë në Gjirin e Gramës të Mbretit të Romakëve Gjon Peloelut – perandori bizantin, i cili në 1369 shkoi fillimisht në Venecia e më pas në Romë për t'u takuar me Papë Urbanin V, në përpjekjet për të siguruar mbështetjen e tij në kuadër të përkeqësimit të situatës në Kostandinopojë, si edhe të përparimit të trupave turke.

Mesazhi

Gjiri i Gramës përfaqëson një shpëtim natyror dhe shpirtëror për njeriun e detit, një vend nderimi dhe komunikimi me të shenjtën, përpara se të përballesh me të panjohurën e detit. Në përballje me fuqinë e jashtëzakonshme të natyrës dhe rrënimin e një perandorie, edhe një perandor zbrit në thjeshtësinë e njeriut – duke kërkuar kuptim, shpresë dhe përjetësi jo në pushtet, por në një gjurmë të lënë në gur.

Bibliografia

- *CIGME III* : Cabanes, Pierre., Drini, Faik., Hatzopoulos, M. (coll), *Corpus des inscriptions d'Albanie (en dehors des sites d'Épidamne-Dyrrhachion, Apollonia et Bouthrôtos)*, École française d'Athènes, Paris 2016
- Hajdari Arben, Reboton Joany, Shpuza Saimir, Cabanes Pierre, Les inscriptions de Grammata (Albanie), *Revue des Études Grecques* 120 (2007), f. 353-294
- Fondi i gojëdhënave të Institutit të Kulturës Popullore, arkiva "Karaburun – Grama", regjistrime të mbledhura gjatë viteve 1970–1985.

Fitimtarë në përballjet fizike – Amfiteatri i Dyrrahut

Atë mëngjes deti ishte i qetë dhe anijet lundronin ngadalë drejt bregut të Adriatikut. Dielli rrezatonte mbi ujërat e kaltër. Dyrrahu, qyteti i lashtë, shfaqej ngadalë mbi një kodër të gjelbër. Udhëtarët kishin dalë në kuvertë me sytë nga bregu, duke pritur me padurim t'u shfaqej monumenti që i kishte sjellë nga skajet e perandorisë. Ai ishte amfiteatri i sapondërtuar, për të cilin flisnin të gjithë.

Epikadi, së bashku me të atin, kishin ardhur enkas për të ndjekur nga afër ceremonitë festive të përrimit të Amfiteatrit të Dyrrahut, i cili hapte dyert për herë të parë. Ata zbritën, shëtitën përmes rrugicave me kalldrëm që të çonin drejt qendrës së qytetit, mes zhurmës së hapave, aromës së verës dhe gëlqeres. Nga tavernat vinin zëra plot jetë, njerëz që pinin, bisedonin, diskutonin me zjarr. Në çdo tryezë flitej për gladiatorët më të zotë që do të luftonin sot në arenë. Nuk mbahej mend të ishte parë ndonjëherë një ndeshje me plot **dymbëdhjetë çifte gladiatorësh**, njëri më i fuqishëm e më i famshëm se tjetri.

– Eja, - i tha i ati, duke e drejtuar nga hyrja jugore e amfiteatrit. Hynë në freskinë e një galerie, ku ndaleshin pak kalimtarë. Aty, mbi një bllok guri, dukej një mbishkrim i lashtë. Epikadi u afrua dhe lexoi me zë të ulët fjalët që koha i kishte zbehur, por që ruanin ende gjallërinë e tyre: *“Kleosteni, i biri i Pontit, fitues në garën e karrocave me katër kuaj në Lojërat Olimpike. Ngritur në nder të qytetit dhe për lavdinë e perëndive.”* Epikadi e preku gurin, duke ndjerë peshën e historisë që mbartte. Ky nuk ishte thjesht një mbishkrim, por ishte lidhja me të kaluarën, me njerëzit që kishin lartësuar Dyrrahun dhe i kishin dhënë emër në botë. Ishte e para herë që prekte një dëshmi kaq të drejtpërdrejtë të një lavdie të largët, ku një i ri nga qyteti i tij, kishte garuar mes më të mirëve të botës dhe kishte fituar. Epikadi nuk tha asnjë fjalë, por brenda tij ndjeu një nderim të thellë për dikë që nuk e kishte njohur kurrë.

Ai hodhi sytë nga arena. Gladiatorët kishin nisur luftimet. Britmat e spektatorëve ngriheshin e binin si valë në qiellin e kaltërt të Dyrrahut, ndërsa historia dhe e tashmja përplaseshin në këtë betejë madhështore. Amfiteatri nuk ishte një monument i ftohtë, por ishte zemra e qytetit, vendi ku lavdia e të kaluarës dhe forca e sotme bashkëjetonin në një harmoni të përjetshme.

Periudha kohore: Gjatë shek. II-IV e.s.

Përmbledhja historike e periudhës

Qyteti i Dyrrahut, një ndër portet më të rëndësishëm të Adriatikut lindor, merr një rëndësi të veçantë në periudhën romake: Augusti vendosi aty një grup të madh veteranësh, me statusin e qytetarit romak, dhe qytetit i dha statusin juridik të kolonisë romake. Dyrrahu gjithashtu do të luante një rol të dorës së parë në rajon - arsye këto që shtruan nevojën e ndërtimit të një amfiteatri në qytet.

I ndërtuar në shek. II e.s., amfiteatri i Dyrrahut është një nga më të mëdhenjtë në Ballkan (të rrallë janë amfiteatrot në brigjet lindore të Adriatikut), me kapacitet rreth 15.000-20.000

spektatorë. Fakti që është ndërtuar në shpatullën jugperëndimore të kodrës së qytetit, i jep ngrehinës një pamje monumentale. Ballina është trekatëshe dhe e orientuar nga bregdeti.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Sipas një mbishkrimi (CJL III, 1, 607), gjatë përrimit të tij u organizuan lojëra me dymbëdhjetë çifte gladiatorësh. Ndonëse nuk është përdorur për gara olimpike në kuptimin klasik, amfiteatri mishëron idealin e spektaklit fizik, të nderit në përballje, dhe është simbol i lavdisë publike për fitimtarët. Tregimet lokale e lidhin amfiteatrin me garat e forcës dhe dyluftimeve, dhe me nderimin e atyre që në kohët më të hershme ishin kthyer nga Olimpia si fitimtarë: një nga emrat më të njohur është Kleosteni i Dyrrahut, i biri i Pontit, i cili fitoi në garën sportive të vrapimit me karroca me katër kuaj, në lojrat e Olympias (Pausania, VI 10, 6), dhe bëri një ofrandë të çmimit të madh, që paraqet karrocën, kuajt, drejtuesin e tyre dhe pronarin.

Mesazhi

Pjesa synon të nxjerrë në pah lidhjen e thellë ndërmjet së kaluarës dhe së tashmes, si dhe rëndësinë e kujtesës historike në formësimin e identitetit personal dhe kolektiv. Përmes syve të Epikadit, ne shohim se si një monument si amfiteatri i Dyrrahut-Durrësit nuk është vetëm një strukturë fizike, por edhe një vend ku lavdia e dikurshme dhe forca e sotme bashkohen, duke krijuar një harmoni të përjetshme. Në thelb, fuqia e kujtesës, lidhja me rrënjët, dhe se si e kaluara vazhdon të formësojë të tashmen dhe të ardhmen janë në themel të kësaj historie.

Bibliografia

- Islami Selim, Historia e Dyrrahut në Antikitet (Tiranë: Akademia e Shkencave, 1984).
- Toçi Vangjel, Amfiteatri i Dyrrahit, Monumentet 2 (1971), f. 37-42.
- Santoro Sara, Moderato Michele, Il paesaggio urbano e territoriale di Epidamnos - Dyrrachium/Dyrrachion in una visione diacronica, në Mastrocinque Giovanni (edt.) *Paesaggi mediterranei di età romana, archeologia, tutela, comunicazione*, Bari 2017, f. 39 – 47
- Beste Heinz Jürgen, von Hesberg Henner, Shehi Eduard, Das Amphitheater in Dyrrachium Rekonstruktion und Bedeutung (mit einem Beitrag von Dominik Lenyel und Catherine Toulouse), *RM* 129 (2023), f. 152-235.

Liqeni i Seferanit dhe kushtimet e “të bukurave të dheut”

Rreth brigjeve të liqenit, sapo kishin nisur të çelnin gjethet e para të zambakëve të bardhë. Shumë shpejt vashat e fshatit do të merrnin pjesë në ceremonitë për nder të Hyjneshës së Ujit. Që nga kohët e lashta, liqeni kishte qenë vend i shenjtë. Vashat e reja, në prag martese, zgjidhnin figurinat më të bukura, të zbukuruara me kurora, me boçe lulesh ende të paçelura, ashtu si ato vetë, dhe ia dhuronin ato hyjneshës për t'i mbrojtur, për t'i sjellë pjellori tokës dhe lumturi familjes. Në ato figurina vashat e reja kishin derdhur dëshirat dhe ëndrrat, lutjet dhe shpresat. Me to, vashat kërkonin mbrojtjen e hyjneshës, miratimin për të ecur përpara në jetë, dhe bekimin për të ndërtuar familje, për të lulëzuar si zambakët që çelnin çdo pranverë mbi sipërfaqen e liqenit.

Në mbrëmjen e fundit të pranverës, ndërsa ajri mbante ende aromën e tokës së lagësht dhe uji rridhte pa zë, vashat e reja zbritën drejt liqenit. Të veshura me rroba të bardha, me flokët e lëshuar dhe të zbukuruar me lule të egra, ato ecnin zbathur mbi barin e njomë. Secila mbante në duar figurinën e vet, imazhin e bukur të dëlirësisë së tyre. Gratë e moshuara i ndiqnin nga larg, pa folur, por krenare. Ato e njihnin mirë këtë rrugë, pasi e kishin ndjekur vetë më parë, në të njëjtën ceremoni të lashtë.

Arritën pranë liqenit të bekuar. Nga larg, në heshtjen e natës, dëgjoheshin cicërimat e zogjve dhe fëshfërima e lehtë e dallgëzave mbi ujë. Vashat, njëra pas tjetrës, u përkulën dhe vendosën figurinat e tyre mbi gjethet e gjera të zambakëve. Me kujdes, pa zhurmë, i shtynë lehtë mbi sipërfaqen e ujit. Në dritën e butë të hënës, figurinat nisën të lundronin. Disa më ngadalë, të tjera më shpejt, u zhdukën ngadalë nga sytë, duke humbur në heshtjen dhe thellësinë e liqenit.

Të nesërmen, kur dielli preku për herë të parë ujin, mbi sipërfaqen e liqenit çelën zambakë të rinj, të bardhë, të pastër, si vetë shpirti i vashave. Hyjnesha e Ujit i kishte pranuar lutjet e tyre. Në netët e qeta të pranverës, kur hëna pasqyrohej mbi sipërfaqen e liqenit dhe era sillte aromën e zambakëve të ujit, nga shtëpitë dilnin tinguj të ëmbël, këngë të vjetra, lutje të gjata, urime dhe rrëfime pa fund për vashat që ishin pranuar nga Hyjnesha e Ujit. Ishte lidhja e pandarë mes brezave, që mbante gjallë shpresën dhe forcën e jetës në këtë vend të shenjtë.

Periudha kohore: Shek. IV-II p.e.s.

Përmbledhja historike e periudhës

Liqenet e Dumresë, në rajonin qendror të Shqipërisë, kanë origjinë karstike. Ato janë formuar përmes një procesi natyror të tretjes së shkëmbinjve gëlqerorë gjatë miliona viteve, një fenomen tipik i zonave karstike. Ata karakterizohen nga një shumëllojshmëri e madhe në shtrirje dhe thellësi dhe përbëjnë një pasuri të rëndësishme natyrore për ekosistemin lokal,

përveçse janë një burim i rëndësishëm për bujqësinë dhe jetën e përditshme të komuniteteve përreth. Liqeni i Seferanit, në zonën e Belshit, është një ndër më të mëdhenjtë e krahinës së Dumresë, dhe i rrethuar nga kodra e vende të fshehta që prej shekujsh janë përshkuar nga rrëfime dhe besime popullore.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Thatësira e madhe e vitit 1982 shkaktoi rënien e nivelit të ujit të liqenit të Seferanit, duke nxjerrë në sipërfaqe shumë objekte arkeologjike, ndër të cilat mbizotërojnë figurina prej balte të pjekur të vajzave dhe grave të reja. Kemi të bëjmë me një vend të shenjtë ku gratë dhe vajzat – në faza të rëndësishme kalimtare në jetën e tyre – u kushtonin dhurata hyjnive që lidhen me ujin dhe kujdesen për jetën, martesën dhe lindjen. Liqeni i Seferanit, elementi natyror kryesor i të cilit është uji, është simbol i jetës dhe i pjellorisë njëherazi për natyrën dhe individin.

Mesazhi

Ky fragment synon të përcjellë mesazhin se fazat e rëndësishme të përfshirjes së vajzave në botën e të rriturve – dashuria, martesa dhe lidhja me jetën – marrin një dimension të shenjtë kur zhvillohen në harmoni me natyrën, me traditën dhe me ritmet e thella të shpirtit njerëzor. Këto përvoja nuk janë vetëm ndodhi personale, por pjesë e një cikli jetësor ku çdo brez mbështet dhe udhëheq tjetrin drejt vazhdimësisë.

Bibliografia

- Ceka Neritan, Zeqo Moikom, Kërkime nënujore në vijën bregdetare dhe ujrat e brendshme të vendit tonë, Monumentet 28 (1984/2), f. 127-136.
- Lamaj Thanas, Folklori i Elbasanit (Tiranë: Akademia e Shkencave, 1990)
- Instituti i Kulturës Popullore. Fondi "Besime dhe rite", Elbasan, intervistat e mbledhura në Dumre, 1978–1985.
- Domi Mahir, Motivet mitike në folklorin shqiptar (Tiranë: SHBLSH, 1987)
- Muka Belisa, Offrandes votives dans un lac: le cas de Seferan (Albanie), në Hyusecom-Haxhi Stéphanie, Muller Arthur (eds) Figurines en contexte: Présence muette dans le sanctuaire, la tombe et la maison. Actes du XXXVème Symposium International organisé (7-8 décembre 2011), Lille 2015, f. 218-231

“Mali i mbretërve ilirë”, varret shkëmbore në Selcën e Poshtme

Rrethuar nga male të larta, buzë luginës së Genusus (Shkumbini), ku era bart kujtimet e lashtësisë, ngrihej dikur Selca e Poshtme, zemra e fisit ilir të Desaretëve. Aty, shpati i malit u kthye në vend krenarie, ku një popull i fortë dhe i heshtur gdhendi në shkëmb lavdinë e mbretërve të vet.

Një mjeshtër gurgdhendës, njeri i heshtur dhe i përulur, punonte me gurin sikur bashkëbisedonte me të. Kishte duar të forta, por sy të trishtuar. Ai e dinte se gjithçka që ndërtonte ishte për ata që nuk do të flisnin më kurrë.

Kur mbreti e thirri dhe i bëri me dije dëshirën për të ndërtuar disa varre mbretërore për veten dhe pasardhësit e tij, mjeshtri e kuptoi se nuk kërkohej thjesht një strehë për trupin, por një vend që të fliste me përjetësinë. Ai vend duhej t'u drejtohej brezave që do të vinin: kushdo që do të ndalej përpara atij shkëmbi, duhej të ndjente madhështinë e ëndrrës së këtij populli.

Mjeshtri punoi me përkushtim plot një dekadë, ditë e natë, në faqet e shkëmbit. Çekiçi dhe dalta e tij rrëfyen historinë. Ai gdhendi përkrenaret e luftëtarëve ngadhënjimtarë nga betejat e shumta, mburojat e trimave të rënë, shpatat që valëviteshin në ajër e binin furishëm mbi ushtritë armike, gjethet e dafinës që shoqëronin lavdinë, dhimbjen dhe lotët e nënave për bijtë e vrarë, këngët e vajeve që drithëronin zemrat... Gur pas guri, shkëmbi nuk ishte thjesht një vendvarrim – ai u bë tempulli i kujtesës, dëshmi e një ëndrre.

Mjeshtri jetoi mjaftueshëm për të parë ikjen e mbretit, një humbje që la një zbrazëti të thellë në zemrat e njerëzve të tij. Thuhet se atë natë varrimi, ndërsa hëna ndriçonte mbi shkëmb, një dritë e butë u shfaq mbi varrin e mbretit. Nuk ishte një pishtar i zakonshëm që flakëronte në errësi, por një vezullim i veçantë që vinte nga thellësia e gurit, si një shpirt i trazuar që diçka përpiquej të thoshte. Të moshuarit e fshatit, që e panë me sytë e tyre, thoshin se ajo dritë nuk ishte shenja e një shpirti të mallkuar, por vuajtja e një mbreti që nuk pushonte dot qetësisht, sepse ëndrra për një të ardhme të paqte dhe të sigurt për vendin e tij nuk ishte përmbushur ende.

Që atëherë, drita e vezullimit shfaqet në netë të caktuara, si një kujtesë e heshtur se diku, në zemrën e shkëmbit, fle një mbret që ende ëndërron dhe pret ditën kur jeta dhe lavdia do të ndërthuren sërish në këto troje, duke ringjallur historinë dhe krenarinë e një populli të pathyeshëm.

Periudha kohore: Shek. IV-III p.e.s

Përmbledhje historike e periudhës

Vendbanimi në Selcën e Poshtme (Gradishta e Selcës), në zonën e Pogradecit, ndodhet sot në bregun e djathtë të lumit Shkumbin dhe në antikitet kishte një pozicion strategjik, duke kontrollur rrugën antike që lidhte Dyrrahun me Maqedoninë. Ky vendbanim njihet për varret monumentale, të gdhendura në shkëmb, me dhoma funerare me harqe dhe arkitekturë madhështore, si dhe gjetje që e vendosin këtë kontekst në periudhën midis shek. IV-III p.e.s. Nisur nga arkitektura e varreve, gjetjet arkeologjike dhe relievet (bukranion, përkrenare dhe mburojë e tipit ilir), këto struktura janë interpretuar si varret e mbretërve ilirë, si Bardhyli – “mbreti i parë i ilirëve” - ose djali i tij, Kleitos.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Vendvarrimet në Selcën e Poshtme nuk janë vetëm monumente mortore, por reflektojnë një ndërmarrje të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore për komunitetin ilir. Ndërtimi i tyre kërkonte përpjekje të mëdha, që përfshinin mjeshtrit, punëtorët, materialet dhe organizimin e burimeve natyrore. Në aspektin shoqëror, këto varre përfaqësonin shprehjen më të lartë të identitetit dhe fuqisë së fisit, duke bashkuar njerëzit në një mision të përbashkët që tejkalonte jetën individuale. Ato ishin vendtakime ceremoniale, simbole të unitetit dhe krenarisë, dhe shenja e respektit të thellë ndaj paraardhësve dhe trashëgimisë kulturore.

Mesazhi

Madhështia dhe lavdia nuk janë të lidhura me gjërat e përkohshme apo materiale, por qëndrojnë në kujtimin dhe trashëgiminë që lë pas një popull ose një udhëheqës. Nëpërmjet gurit, durimit dhe besimit, njerëzit kanë krijuar diçka që tejkalon kohën - një simbol që lidhet me identitetin dhe ëndrrën për një të ardhme më të mirë. Nëpërmjet dritës simbolizohet shpresa dhe një premtim i heshtur, një kujtesë e fuqishme se historia dhe shpirti i një populli mund të mbijetojnë përtej kohës fizike. Në thelb, mesazhi flet për përjetësinë e vlerave, për forcën e kujtesës historike dhe për shpresën që frymëzon brezat e ardhshëm

Bibliografia

- Ceka Neritan, *Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme*, Tiranë 1985
- Intervistat e Institutit të Kulturës Popullore, veçanërisht studimet e terrenit në vitet 1980 dhe më pas në 2010–2020.
 - Tregimet gojore të mbledhura nga arkeologë mbi Selcën.
 - Rrëfime të ruajtura nga banorët e Selcës së Poshtme, sidomos nga familjet më të vjetra të fshatit, që kanë përcjellë këto legjenda si pjesë të identitetit të zonës.

Miti i Kadmit në Iliri

Banorët e vjetër të Pogradecit dhe fshatrave përreth rrëfejnë se, në fund të liqenit të Ohrit, përballë kodrave të Gështenjasit, fshihet një fron guri i skalitur. Sipas gojëdhënës, aty ulej çdo mëngjes Kadmi për të soditur mbretërinë e tij të qetë e të zhdukur. Froni qëndronte mbi dy gurë në formë gjarpërinjsh, të zgjatur në thellësitë e errëta të liqenit.

Thuhet se një herë në vit, kur hëna skuqet dhe qetësia mbulon sipërfaqen e ujit, froni ngrihet për pak çaste mbi valë. Ai që arrin ta shohë, ose do të ketë fatin e një mbreti, ose do të çmendet nga vizioni i shenjtë.

Një plak i moshuar tregonte se gjyshi i tij e kishte parë fronin një natë vere, por s'kishte folur më asnjëherë. Në ëndërr, Kadmi i ishte shfaqur dhe e kishte urdhëruar të ruante heshtjen, që të mos zbulohej sekreti i mbretërisë së humbur.

Disa të rinj që kishin guxuar ta kërkonin fronin me varkë, kishin dëgjuar thellë në ujë një rënkim dhe një kërcitje zinxhirësh – si zëri i një mbreti të lidhur, që pret çlirimin e tij. Një grua e moshuar i kishte ndaluar, duke u thënë: “Mos e trazoni! Kadmi nuk ka vdekur. Ai ruan Ilirinë !”

Periudha kohore: Duke nisur nga shek. V p.e.s.

Përmbledhje historike e periudhës

Miti i Kadmit është një nga rrëfimet më të hershme të mitologjisë greke, i përmendur nga autorë si Euripidi (*Bacchantes*, 1330-41) dhe Apollodori (*Bibliothèque*, III, 5,4). Ai lidhet ngushtësisht me themelimin e qytetit të Thebës. Kadmi, princi fenikas, nisi një udhëtim për të kërkuar motrën e tij, Europën, e cila ishte rrëmbyer nga Zeusi, dhe përfundoi duke themeluar qytetërime të reja. Sipas burimeve antike, pas një periudhe sundimi në Thebë dhe vuajtjesh që goditën familjen e tij, Kadmi dhe gruaja e tij, Harmonia, u larguan nga vendi dhe shkuan në veriperëndim, në tokat e fisit ilir të Enkelejve - më vonë të njohur si Desaretë - që banonin në zonën e liqenit të Ohrit. Këtu, mitologjia ndërthuret me historinë e Ilirisë: Kadmi jo vetëm që jetoi në Iliri, por edhe luftoi kundër fiseve fqinje dhe themeloi një qytet. Ky është një nga rastet e rralla kur një figurë mitologjike greke integrohet në mitologjinë vendase ilire.

Miti i Kadmit është unik, pasi është i vetmi mit klasik grek që e lokalizon qartë Ilirinë si skenë mitike. Asnjë figurë tjetër mitologjike nuk përmendet në burime antike kaq qartë si udhëtuese, sunduese dhe e vendosur në trojet ilire. Autorët antikë nuk e trajtojnë Ilirinë si një periferi të paqartë, por tokat e Enkelejve, që përkojnë me zonën Pogradec – Ohër, që emërtohen qartë si vendi ku Kadmi jetoi dhe sundoi. Ky lokalizim gjeografik e bën mitin veçanërisht të

rëndësishëm për mitologjinë ilire, edhe pse origjina e tij mbetet fenikase dhe greke. Përhapja e këtij miti në Iliri, krahas shkëmbimeve materiale për të cilat arkeologjia ka ofruar dëshmi të pasura, solli edhe përvetësimin e tij nga elitat vendase, të cilat e shndërruan Kadmit në paraardhësin e tyre mitik.

Kushtet qësollën lindjen e ngjarjes

Një nga gjetjet arkeologjike që lidhet drejtpërdrejtë me mitin e Kadmit është një paftë rripi (22 x 5 cm), e zbuluar në inventaret e varreve shkëmbore në Selcën e Poshtme. Skena paraqet një ushtar në këmbë, me dorën e djathtë të ngritur, duke lëshuar heshtën. Në të djathtë dhe të majtë e tij ndodhen dy kalorës. Të tre luftëtarët janë të armatosur me përkrenare të tipit ilir dhe mburoja të tipit maqedonas. Një luftëtar i vrarë qëndron i shtrirë nën kalorësin e majtë, ndërsa një krijesë monstruoze duket se vrapon pranë kalit në të djathtë, prej nga fluturon një zog. Në skajin e majtë gjendet një gjarpër gjigant i mbuluar me luspa të mëdha, me trupin e ngritur, të mbështjellë dy herë, dhe me kokën e kthyer drejt kalorësit të majtë, sikur i ofron atij mbrojtje.

Mesazhi

Figura e Kadmit të metamorfozuar në gjarpër mishëronte vlera pozitive, si mbrojtja ushtarake dhe roli mbrojtës i paraardhësve, duke u lidhur me objekte arkeologjike si pafta e brezit nga Selca e Poshtme. Megjithatë ky mit nuk është me origjinë vendase, ai u përvetësua natyrshëm nga ilirët, pasi përputhej me besimet dhe simbolikën e tyre tradicionale. Roli i Kadmit si hero “margjinal” e shndërroi atë në një figurë ndërmjetëse – përfaqësues i kalimit nga kaosi në rend, nga barbaria në qytetërim. Në këtë mënyrë, ai u bë një paradigmë kulturore me funksion të qartë, duke u konsideruar si hero transballkanik për nga rëndësia dhe ndikimi i tij.

Bibliografia

- Tregime të mbledhura në Pogradec, Gështenjas dhe Lin nga studiues të Institutit të Kulturës Popullore, viteve 1980–1990
- Ceka Neritan, *Ilirët* (Tiranë: Toena, 2012), ku përmendet lokalizimi i mitit të Kadmit në Ohër
- Domi Mahir, *Motivet mitike në folklorin shqiptar*, SHBLSH, 1987
- Castiglioni Maria-Paola, *Cadmos-serpent en Illyrie. Itinéraire d'un héros civilisateur*, Pisa University Press, 2010.
- Intervista të dokumentuara gojore nga familje të vjetra në Pogradec (jo të botuara, por të përmendura në punime universitare mbi kujtesën kulturore)

Shqiponjat arbërore të Komanit

Kambanat e kishave kumbonin në agun e ftohtë të atij mëngjesi të fillimdimrit. Tingulli i tyre dilte nga muret e Sardës, zbriste poshtë kodrave të thepisura, kalonte përmes ujërave të qeta të Drinit dhe arrinte, i përhumur, deri në rrethinat e Komanit.

Atë mëngjes, në krah të lumit, njerëzit e një familjeje të vjetër, sa vetë gurët e qytetit u mbledhën për të përcjellë në banesën e fundit të parin e tyre. Ai kishte qenë më shumë se një prijës. Ishte mbrojtës i traditave dhe kujtesës, ruante emrin e tokës me të njëjtin përkushtim me të cilin fjalët mbajnë gjallë këngët e të parëve. Ikja e tij ishte më shumë se thjesht një vdekje. Mes dhimbjes së heshtur dhe lotëve të përmbajtur, në përgatitjet e fundit, ata i vendosën unazën prej bronzi me një simbol të gdhendur – shqiponjën – trashëgimi e të parëve. Ajo nuk ishte vetëm shenjë e shtëpisë, por edhe shprehje e lartësisë, forcës dhe lirisë së pakthyeshme.

– “Do të varroset me të”, - tha më i moshuari i asaj dere. “Ashtu siç jetoi – me shqiponjën në zemër.”

Kambanat kumbonin fort, sikur ndiqnin ritmin e zemrave të atyre që kishin mbetur, të bindur se simboli nuk do të zhdukej me trupin e tij. Sepse shqiponja nuk jeton në bronz. Ajo jeton në kujtesën që bartet, në guximin për të mos u përkulur, në krenarinë e rrënjëve të thella dhe në forcën për të fluturuar lart.

Kambanat pushuan, por mjegulla mbeti ende mbi luginë. Brenda saj gjëmonte kujtesa, e gdhendur si shqiponjë, që kishte zënë rrënjë në tokën ku prehen eshtrat e të parëve dhe jeton në kujtimin e atyre që do të përmenden ndër shekuj.

Periudha kohore: Shek. X-XII e.s.

Përmbledhje historike e periudhës

Vendbanimi antik i Komanit ndodhet në luginën e mesme të Drinit. Ai shtrihet në disa kodra të thepisura me lartësi nga 600-700 m, me njësipërfaqe të përgjithshme prej rreth 40ha. Ai dëshmon për praninë e një qyteti të madh dhe një dioqeze të rëndësishme të qytetërimit mesjetar të Arbërit, i cili u zhduk në shekullin XVI, pas pushtimit osman. Vendbanimi i Komanit zhvillohet në tre nivele – i sipërm, i mesëm dhe i poshtëm – tipari kryesor i topografisë së vendbanimit është prania e dy kishave, njëra në pjesën e poshtme dhe tjetra në pjesën e sipërme të vendbanimit, që kanë luajtur rolin e qendrave për komunitetin përkatës.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Nekropoli gjendet në afërsi të kishave, duke krijuar një lidhje të fortë midis jetës, besimit dhe praktikave funerare që lidhen me vdekjen. Ai shtrihet në një nga hapësirat funerare më të mëdha të kësaj periudhe, me varre të pajisura me inventare të pasur. Studimet dëshmojnë se është familja ajo që dominonte dhe menaxhonte varrin, si një vend kujtese për disa breza. Strategjitë e tyre të ruajtjes dhe përcimit të kujtesës kolektive shfaqen në arkitekturë, në strukturat funerare të konceptuara për ripërdorime të njëpasnjëshme dhe në elemente sociale përmes grumbullimit të pasurisë materiale dhe kalimit të saj nga një brez në tjetrin. Gjatë gjurmëve të fundit në nekropolin e Komanit, janë zbuluar disa unaza bronzi me një shqiponjë njëkokëshe të gdhendur në to. Ky zbulim është i rëndësishëm për të kuptuar tiparet e kulturës dhe identitetit të popullsisë që ka banuar në këtë zonë gjatë periudhës mesjetare të hershme. Shqiponja ka qenë një simbol i fuqishëm dhe domethënës në kulturën shqiptare, me kuptime që kanë evoluar ndër shekuj. Në kontekstin e Komanit, shqiponja njëkokëshe, e paraqitur në unaza të zbuluara në varre, mund të ketë pasur një rol mbrojtës ose identitar, veçanërisht për individët me status të lartë shoqëror. Prania e këtyre unazave në kontekste funerare tregon jo vetëm rëndësinë e simbolit në jetën e përditshme, por edhe funksionin e tij në përcimin e përkatësisë kulturore dhe memorjes kolektive përtej jetës. Këto gjetje janë një dëshmi e qartë e lidhjeve të forta kulturore dhe identitare që banorët e Komanit kishin me simbolikën dhe historinë e tyre.

Mesazhi

Kjo pjesë synon të përçojë mesazhin se kujtesa nuk vdes. Ajo mbetet e gjallë në tokën që ruan gjurmët e të parëve, në simbolet që kalojnë nga një brez në tjetrin, dhe në zemrat e atyre që vijnë pas. Shqiponja – e gdhendur në bronz dhe e gjallë në kujtesën kolektive – është shprehje e lirisë, e forcës dhe e qëndresës.

Bibliografia

- Nallbani Etleva, Early Medieval North Albania: New Discoveries, Remodeling Connections, *Adriatico altomedievale (VI–XI secolo)*, 2017
- Nallbani Etleva, Gallien Véronique, Inhumation et statut social privilégiés dans l'Ouest des Balkans au haut Moyen Âge. Les cas de Lezha et Komani, në De Vingo Paulo, Marano Yuri, Pinar Gil Joan (eds) *Sepolture di Prestigio nel baccino mediterraneo (secoli IV-IX). Definizione, immagini, utilizzo*, Atti del convegno (Pella, 28-30 giugno 2017), All 'Insegna del Giglio, Sesto Fiorentino (FI) 2021, f. 473-494
- Nallbani Etleva *et alii*, Komani. Peuplement et territoires dans l'occident Balkanique (VIe–XVe s.). Komani, Sarda et Lezha: Campagnes de fouilles et d'études 2020–2021, *Bulletin archéologique des Écoles françaises à l'étranger*, 2023

Në gjurmët e Gjergj Kastriotit, Kalaja e Petrelës

Arbëria po kalonte stuhitë më të errëta të saj. Flamujt e zinj të një perandorie që përpiqej të shkatërronte gjithçka prekte, lëviznin si hije drejt viseve të saj. Në këtë kohë kur Gjergj Kastrioti luftonte betejat e Matit dhe Dibrës, një kala e vogël, që ngrihej mbi një shkëmb të thepisur në luginën e Erzenit, qëndronte e palëkundur. Ishte Kalaja e Petrelës.

Aty jetonte Mamica Kastrioti, motra e vogël e Skënderbeut. Pas humbjes së bashkëshortit dhe djalit në luftë kundër osmanëve, ajo mori në dorë komandën e kalasë. Ishte një akt guximi i rrallë për kohën, por vendosmëria dhe mençuria e saj fituan zemrat e banorëve. Të gjithë e thërrisnin me nder: “Zonja e Kalasë”.

Një mëngjes pranvere, një lajm i zi mbërriti në Petrelë: trupat osmane kishin kapërcyer lumin Shkumbin dhe po i afroreshin luginës. Mamica e kuptoi menjëherë. Përpara se të godisnin Krujën, ata do të përpiqeshin të thyenin Petrelën, si e vetmja pengesë strategjike që ua priste hovin drejt Durrësit dhe më tej drejt Krujës. Në kullat e Dorëzit, burra e gra kishin zënë pritë. Nën dritën e një hëne të plotë, Mamica i mbledhi njerëzit në oborrin e kalasë: “Prijësi ynë, Gjergj Kastrioti, lufton larg. Por këtu, mbi këta gurë të lashtë, është derdhur gjak që toka e të parëve të mos dorëzohet. Nuk kemi shumë forca, por kemi njëri-tjetrin. Dhe mbi të gjitha, kemi besën!”.

Të nesërmen, armiku u shfaq në horizont, i armatosur deri në dhëmbë. Rrethimi filloi. Ditën, Mamica shpërndante ushqim, dërgonte lajmëtarë dhe mbikëqyrte mbrojtjen. Natën, patrullonte vetë mbi gurët e lagësht, duke pëshpëritur lutjet e lashta që gjyshi i kishte mësuar. Pak ditë para rrethimit, kishte kërkuar forcë në gjurmët e historisë së Petrelës. Kishte ngjitur kodrën drejt rrënojave të Persqopit, ku qëndronin muret e kalasë së lashtë si dëshmi e një lavdie që nuk është harruar. Pastaj kishte zbritur nëpër kanionin e ngushtë që të çonte drejt Erzenit dhe kishte prekur gjurmët e të parëve, të gdhendura në shkëmbinjtë e shpellës së Pëllumbasit.

Kur qielli u ngjyros me flakën e sinjalit nga Persqopi, ndihma nuk vonoi. Luftëtarë nga Dorëzi dhe fortesat përreth çanë krahun jugor të armikut. Osmanët u thyen, pa e kuptuar se nga cila anë u kishte ardhur goditja.

Sot, Kalaja e Petrelës qëndron krenare mbi luginën e Erzenit, dëshmitare e një epoke të përgjakur dhe të lavdishme. Emri i Mamica Kastriotit jeton në gojëdhëna, në pëshpërimat e gurëve dhe në kujtesën që nuk zbehet. Historia mund të harrojë shpesh gratë që ngritën mburojën e kombit, por muret e Petrelës e dinë mirë: pa të, kjo kala nuk do të kishte qëndruar.

Periudha kohore: Shek. XIV-XV



Përmbledhje historike e periudhës

Kalaja e Petrelës ndodhet rreth 15 km në juglindje të qendrës së qytetit të Tiranës. E vendosur në mënyrë strategjike mbi një kodër të lartë, ajo kontrollonte luginën e Erzenit dhe rrugët tregtare që prej periudhave më të hershme. Origjina e saj daton që nga periudhat antike, por formën e fortifikuar që njohim sot, e merr gjatë shek. XV e.s. Duke nisur nga shek. XIII-XIV Petrela ishte pjesë e zotërimeve të familjes së Topiajve, princër të Arbërit.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në shek. XV, në kohën e luftërave mes Gjergj Kastriotit – Skënderbeut dhe ushtrive osmane, Petrela ishte një qendër e rëndësishme strategjike si pjesë e sistemit mbrojtës dhe pikë vrojtimi. Kalaja e Petrelës ishte edhe vendi ku qëndroi Mamica Kastrioti, motra e Skënderbeut, e martuar në familjen e Topiajve. Ajo qëndroi aty gjatë një pjese të këtyre luftërave duke e kthyer kalanë edhe në qendër të rezistencës.

Mesazhi

Historia e Kalasë së Petrelës dëshmon bashkimin dhe guximin e një populli që nuk dorëzohet përballë armikut, edhe kur duket e pamundur. Ajo qëndron si dëshmi e fortë e historisë, kujtesës dhe rezistencës - sepse ata që luftuan, ndonëse shpesh anonimë, ruajtën themelet e kombit me besë, sakrificë dhe kurajo.

Bibliografia

- Barleti Marin, Historia e Skënderbeut (përktheu Prifti Stefan), Tiranë 2004
- Ceka Neritan, Muçaj Skënder, Përzhita Luan, Tirana 100 (1920-2020) : Arkeologjia, Tiranë 2020
- Karaiskaj Gjerak, 5000 vjet fortifikime, Tiranë 2016

Gjuha që nuk humbi – Legjenda e kalorësit gjerman

Në rrugëtimin e tij drejt Tokës së Shenjtë, kalorësi Arnold von Harff zbriti në brigjet shqiptare, në Durrës. Në ditarin e tij ai shkruan se qyteti kishte mure të forta, shumë tregti dhe një popullsi të përzier me katolikë, ortodoksë dhe myslimanë, por ajo që i ra më shumë në sy ishte gjuha që flitej.

Ai ishte një udhëtar e shkruar i palodhur i botës që shihte. Kishte kaluar male dhe dete, kish shkruar greqisht, turqisht, italisht...

Një burrë i moshuar, me qeleshe të bardhë në kokë, i thirri djalit të tij me një gjuhë që nuk ngjante me asnjë tjetër:

– *Eja bir! Buka është gati.*

Kalorësi ngriti kokën. Nuk e kuptonte gjuhën, por e ndjeu peshën e saj. Iu kthye shërbëtorit të hanit dhe kërkoi ndihmë:

- *Çfarë gjuhe flasin këta njerëz?*
- *Flasin shqip. Është gjuha e gurit tonë, - u përgjigj ai.*

I habitur dhe i tërhequr nga këta tinguj të pazakontë, kërkoi përkthime dhe i shkroi në fletoren e tij: “*vene*”, “*krup*”, “*criste*”, “*kale*”, “*myreprema*” etj. Në ditarin e tij shkruajti: “*item dese stat lijcht in Albanijen dae sij ouch eyn eygen spraiche haynt, der man nyet wael geschrijuen en kan, as sij geyn eygen liter in deme lande en hauen*”. (Ky qytet (Durrësi) ndodhet në Shqipëri, ku ata kanë edhe gjuhën e tyre, por të cilën nuk mund ta shkruash mirë, sepse në këtë vend nuk kanë shkronjat e tyre).

– *Këto fjalë fliten nga njerëz që s’kanë letër, por kanë shpirt, – pëshpëriste ai. – Është një gjuhë që ndoshta nuk do ta kuptoj kurrë, por do ta ruaj për ata që do të vijnë.*

Ai pa malet në horizont dhe shtoi në ditar: “*Banorët janë të fortë, të heshtur dhe të ashpër. Ata nuk i nënshtrohen askujt. Gjuha që flasin është ndryshe nga çdo tjetër që kam dëgjuar. E quajnë shqip.*”

Atë natë, në një qoshe të vogël të perandorisë së përçarë, një fjalë shqipe u bë për herë të parë shkronjë.

Fjalët që Arnold von Harff shkroi në ditarin e tij nuk ishin vetëm tinguj të veçantë për veshët e një të huaji, por fije të padukshme të kujtesës sonë kolektive – fjalë të ruajtura në zemër ndër shekuj nga një populli i tij.

Periudha kohore: Fund i shekullit XV (rreth vitit 1496)

Përmbledhje historike e periudhës

Në fund të shekullit XV, Shqipëria ndodhej në një nga kthesat më të vështira të historisë së saj. Kishte marrë fund qëndresa e organizuar kundër Perandorisë Osmane, kështjellat po binin njëra pas tjetrës, figura e Skënderbeut tashmë ishte kthyer në kujtim legjendar, ndërsa mijëra shqiptarë shpërnguleshin drejt Italisë, Arbërisë së Poshtme dhe vendeve të tjera. Terri i pushtimeve dhe zbrazjes shoqërore dukej se po e mbulonte gjithçka. Por edhe në këtë errësi, gjuha shqipe mbetej si një dritë që nuk fikej – nuk shkruhej në libra, por flitej në çdo prag, ruhej në këngë, pëshpëritej në mallkime dhe zbukurohej në lutje. Ishte gjuha e lashtë e uratës, e gjëmës, e përshëndetjes dhe e besës. Dhe pikërisht në këtë çast të vështirë, një kalorës gjerman – Arnold von Harff – kaloi nëpër trojet shqiptare, ose sikurse ai e shkruan *Albanyen*, dhe pa e ditur, la një nga dëshmitë e para të shkruara të shqipes. Në ditarin e tij të udhëtimit, mes përshkrimesh për qytetet, shenjtëroret dhe zakonet e botës mesjetare, ai u ndal e shkruajti fjalë të një gjuhe, që nuk i ngjante asnjërës që kishte dëgjuar më parë – një gjuhë që ai në gjermanishten e vjetër e quan “*albanische sprache*” (gjuhë shqipe).

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në dhjetor të vitit 1496, një kalorës i ri nga Këlni, Arnold von Harff, zbarkoi në Durrës. Ai nuk kishte ardhur për luftë, por për një udhëtim shpirtëror e kulturor që e çonte drejt Tokës së Shenjtë. Nga Italia kaloi në bregdetin shqiptar, në rrugën e tij drejt lindjes. Ai nuk ishte vetëm një pelegrin, por edhe një kronikan i hollë, që donte të regjistronte botën me të cilën ndeshej. Në rrëfimet e tij, përveç përshkrimeve të qyteteve dhe udhës, ndaloi edhe te diçka që për të ishte krejt e panjohur: një gjuhë që nuk i ngjante asnjërës nga ato që kishte dëgjuar më parë. Von Harff u përball me fjalë të panjohura që shqiptoheshin me forcë e qartësi. Nuk ishin latinisht, as greqisht, as sllavisht, as turqisht. Ishin “*albanisch*”, *shqip* - siç e quan ai.

E bëri këtë jo si gjuhëtar, por si vëzhgues i vëmendshëm, ndoshta pa e kuptuar që po kryente një akt me vlerë të pazëvendësueshme për historinë tonë. Sepse ishte hera e parë që fjala shqipe, e pathënë në letër prej vetë shqiptarëve, po zinte vend në një dokument të shkruar nga një udhëtar i huaj.

Gjuha shqipe, në atë kohë ende pa një alfabet të vetin, pa libra, pa gramatikë, po dëshmohej në heshtje – si zë i një populli që nuk kishte pushtet, por kishte gjuhën, çka do të bëhej për ne një nga provat më të hershme të ekzistencës së shqipes – një testament i pavetëdijshëm që parashkruan zbulimin e “Formulës së Pagëzimit” nga Pal Engjëlli, vetëm pak dekada më pas.

Mesazhi

Gjuha shqipe nuk lindi në oborret mbretërore, as në kancelaritë perandorake. Ajo nuk u përrua me dekret, por u rrit nën zërin e nënave, në urimet e dasmave, në vajet e grave, në këngët e barinjve dhe në britmat e luftëtarëve. Nuk e shkruajtën dijetarët, por e ruajtën njerëzit. Ishte një gjuhë që ekzistonte para se të njihej shkrimi – dhe pikërisht sepse jetonte, mbijetoi. Në fund të një shekulli të trazuar, një kalorës i huaj – Arnold von Harff – u ndal, dëgjoi, dhe shkroi për herë të parë disa fjalë shqipe. Sot, kur gjuha shqipe është zyrtare, e shkruar, e përhapur në diasporë dhe e njohur ndërkombëtarisht, ky episod i vogël – një kalorës që shkroi disa fjalë shqipe në ditarin e tij – merr përmasat e një dëshmie të madhe. Ai na kujton se kjo gjuhë nuk është thjesht një mjet komunikimi, por një kujtesë e gjallë, një akt mbijetese e një vepër shpirtërore.

Bibliografia:

- Arnold von Harff, *Die Pilgerfahrt des Ritters Arnold von Harff von Cöln durch Italien, Syrien, Egypten, Arabien, Ethiopien, Nubien, Palästina, die Türkei, Frankreich und Spanien (1496–1499)*, herausgegeben von E. von Groote. Köln: M. DuMont-Schauberg, 1860.
- Eqrem Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 1982.
- Robert Elsie, *Historical Dictionary of Albania*, Scarecrow Press, 2010.
- Dhimitër Shuteriqi, *Shkrimet e para shqipe dhe humanizmi shqiptar*, Tiranë: Naim Frashëri, 1974.

Sazani – Ishulli që nuk flet

Thonë pleqtë e Tragjasit se njëherë e një kohë, kur Sazani nuk kishte ende tela, mure e armë, jetonte në fshat një vashë me sytë si deti dhe zërin si bilbil. Ajo u dashurua me një marinar të huaj, i cili vinte shpesh me një anije tregtare që ankoronte në gjirin e Vlorës. Ai e takonte vajzën fshehurazi nëpër shkurret e Karaburunit, kur ajo kulloste bagëtinë.

Por familja e fejoj vashën me një burrë të mirë, por të madh në moshë, nga Dukati. Askush nuk e pyeti, askush nuk e dëgjoi. Kur mësoi se po përgatitej martesë kundër dëshirës së saj, vasha vendosi të largohej me të dashurin e saj të zemrës. Ajo shkruajti një letër dhe e la mbi jastëkun e saj. Një natë të qetë qershori hipi në një varkë së bashku me të dashurin dhe shkuan në ishullin e Sazanit.

Familja e vajzës ngriti fshatin në këmbë. Shpejt e kuptuan që ata nuk mund të fshiheshin kundër tjetër, përveçse në Sazan. U mbledhën burrat, morën armët dhe hipën në varka.

Çifti, i lodhur nga udhëtimi, kishte ngritur një strehë të përkohshme mbi një grykë shkëmbore. Aty kishin ndezur një zjarr të vogël dhe kishin rënë për të fjetur. Për herë të parë si njerëz të lirë. Por nuk e arritën mëngjesin. Në errësirë, burrat e familjes zbarkuan në ishull, i gjetën të dy në gjumë dhe i vranë pa zë, pa fjalë. I varrosën në një gropë të cekët, mbuluar me gurë të bardhë të mbledhur nga bregu. Pastaj u kthyen, e historia u mbyll me urdhrin: “Të mos përmendet më.”

Por fjalët nuk mbahen me zinxhir. Tre javë më vonë, një djalosh nga Tragjasi, i cili ruante dhentë mbi Karaburun, u betua se kishte parë një grua me fustan të bardhë në majën më të lartë të Sazanit. Ajo rrinte pa lëvizur e vështrohte nga fshati.

Të nesërmen, mbi ishull ra një shi i beftë e i ngrohtë, ndonëse në qiell nuk kishte asnjë re. Dukej sikur qielli po lotonte. Ishte mesi i korrikut. Që atëherë, sa herë që mbi Sazan bie një shi i tillë në vapë të madhe, pleqtë pëshpëritin: “Ajo qan.”

Sa herë që mbi Sazan mbledhen re të bardha pa shi, njerëzit thonë me zë të ulët: “Sazani nuk flet – sepse gjithçka që do të thoshte, do të na therrte në shpirt.”

Periudha kohore: Rrëfimet mitike dhe gojëdhënat për Sazanin nisin që nga antikiteti ilir dhe romak (shek. IV p.e.s. – shek. III e.s.), por trajtimi i tij si "ishull i mallkuar" apo "i ndaluar" nis të përforcohet sidomos nga periudha osmane e më tej gjatë shek. XX.

Përmbledhje historike e periudhës

Në kohën antike, Sazani njihej si një strehë për detarë dhe ushtarë romakë dhe më pas si pikë strategjike në kalimin mes Adriatikut dhe Jonit. Gjatë pushtimit osman, ishulli nuk kishte një popullsi të qëndrueshme dhe ruhej për arsye ushtarake. Gjatë shekullit XX, sidomos në kohën

e Mbretërisë dhe më tej në diktaturën komuniste, Sazani u kthye në një bazë të rreptë ushtarake e izoluar. Legjendat mbi heshtjen, humbjet, zhdukjet dhe mallkimet u shfaqën si formë rrëfimi popullor për të shpjeguar “mungesën e jetës” në një vend kaq të bukur.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Izolimi i gjatë i ishullit, ndalimi i hyrjes për qytetarët e zakonshëm dhe mungesa e çdo shenje jete civile e kthyen Sazanin në një hapësirë të shkëputur nga koha dhe njerëzit. Ai u perceptua si “ishulli i shurdhër” – pa zë, pa dritë, pa kujtim. Kjo heshtje e ngulitur në kohë, e shoqëruar me prani të mistershme dhe me rrëfime të pashpjegueshme, krijoi një nga figurat më të fuqishme të imagjinatës popullore: ishulli që nuk flet – një vend që ruan sekrete të thella dhe ndëshkon me heshtje ata që guxojnë ta prekin, qoftë me trup, qoftë me shpirt.

Mesazhi ose kuptimi simbolik që përçon

Ishulli i Sazanit mishëron idenë e bukurisë së pamundur, të një parajse të ndaluar, ku përzierja e historisë ushtarake, izolimit politik dhe natyrës së egër ka krijuar një hapësirë jashtë kohe. Gojëdhënat e lidhura me të pasqyrojnë frikën dhe respektin ndaj vendeve të mistershme dhe fuqinë e kujtesës kolektive për të mbrojtur hapësira të paprekura përmes mitit.

Bibliografia:

- Mark Tirta, Mitologjia ndër shqiptarë, Toena, Tiranë, 2004 – për trajtimin e besimeve popullore mbi hapësirat e izoluara dhe ishujt si vende të mbinatyrshme apo të mallkuara.
- Arkivi i Institutit të Kulturës Popullore (vitet 1970–1985), intervista etnografike të mbledhura në Karaburun, Tragjas dhe Dukat – përfshijnë rrëfimet lokale mbi Sazanin si ishull “i ndaluar”, “i heshtur”, dhe “që nuk pranon zë”.
- Kujtesa popullore nga zona e Orikumit dhe Dhërmiut, të publikuara në revista kulturore si Kultura Popullore dhe Gjurmime Albanologjike – për legjendën e “dritave në det”, të katër shpirtrave të ngjuar dhe simbolikën e shpirtrave të pastrehë në Sazan.

Mali i Tomorrit dhe Baba Tomorri

Në kohë të largëta që nuk maten me vite, mali i Tomorrit nuk ishte thjesht një mal. Ishte kufiri mes tokës dhe fjalës, mes njerëzores dhe hyjnore. Ishte vendi ku drejtësia s'kishte nevojë për gjykatës.

Thuhet se në majën e Tomorrit, atje ku retë ndalen e marrin frymë, jeton Baba Tomorri, një plak i moçëm, me mjekër të bardhë si bora, që s'e shkrin as dielli i gushtit. Ai nuk ka nevojë të flasë. As të duket. Mjafton që sheh. Dhe kur sheh, sheh përtej kohës. Rreth tij rrotullohen katër shqiponja të zeza, me krahë të mëdhenj dhe sy të mprehtë. Ato janë sytë dhe veshët e tij. Kur fluturojnë në qetësi, gjithçka është në paqe. Por kur nisin të rrotullohen mbi majë, në heshtje, është si të dëgjosh kambanat e një mallkimi të afërt. Diçka e rëndë po ndodh, një padrejtësi, një thyerje bese, një fyerje ndaj së shenjtës.

Baba Tomorri nuk flet me gojë, por me stuhi që zbresin si dënim, me erëra që ulërijnë nëpër terr, gurë që këputeshin nga faqet e malit si lotët e një zemërimi të mbledhur ndër shekuj. Ai nuk ndëshkon menjëherë, por nuk harron.

Njëherë një bej i pasur e mendjemadh kishte vendosur të ngrinte një kullë pikërisht mbi majën e Tomorrit. Donte të sundonte "nga lart", në mënyrë që të shihte çdo fshat, çdo njeri, çdo kafshë që lëvizte poshtë tij. Donte të bëhej më i lartë se hija e malit. Të shkruante emrin e vet atje ku vetëm Zoti shkelte. E kishte nisur punën me ustallarë, me gurë të bardhë, me karvanë që ngjiteshin çdo ditë. Për disa kohë, dukej se çdo gjë po ecte për mrekulli.

Por Babait të malit nuk i pëlqeu kulla dhe as ambicia e beut për të parë gjithçka nga lart. Ndaj një natë, erërat nisën të frynin nga të katër anët. Një stuhi e zezë mbuloi gjithçka. Mjegulla zbriste si qefin i bardhë mbi trupin e kullës që po ngrihej.

Të nesërmen, kulla nuk ishte më. As shtegu për atje. Askush nuk i gjente më rrugët që ishin hapur për javë të tëra. Asnjë shenjë që dora e njeriut kishte qenë ndonjëherë aty. Thuhet se atëherë Baba Tomorri më në fund foli dhe fjalët e tij jehojnë edhe sot, përtej kohës: *"Askush s'e ngre kullën mbi hijen time"*.

Që nga ajo kohë, askush nuk guxonte të ngrihej mbi majën e shenjtë. Të gjithë ngjiteshin dhe ngjiten me përulje, jo me krenari. Kjo nuk është vetëm historia e një beu të marrë, por kujtesë për gjithkënd se krenaria pa kufi, padrejtësia dhe shpërfillja e së shenjtës nuk kalojnë pa ndëshkim.

Periudha kohore: Evidentuar si vend i shenjtë prej shek. IV. p.e.s.

Përmbledhje historike e periudhës

Besimi i lidhur me malin e Tomorrit si një vend i shenjtë është shumë i lashtë, me rrënjë që mund të identifikohen prej shekullit IV p.e.s., kur kultet e natyrës dhe adhurimi i maleve ishin

të përhapura në trevat shqiptare. Ky sakralitet natyror, që shihte në majat e maleve vendbanime të forcave hyjnore, mbijetoi përmes përshtatjes me besime të tjera përgjatë historisë. Në periudhën e krishterimit të hershëm, ai u përthith pjesërisht në tradita të reja devocioni, ndërsa gjatë sundimit osman, përmes përhapjes së bektashizmit, u institucionalizua në formën e një kulti të qëndrueshëm shpirtëror.

Në rrëfimet popullore, mali i Tomorrit përfytyrohej si vendbanimi i një fuqie mbinatyrore që ndëshkonte padrejtësinë dhe ruante rendin moral, shpesh i mishëruar në figurën mitike të Baba Tomorrit – një plak i moçëm me mjekër të bardhë dhe katër shqiponja rreth tij. Kjo figurë, e trashëguar nga botëkuptime të lashta, përfaqësonte vazhdimësinë e shenjtërisë së malit në vetëdijen kolektive.

Me përhapjen e bektashizmit në shekujt XVIII–XIX, kjo ndjeshmëri mitike mori formë të përqendruar rreth kultit të Baba Aliut (Abaz Aliut), një prej shenjtoreve kryesorë të këtij besimi. Teqeja e Kulmakut, në lartësitë e Tomorrit, u shndërrua në një nga qendrat më të rëndësishme të pelegrinazhit bektashi në Ballkan. Ndërthurja mes përfytyrimit popullor të Baba Tomorrit dhe kultit fetar të Baba Aliut është një shembull i rrallë i bashkëjetesës midis mitit dhe besimit të institucionalizuar, duke ruajtur fuqinë shenjtëruese të malit si pjesë thelbësore e identitetit shpirtëror shqiptar.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Tomorri nuk është thjesht një mal. Ai është një prani. Kur e sheh nga larg, me majat që mbështeten mbi retë dhe trupin e tij si një luan i shtrirë, kupton pse njerëzit, prej mijëra vitesh, kanë besuar se atje lart banon një fuqi. Nuk ishte e nevojshme një libër i shenjtë për ta shenjtëruar. Vetë natyra e tij – e egër, e qetë dhe hijerëndë – mjaftonte për të ngjallur frikë, respekt dhe përlje.

Në botën shqiptare, si në shumë kultura të tjera të lashta, majat e maleve ishin gjithmonë vende të shenjta. Por Tomorri u veçua. Ai nuk ishte vetëm vendi ku qëndronin hyjnitë, por edhe një lloj gjykatësi i heshtur. Populli i dha shpirt, e pa si roje të drejtësisë, si mbrojtës të besës, si dikë që sheh dhe vepron. Dhe kur ndodhnin stuhi, kur era fshikullonte pa mëshirë, kur shkëmbinjtë rrëshqisnin papritur, njerëzit nuk i shihnin këto fenomene si rastësi, por si shenja të një zemërimi që vinte nga lart.

Në rrëfimet gojore, Tomorri nuk fal padrejtësinë. Ai nuk është i largët; është gjithmonë aty, gati të flasë – jo me fjalë, por me mjegull, me zhurmë, me ndëshkim të heshtur. Nga kjo ndjeshmëri lindi figura e Baba Tomorrit, një njeri i moçëm me mjekër të bardhë dhe katër shqiponja që sillen rreth tij. Më vonë, ky besim u ndërthur me besimin bektashi dhe u mishërua në shenjtin Baba Ali. Por në thelb, gjithçka nisi nga një ndjenjë e thellë njerëzore: se drejtësia ka një vendbanim, dhe ai është mali.

Sot, Tomorri është një qendër e rëndësishme pelegrinazhi për besimtarë të feve të ndryshme, veçanërisht gjatë festës së Baba Aliut (20–25 gusht), ku qindra familje ngjiten në mal për të bërë kurban, për të lutur falje, për të shprehur mirënjohje dhe për të rigjetur lidhjen me të shenjtën.

Mesazhi

Sot, Mali i Tomorrit nuk është vetëm një simbol shpirtëror, por edhe një qendër bashkimi kulturor dhe identitar për shqiptarët. Ritet që zhvillohen çdo gusht janë dëshmi e gjallë e ndërthurjes ndërfetare dhe e trashëgimisë së një përvoje të përbashkët, që i ka mbijetuar pushtimeve, ideologjive dhe ndarjeve. Baba Tomorri është kthyer në një figurë që tejkalon përkatësitë fetare apo krahinore – një simbol i tokës së shenjtë, i drejtësisë dhe i kujtesës që nuk zbehet. Për komunitetin bektashi, vendi mbetet një nga qendrat më të rëndësishme të



pelegrinazhit shpirtëror, përkushtuar Baba Aliut. Për shumë të tjerë, ai është një mal që flet me histori, me legjenda dhe me heshtje. Në një botë gjithnjë më të fragmentuar, ku shenjtëria rrezikon të humbasë përballë interesit, Tomorri mbetet një pikë orientimi dhe një pasqyrë për atë që kemi qenë dhe atë që ende duam të jemi.

Bibliografia

- Elsie, Robert. Albanian Folktales and Legends. Dukagjini Publishing House, Pejë, 2001.
- Mandala, Pëllumb. Kulti i Tomorrit: Ndërmjet Mitit dhe Besimit Popullor. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2009.
- Doja, Albert. "Politics of Religious Dualism: Bektashism in Albania." Critique of Anthropology, vol. 20, no. 1, 2000, pp. 61–86.
- Instituti i Kulturës Popullore. Kultura Popullore, Nr. 2, 1981; Nr. 1, 1987.

Beja mbi gur, fjala që nuk shkelet

Në një mëngjes të freskët, djemtë më të rinj të fshatit ishin nisur me urdhër të plakut të kuvendit për të gjetur një gur. Duhej të ishte i rrumbullakët, i fortë, jo më i madh se grushti i dorës, por as i vogël për t'u humbur. Guri do të shërbente për betimin e burrave që sapo kishin marrë një vendim të rëndësishëm për gjithë katundin. Ata do të bashkoheshin kundër një armiku të jashtëm që cënonte lirinë e tyre.

Pasi guri u gjet dhe u soll me kujdes, plaku i madh i kuvendit e mbajti në dorë për disa çaste, duke parë çdo burrë në sy. Të gjithë qëndronin në këmbë në formë gjysmë-rrethi, të heshtur e solemnë. Ai ia dha gurin burrit të parë në të majtë. Ky e vendosi në shuplakën e dorës së majtë, e preku me të djathtën dhe shqiptoi me zë të qartë: *“Për këtë të mirë të Perëndisë, e si e bafsha më ndihmoftë, se as unë, e askush i shtëpisë s’me për t’i dalë besë katundit nuk kemi.”* Një nga një, të gjithë e përsëritën të njëjtën formulë.

Kur guri u kthye në dorën e plakut, edhe ai u betua. Pastaj ngriti dorën lart dhe tha: *“Ai që e theftë këtë be, theftë kokën si unë që e lëshoj këtë gur.”*

Dhe e la gurin të bjerë përdhe, përpara syve të gjithë burrave të kuvendit. Ky gur nuk ishte më një send i rëndomtë. Kishte marrë peshën e fjalës, të nderit dhe të besës. Ruhej me kujdes në shtëpinë e plakut, si një objekt i shenjtë. Thuhej se : *“Ky gur nuk është më si çdo gur, mbi të është bërë beja, dhe do të ruhet si send i shuguruem.”* Ta hidhje jashtë ose ta trajtoje me përbuzje ishte mëkat i rëndë.

Beja mbi gur nuk përdorej vetëm për vendime kolektive. Në shumë raste, ishte mënyra e vetme për të shfajësuar një individ nga një akuzë që i bëhej. Një burrë i akuzuar për tradhti, për shkelje fjale, apo për ndonjë fyerje të rëndë, mund të kërkonte të bënte be mbi gur për të pastruar emrin. Beja konsiderohej e paprekshme: nëse njeriu betohej rrejtshëm, besohej se brenda tri ditësh do ta ndëshkonte vetë toka.

Në Mirditë, për shembull, kjo praktikë kishte përmasa gati mistike. Guri nuk ishte vetëm dëshmitar, por edhe shenjt. Në kulturën shqiptare guri kishte status të dyfishtë: si kufi fizik dhe si objekt i besimit tradicional. Është i njohur përdorimi i gurëve në kuvende, në ndarje toke, në varre dhe, më me rëndësi, si pikë referimi për betimet e shenjta. Në zona si Mirdita, Labëria apo Dukagjini, ende ruhen “gurët e besës”, të njohur si vende ku janë bërë ‘be’ historike për pajtime gjakmarrjesh, lidhje aleancash apo edhe vendime për t’u bashkuar në luftë kundër një armiku të huaj.

Periudha kohore: Traditë e lashtë shqiptare, e dokumentuar që nga shek. XVII, por me rrënjë më të thella gojore e zakonore.

Përmbledhje historike



Në botën shqiptare të maleve, fjalët nuk ishin veç tinguj, ato ishin akte. Fjala e dhënë, në mungesë të ligjeve të shkruara, kishte vlerën e një kontrate të shenjtë. Ndër të gjitha format e betimit, më solemnia ishte “beja mbi gur”, një akt i ngulitur në truallin e shqiptarëve si mishërim i së vërtetës, i nderit dhe i drejtësisë. Kanuni i Lekë Dukagjinit e njeht benë mbi gur si ndër betimet më të rënda dhe më të ndershme që njeht shqiptari, përkrah besë mbi Ungjill.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në një shoqëri ku autoriteti shoqëror mbështetej te burrëria dhe nderi, zgjidhja e konflikteve, marrëveshjet apo pajtimet nuk kërkonin gjyqtarë, por dëshmitarë. Ata dëshmitarë ishin burrat e kuvendit dhe toka që i dëgjonte. Guri, si simbol i qëndrueshmërisë dhe i lidhjes me të shenjtën, ishte mjeti për ta ngulitur fjalën në tokë, në mënyrë që asgjë të mos e zhbënte më. Beja bëhej me dorën mbi gur, në emër të Zotit dhe të turpit që do të binte mbi atë që e shkelte.

Mesazhi

Beja mbi gur nuk është një zakon i thjeshtë, por një shprehje e thellë e kulturës shqiptare, ku ndërthuren drejtësia, morali dhe komuniteti. Ajo mishëron ndërgjegjen kolektive dhe vullnetin për të ruajtur fjalën si diçka e shenjtë. Përmes këtij riti, fjala nuk ishte më personale, por një borxh i shenjtë ndaj tokës dhe të tjerëve. Kishte pasoja në këtë jetë dhe, sipas besimit popullor, edhe në tjetrën. Beja mbi gur mishëron një nga lidhjet më të forta ndërmjet njeriut, tokës dhe nderit. Ajo nuk është vetëm një akt verbal, por një marrëveshje që përfshin gjithë qenien. Në të vërtetë, ky betim ka të njëjtën fuqi si një kontratë morale, ku për dëshmitar është jo thjesht bashkësia, por vetë natyra, pra toka, guri, qielli. Në një shoqëri ku drejtësia varej nga besimi dhe jo nga dënimi, beja mbi gur përforconte strukturën morale dhe shoqërore. Ajo krijonte një rrjet garancie që e bënte njeriun të përgjegjshëm për fjalën dhe veprimin.

Bibliografia

- Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Tiranë: Shtëpia Botuese "Idromeno", 1993.
- Tirta, Mark. *Mitologjia ndër shqiptarë*. Tiranë: 2019.
- Elsie, Robert. *Albanian Folktales and Legends*. London: Dukagjini Publishing House, 2001.

Gjama e burrave në Shqipëri, zë i dhimbjes dhe nderit

Kur udhëtari i quajtur Dorian, mbërriti në fshatin e qepur në shpatet e Alpeve, nuk e dinte se kishte hyrë pa dashje në një botë tjetër, ku hapat respektojnë të kaluarën dhe fjala e nderit nuk shuhet bashkë me trupin. Kishte ardhur për të fotografuar bukuritë e maleve për arkivin e tij, por në vend të pamjeve që shpresonte të gjente, duke ecur në fshat, papritur dëgjoi një gjësim të thellë, të ritmuar, të vërtetë.

Ishte gjama e burrave të maleve. Ai nuk pyeti asnjë pasi të gjithë rrinin të heshtur, ndërsa nga maja e rrugës zbritnin me radhë burra, të veshur thjesht, por me një solemnitë që nuk kishte parë kurrë më parë. Të gjithë ecnin drejt oborrit të një shtëpie, ku qëndronte i mbuluar trupi i një plaku të ndershëm që sapo kishte ndërruar jetë.

Në hyrje të shtëpisë, gratë rrinin më vete, të ulura, duke qarë me zë, por pa zhurmë, ndërsa burrat u rreshtuan në rreth dhe u përkulën lehtë me dorën në zemër. Njëri prej tyre doli përpara. Kishte mustaqe të bardha, sy të thellë dhe një qëndrim që fliste më shumë se fjalët. Pa vegla muzikore, pa përgatitje, pa spektakël. Thjesht zë. Zë i burrave. I pari filloi të lëshonte tinguj të ritmuar që s'ishin këngë, por nuk ishin as thirrje të zakonshme. Ishin fjalë që godisnin si gurë në gjoksin e ajrit. Ishin mallkim për vdekjen, por edhe lavdi për jetën.

“Ah burrë i dheut, me nder të madh ke rënë, zemrat na i ke shqyer, por gjurma s'të humbet në këtë tokë!”

Pas tij, me një sinkronizim që nuk vinte nga provat, por nga zakoni, të tjerët u bashkuan, duke ndjekur ritmin dhe fjalët si një kor dhimbjeje të lashtë. Udhëtari, pa e kuptuar, qëndronte i palëvizur. As aparati i tij nuk guxoi të nxirrte zë. Kuptoi se gjendej në mes të një procesioni të rrallë, që ishte një akt kolektiv i vajtimit burrëror, një traditë që kishte lindur jo për të bërë dramë, por për të mos lënë dhimbjen të vdesë me trupin.

Në Shqipërinë e Veriut, por edhe në Labëri, gjama ishte mënyra e vetme që burrat mund të qanin. Atyre nuk u lejohej të derdhnin lot, dhe dhimbja e tyre nuk derdhej nëpër faqe, por shndërrohej në fjalë që ngriheshin drejt qiellit. Kështu e kishin caktuar të parët: burrat nuk qanin, por vajtonin si burrat. Gjithçka kishte rregulla të veta.

Gjama nuk bëhej për çdo njeri. Duhej të ishte një burrë i ndershëm, i mençur, i njohur për fisnikëri e drejtësi. Njerëzit e fshatit vendosnin në heshtje kush e meritonte një gjamë të tillë. Ishte nderi i fundit që i jepej një jete që kishte ecur drejt, pa e kthyer fjalën, pa e shkelur besën. Gjithçka ndodhi në një atmosferë që i ngjante një procesioni të lashtë. Njerëzit rrinin më këmbë, me duart te gjoksi ose në kokë, si për të përmbajtur diçka që donte të shpërthente. Dhe në kulmin e gjamës, kur zëri i burrave arrinte pikën e tij më të lartë, udhëtari e ndjeu veten të lëkundej, jo nga trishtimi, por nga madhështia e një kulture, që kishte gjetur këtë gjuhë për të thënë lamtumirën më dinjitoze.

Pas përfundimit, askush nuk foli. Burrat u ulën për pak në gurët përreth, pinë pak raki në heshtje dhe u ngritën të largoheshin. E kishin bërë të tyren. E kishin çuar njeriun e tyre përtej, me zë. Kishin bërë gjamën.

Udhëtari Dorian pyeti një plak aty pranë: “Çfarë ishte ajo?”

Plaku e pa me qetësi dhe iu përgjigj: “Ishte fjala e fundit. Por më e rëndë se të gjitha. Atë që nuk e thotë më goja, e thotë gjama.”

Në ditët e sotme, shumë prej këtyre gjamave nuk dëgjohen më. Të rinjtë largohen, ceremonitë moderne zëvendësojnë zakonet. Por nëpër fshatra të largëta, ende ndodh që kur bie një burrë i nderit, të ngrihen gjashtë a shtatë burra në këmbë dhe të shkundin ajrin me zërin e tyre. Gjama nuk është thjesht zë, por shpirti që ngrihet për të dhënë lavdinë e fundit.

Periudha kohore: E trashëguar nga kohët e lashta, e dokumentuar më qartë nga shek. XVIII deri në mes të shek. XX.

Përmbledhje historike e periudhës

Në shoqëritë patriarkale shqiptare, veçanërisht në Veri dhe në Labëri, dhimbja, nderi dhe vdekja ishin ngjarje të ngarkuara me simbolikë shoqërore. Në këto rrethana, u zhvillua gjama, një formë burrërore dhe kolektive vajtimi, që nuk ishte as këngë dhe as klithmë, por një thirrje e strukturuar ritmike dhe ceremonialisht. Ajo shprehte dhimbjen në mënyrë të ligjshme dhe të pranueshme për burrat, të cilët nuk lejohej të qanin publikisht. Gjama nuk ishte vetëm një mënyrë për të nderuar të vdekurin, por shërbente për të transmetuar një mesazh burrërie, dinjiteti dhe përjetësimi.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në mungesë të ritualeve të formalizuara dhe të një kulture të shkruar, gjama lindi si një formë kolektive për të shprehur ndjenjën e pikëllimit në mënyrë të kontrolluar, të pranuar dhe të respektueshme nga kodi moral i kohës. Ishte e vetmja mënyrë që një burrë të shfaqte ndjenjat e tij ndaj humbjes së një të afërmi, apo të një figure të nderuar të komunitetit.

Mesazhi

Gjama është një formë e thellë respekti për të vdekurit dhe për nderin e jetuar. Ajo nuk është vetëm një vajtim, por një akt komunitar që i jep zë dhimbjes së përbashkët dhe përjetëson figurën e të ndjerit përmes një forme të rrallë rituale. Ajo dëshmon se edhe në shoqëri ku ndjenjat ishin të ndaluara të shfaqeshin hapur, u gjetën mënyra dinjitoze për të vajtuar dhe për të nderuar.

Bibliografia

- Tirta, Mark. *Mitologjia ndër shqiptarë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2004.
- Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, komentet mbi ritet e mortit.

Dollia, bekimi i ngritur në kupë

Keni dëgjuar për Dollinë shqiptare? Duhet ta dini se nuk është thjesht një ngritje gote, por një rit i heshtur nderi, ku rakia (apo një pije tjetër tradicionale) shoqërohet me fjalë urimi e respekti, që dalin si një bekim i shpirtit.

Nga fjalët e mirëseardhjes deri te urimet solemne që lidhen me fatin e familjarëve, dollia ndjek një rend të pashkruar, por shumë të qartë për ata që e ndjekin. E ngre gotën i pari i zoti i shtëpisë, pastaj miku, gjithnjë me respekt dhe fjalë të mira. Këtu s'ka vend për fyerje, vetëm për nder, për kujtim, për fjalën e dhënë, duke pasqyruar gjithë mirënjohjen dhe dashurinë e shqiptarëve për njëri-tjetrin. Aq i fortë është një moment dollie mes mikpritësit dhe miqve, sa një i huaj do habitej me gjithë ato fjalë respekti dhe dashurie të thëna brenda një nate. E pazakontë si traditë askund tjetër.

Në rrethin e Gramshit, ky zakon merr një trajtë të veçantë dhe të pasur me simbolikë kombëtare. I zoti i shtëpisë e mbyll gjithmonë dollinë me fjalët: *“Këtë shëndet e ngremë për Flamurin. Rroftë e valoftë!”*. Në atë çast, të gjithë të pranishmit ngrihen dhe përgjigjen njëzëri: *“Gjithmonë në duart e shqiptarit!”*. Ky rit i rrallë, që ruhet vetëm në Gramsh, është një akt simbolik që lidh nderin e shtëpisë me nderin e kombit. Flamuri, i shenjtëruar në zemër të dollisë, bëhet pika më e lartë e unitetit, besës dhe krenarisë shqiptare.

Por ky ritual i lashtë sot ruhet më qartë dhe më me solemnitet në zonën e Skraparit. Aty dollia ka ligjet e veta të trashëguara brez pas brezi.

Thonë, se dikur në një dimër të largët, kur bora kishte mbuluar shtigjet e maleve të Skraparit, një mik i panjohur trokiti në derën e një shtëpie të humbur mes dëborës. I zoti i shtëpisë, siç e do zakoni i mikpritjes, e priti dhe i shtroi sofrën. Kur burrat u mblodhën rreth rakisë, ai ngriti dolli: *“Për mikun që s'e njohim, por që fjala do ta nxjerrë në dritë zemrën e tij”*.

Të kam gjetur o mik!

Të gjetët e mira!- ia ktheu miku dhe gotat nisën me radhë urim, pas urimi.

Gjatë asaj mbrëmjeje, mes shëndetesh për prindër, gjyshër dhe të afërt që nuk jetonin më, një kujtim u ringjall si zjarr i vjetër nën hi: gjyshërit e tyre kishin qenë nizamë bashkë, shumë vite më parë, diku në Anadoll. Aty, në rraskapitjen e betejave, kishin ndarë bukën, ujin e plagët, dhe ishin bërë vëllamë gjaku.

Djemtë nuk e dinin këtë lidhje, por dollia, fjala e ëmbël dhe rakia që nxit kujtimet, sollën në jetë një histori të harruar që jetonte ende në kujtesën e tryezës. Ajo natë solli një miqësi të përvetshme: ky s'ishte mik i ri, por një mik i vjetër që rruga e kishte sjellë vonë.

Që prej asaj nate, çdo vit, në të njëjtën datë, ata ngrinin nga një gotë për atë dolli të parë që lidhi dy familje me rrënjë të përbashkëta dhe nder të trashëguar.

Kjo histori, me variante të ngjashme në shumë treva, mbart një të vërtetë të përvetshme: dollia shqiptare nuk është thjesht urim. Është urë mes zemrash, kujtesë që ringjallet me një gotë, besë që rrjedh brez pas brezi. Në tingullin e fjalës dhe të dollisë, ruhet nderi i një populli që ngre gotën me zemër dhe bekon me shpirt.

Periudha kohore: E lashtë sa vetë jeta. Vijon në përdorim të gjallë deri në ditët e sotme.

Përmbledhja historike e periudhës

Tradita e dollisë në trojet shqiptare lidhet me një botëkuptim arkaik, ku fjala dhe alkooli, veçanërisht rakia, përbënin elemente të shenjta të mikpritjes në familjen shqiptare. Në shoqëritë patriarkale shqiptare, tryeza ishte një hapësirë e rregulluar nga ligje të pashkruara të nderit, besës dhe respektit për mikun. Në këto tryeza, dollia nuk ishte vetëm një hyrje apo përmbyllje simbolike e një vakti të përbashkët, por një moment solemn ku nderoheshin miqësia, familja, luftëtarët, të vdekurit dhe vetë jeta. Në shekujt XVIII–XIX, veçanërisht në Shqipërinë e Jugut, dollia filloi të strukturohej si një rregull i mirëfilltë social, i transmetuar brez pas brezi. Pas shekullit të XX-të, me ndryshimet socio-politike dhe përfshirjen në organizata kulturore ndërkombëtare, nisi të trajtohej edhe si element i trashëgimisë shpirtërore kombëtare.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Shqiptarët janë ndër popujt me traditë të theksuar mikpritjeje dhe nderimi të fjalës. Në shoqëritë ku ligji moral ishte më i fortë se ligji i shkruar, fjala e dhënë kishte peshë të jashtëzakonshme. Në këtë kontekst, shfaqja e dollisë si një akt solemn që ndërthurte pirjen me bekimin dhe urimin, lindi si nevojë për të rregulluar marrëdhëniet ndërnjerëzore në mënyrë harmonike. Ajo buron nga raportet kolektive të shoqërisë tradicionale, ku çdo akt publik – si ngritja e gotës – ishte një akt me përmbajtje etike dhe jo thjesht social apo gastronomik.

Mesazhi

Dollia është shprehje e etikës së mikpritjes shqiptare. Ajo tregon se si shqiptarët e kanë nderuar fjalën, miqësinë dhe jetën në mënyrë të organizuar dhe solemne. Duke ngritur gotën, shqiptari jo vetëm pi, por lutet, nderon dhe kujton. Në ditët e sotme, dollia mbetet një pjesë e gjallë e jetës shoqërore shqiptare, qoftë në dasma, qoka apo takime miqësore. Megjithatë konteksti modern ka sjellë forma të reja të komunikimit dhe socializimit, ritmi dhe ndjenja e dollisë mbeten në thelb të paprekura. Në disa komunitete shqiptare në emigracion, ajo përfaqëson një formë lidhjeje me rrënjët kulturore. Sot ka përpjekje për ta mbrojtur dollinë si pjesë të trashëgimisë shpirtërore të shqiptarëve. Në një botë që po zhvillohet gjithnjë e më shpejt, por edhe në mënyrë të fragmentuar, dollia përçon vlera të ngrohta të solidaritetit, nderit dhe urimit për jetën.

Bibliografia:

- Bundo, Sherif. *Dollia shqiptare si akt shpirtëror dhe etik*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021.
- Elsie, Robert. *Albanian Folklore and Oral Tradition*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 2004.
- Mandala, Peter. *The Anthropology of Ritual Speech in the Balkans*. Thessaloniki: Balkan Cultural Review, 2010.

Dragoi dhe Kulshedra, lufta e përjetshme e forcave mitike në Mirditë

Në fshatin Mushtë të Mirditës, legjenda rrëfen për një Dragua të ri, të lindur në një familje të thjeshtë blegtorësh. Ai ishte fëmijë i zakonshëm në dukje, por qysh i vogël kishte dhënë shenja të pazakonta, pasi ai qeshte vetëm kur shiu binte fort, lëvizte gurë që burra të rritur nuk i lëviznin dot, dhe flinte gjithmonë me fytyrën nga mali.

Kur Kulshedra u zgjua nga shpellat e Gomsiqes dhe nisi të përpinte retë, duke sjellë stuhi të rrufeshme e breshër mbi të mbjellat e fshatrave të Oroshit, njerëzit u mbledhën për t'u këshilluar. Një plak i mençur tha: "Koha ka ardhë. Dragoi do ta ndiejë vetë kur të vijë momenti". Dhe ashtu ndodhi. Një natë ku qielli u errësua si mos më keq, Dragoi u ngjit në malin përballë shpellës dhe e thirri Kulshedrën me emër.

"Mos më prish tokën e njerëzve të mi," i bërtiti.

Kulshedra doli, e fryrë, me flokët që tërhiqnin retë dhe gjuhë zjarri që përpinin errësirën. Ajo gjuajti me stuhitë, por Dragoi e përballoi, i mbështetur mbi një parmendë të rëndë që e përdori si heshtë. Në çastin e fundit, siç thotë legjenda, vetë qielli u ndriçua nga një rrufe dhe e goditi Kulshedrën. Por ishte dora e Dragoit që ia tregoi shpellën, vendin e saj të vdekjes.

Në Mushtë thuhet se aty, mbi një shkëmb të thepisur, mund të shohësh ende "gjurmën e Dragoit", një formë e çuditshme që ngjan me shenjën e një këmbe njerëzore. Në Gomsiqe ndodhet "Guri i Dragoit", vendi ku ai u mbështet për herë të fundit, para se të nisë betejën e tij të përjetshme.

Në zona të tjera të veriut, sidomos në Pukë e Tropojë, Dragoi mund të jetë zog apo dash me krahë zjarri, ndërsa Kulshedra mund të shfaqet në formë gruaje që fshihet nëpër gurra apo nëpër burime të nëndheshme. Në Dibrën e Madhe, thuhet se Kulshedra është një grua me gërsheta të gjata, që shfaqet para përmytjeve të mëdha dhe zhduket sapo Dragoi ngjitet mbi lisat që lëkunden nga erërat.

Studiuesit e krahasojnë këtë përfytyrim me modelet indo-evropiane të mitit të "heroit që vret përbindëshin", duke vënë në dukje se versioni shqiptar ruan më shumë elementë të paganizmit arkaik, sidomos në Mirditë, ku rrëfimet janë më të plota dhe më pak të ndikuara.

Periudha kohore: Që nga periudhat e hershme para-kristiane deri në shek. XX, me rrënjë në botëkuptimin mitologjik të besimit pagan shqiptar.

Përmbledhje historike e periudhës

Në traditën gojore të Mirditës dhe më gjerë në trevat veriore të Shqipërisë, kanë mbijetuar rrëfime të fuqishme mitologjike që vijnë nga një botë e lashtë, ku natyra nuk ishte thjesht sfond i jetës, por një fuqi e gjallë dhe shpesh kërcënuese. Dy figurat më të fuqishme që mishërojnë këtë botëkuptim janë Kulshedra dhe Dragoi, dy qenie mitike që përfaqësojnë dualitetin themelor të ekzistencës: të keqen shkatërruese dhe të mirën mbrojtëse. Kulshedra,

përbindëshi i rrëmbyeshëm, sjell furtuna, breshër, përmytje e shembje malesh, duke i vënë në rrezik jetën dhe bereqetin e njerëzve. Përballë saj qëndron Dragoi, heroi mitik, zakonisht mashkull, që ngrihet në mbrojtje të jetës, tokës dhe rendit natyror.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Terreni i ashpër malor, jeta e vështirë në kushte klimatike ekstreme dhe varësia e plotë nga mjedisi natyror e shndërruan mitin në një formë të domosdoshme shpjegimi dhe ngushëllimi. Në këto kushte, populli i zonave të thella të veriut ndërtoi rrëfime që përshkruanin konfliktet natyrore si stuhitë e befasishme, vërshimet, rrëshqitjet e dheut, si vepra të Kulshedrës, një qenie me fuqi të mbinatyrshme dhe të mallkuara. Përballë kësaj të keqe, njerëzit imagjinuan një mbrojtës, Dragoin, një qenie jo gjithmonë hyjnore, por që kishte lindur mes tyre dhe që mund të ishte fëmijë, burrë, zog apo edhe dash, me fuqi të jashtëzakonshme që i jepte natyra. Ky hero i drejtësisë përfaqësonte shpresën dhe aftësinë për të përballuar të keqen.

Mesazhi

Lufta ndërmjet Dragoit dhe Kulshedrës është një metaforë e përjetshme e ndeshjes midis të mirës dhe të keqes, midis forcës mbrojtëse të komunitetit dhe rrezikut që vjen nga natyra ose nga jashtë. Kjo mitologji i mësonte njerëzit se e keqja nuk është e pamposhtur, por kërkon kurajo, sakrificë dhe një lidhje të thellë me tokën dhe komunitetin për t'u përballur. Sot, rrëfimet për Dragoin dhe Kulshedrën nuk janë thjesht kujtime të një kohe të kaluar, por pjesë e një trashëgimie të gjallë që mbart vlera kulturore dhe edukative. Ato mund të shfrytëzohen për të forcuar ndjenjën e identitetit lokal, për të nxitur dashurinë për mitologjinë shqiptare dhe për të promovuar turizmin kulturor, sidomos në zona si Mirdita ku legjendat janë të mishëruara në toponime dhe kujtesën kolektive.

Bibliografia:

- Tirta, Mark. *Mitologjia ndër shqiptarë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë Tiranë: 2004.
- Tirta, Mark. *Panteoni e simbolika, doke e kode në etnokulturën shqiptare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2007

Flija – Shija e traditës dhe mikpritjes së veriut shqiptar

Në një ditë dimri, kur qielli mbulohet me re të trasha dhe dëbora fillon të bie me qetësi, në një shtëpi malësore të Kukësit fillon përgatitja për flinë. Oda është ngrohur me zjarrin që është ndezur qysh në mëngjes dhe rreth vatrës janë mbledhur gratë e shtëpisë. Në njërin anë është brumi i holluar me ujë dhe pak kripë, në tjetrën janë të përgatitura gjalpi dhe ajka. E para që nis procesin është zakonisht gruaja më e vjetër e shtëpisë, e cila hedh me kujdes shtresën e parë në saçin që është nxehur mirë mbi prush. Ajo nuk nxiton. Çdo shtresë ka nevojë për kohën e vet, për pjekjen e vet, për vëmendje. Ndërsa shtresat piqen njëra mbi tjetrën, biseda rrjedh natyrshëm. Gratë kujtojnë kohët e shkuara, këndojnë ndonjë këngë të vjetër që nuk e kanë dëgjuar prej kohësh ose tregojnë ndonjë ndodhi nga jeta e përditshme. Fëmijët, të ulur afër, presin të dëgjojnë ndonjë histori apo të përkëdhelen nga ndonjë gjyshe që u hedh një vështrim plot dashuri. Aroma e gjalpit që përhapet nëpër shtëpi sjell një ndjesi ngrohtësie familjare dhe sigurie.

Kjo nuk është vetëm një ditë gatimi, është një ditë bashkimi. Kur më në fund flija është gati, ajo nuk pritet menjëherë. I pari që e provon është mysafiri, nëse ka. Nëse jo, e merr më i vjetri i shtëpisë, duke thënë një urim për shëndet e begati. Pastaj pjesa ndahet me kujdes mes të gjithëve. Nuk ka ndasi, as dallime pasi çdo pjesë e flisë është njësoj dhe shoqërohet shpesh me kos të freskët, dajthë, reçel apo me mjaltë, sipas dëshirës së secilit.

Edhe pse Kukësi mban një version shumë të pastër dhe tradicional të flisë, në zona të tjera si Tropoja, Hasi apo Puka, gratë shtojnë ndonjë vezë në brumë ose e pjekin flinë me disa ndryshime në përbërje. Në ndonjë rast mund ta shërbejnë me reçel, në ndonjë tjetër me qumësht të zier. Por në thelb, ideja mbetet e njëjtë sepse flija është një ushqim që kërkon kohë dhe durim dhe që përgatitet me shumë dashuri; dashuri për mikun, për familjen, për jetën.

Periudha kohore: Nga periudhat e hershme historike deri në ditët tona, me kulmin në shekujt XIX–XX.

Përmbledhje historike e periudhës

Në malësitë e Kukësit, ku bora zbret shpejt dhe shpesh zgjat deri në pranverë, ku rrugët zhduken nën dëborë dhe vetmia e dimrit e bën më të fortë lidhjen mes njerëzve, lindin tradita që e mbajnë gjallë shpirtin e bashkësisë. Në këtë mjedis të ashpër, ku jeta kërkon qëndrueshmëri e durim, ka marrë formë një nga gatimet më përfaqësuese të traditës sonë: flija. E bërë me përbërës të thjeshtë, por me shumë përkushtim, ajo nuk është vetëm ushqim, por një mënyrë për të shprehur bujarinë, mikpritjen dhe ngrohtësinë e shtëpisë shqiptare. Ajo është një pasqyrë e shpirtit të veriut shqiptar.

Kushtet që sollën lindjen e traditës

Jeta në krahinën e Kukësit e më gjerë në Shqipërinë e veriut nuk ka qenë kurrë e lehtë. Moti i ftohtë, terreni i thyer dhe izolimi gjatë muajve të dimrit i kanë detyruar banorët të zhvillojnë mënyra jetese që mbështeteshin te komuniteti dhe vetë-mjaftueshmëria. Në këto kushte, çdo burim duhej përdorur me mençuri. Mielli, gjalpi dhe ajka, të cilat vinin nga prodhimi i brendshëm i shtëpisë, u kthyen në përbërës bazë për krijimin e flisë. Por më shumë sesa përbërësit, ishte mënyra e përgatitjes që i jepte flisë vlerën dhe karakterin e saj të veçantë. Ajo ishte një ushqim që nuk bëhej përditë, por në raste të shënuara si për dasma, për festa, për ditë të mëdha ose kur në derë trokiste një mik i rrallë.

Mesazhi

Flija nuk është thjesht një ushqim. Ajo është një simbol. Është një provë e durimit, sepse për t'a përgatitur duhen orë të tëra. Është një shenjë e mikpritjes, sepse nuk përgatitet për këdo, por për dikë që vlen. Është një mënyrë për të treguar kujdesin, sepse çdo shtresë është vendosur me dorë, me përkushtim, me mendimin që i ftuari të ndihet mirë. Në një shoqëri që ka kaluar përmes shumë sfidash, flija ka qenë dhe mbetet një formë rezistence kulturore, një dëshmi e asaj se bukuria mund të vijë nga thjeshtësia.

Bibliografia

- Cenolli, Arsim. *Flija*, Cuneus, 2018



Fyejt e Gramshit dhe historia e Tanës

Tana, vajza e vetme e një fshatari të pasur kishte rënë në dashuri me një bari të varfër, hyzmeqarin e familjes së saj. Fjala mbërriti deri te veshi i babait të vajzës, por ai nuk e besoi. Për të vënë në provë të bijën, ai i kërkoi asaj që t'i çonte bukë bariut dhe e ndoqi atë fshehurazi. Djaloshi-bari, e pa nga larg që të dashurën e zemrës po e ndiqnin. Mori fyellin dhe filloi t'i binte e të këndonte:

Tanë, moj e bukura, Tanë!

Vare bukën n'atë thanë,

Se babanë e ke pranë.

Ishte një thirrje për të mos folur, për të heshtur, për të mbrojtur dashurinë e tyre. Vajza e kuptoi dhe nga larg i thirri me zë të lartë: "O çobani i malit! Eja dhe merre bukën tek thana!"

Këto fjalë e bindën të atin se vajza nuk e dashuronte çobanin.

Pak kohë më pas, një grup hajdutësh hyri në befasi në stan dhe e lidhën çobanin pak më tej stanit. Ai iu lut atyre që t'i lironin të paktën një dorë që t'i binte fyellit. Hajdutët e pranuan kërkesën e tij dhe u larguan.

Tingujt e fyellit dhe kënga e tij u përhapën gjithandej. I dëgjoi edhe vajza. Bariu këndonte:

Tanë, moj e zeza, Tanë!

Sqo babanë të bonjë berianë ?!

Se çobanë lidhur e kanë,

Dhëntë te Shtogu janë

Qen' e zi, arap e vranë.

Dy desh për elli i kanë.

S'qo babanë të bonjë berianë!

Tana, sapo e dëgjoi njoftoi të atin. Në këngën e Tanës kjo gjë është përjetësuar në vargjet:

Ngreu, baba, boj berianë!

Se çobanë lidhur e kanë.

Dhentë mu te Shtogu janë.

Pasi i ati i vajzës së bashku me burrat e fshatit e shpëtuan çobanin nga rreziku, ai e pyeti djalin:

– E do vajzën time?

– Më shumë se jeta ime, – tha bariu.

– Të trashëgoheni në jetë të jetëve, – i tha babai i vajzës dhe i lidhi duart e tyre me një shami të bardhë.

Duke i lidhur me shami duart e tyre babai i vajzës vulosi lidhjen: me një dorë të lidhur ai nuk mund t'i binte fyellit, nuk do kishte më përse të thërriste dashurinë – sepse ajo tashmë i ishte dhënë. Dashuria u pranua. Fyelli e përmbushi misionin e tij dhe nuk do ishte më mjet lutjeje, por kujtimi i një sakrifice që e bëri këtë dashuri të mundur dhe që i shpëtoi jetën.

Periudha kohore: Trashëgimi gojore dhe instrumentale prej lashtësisë deri në ditët tona (pa datë); historia e Tanës – shek. XIX

Përmbledhje historike e periudhës

Treva e Gramshit është një nga trevat që ruan gjallë një nga trashëgimitë më të rralla dhe më autentike të muzikës popullore shqiptare – fyellin si instrument, mjeshtëri, kod komunikimi dhe simbol shpirtëror. Në këtë krahinë malore, ku jeta e përditshme lidhej ngushtë me bagëtinë, natyrën dhe komunitetin, fyelli nuk ishte vetëm shoqërues i çobanëve, por zë i ndjenjave njerëzore, thirrje e largët, shprehje e dhimbjes, gëzimit, dashurisë e mallëngjimit. Në shek. XIX, kur shoqëria ndahej ndjeshëm sipas pasurisë, e dashuria përjetonte përplasje me nderin e fisit, instrumente si fyelli mbeteshin si mjet i vetëm për të folur pa fjalë. Në këtë kontekst, është rrënjësuar edhe *Legjenda e Tanës dhe bariut*, një histori dashurie që e ngre instrumentin e fyellit në nivelin e një akti shpëtues dhe simbol besnikërie.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në një shoqëri me ndarje të thella shoqërore, ku vajzat e pasura nuk guxonin të dashuronin djem të varfër, çobanë, fyelli shërbente si urë e padukshme mes dy zemrave. Në duart e çobanit, fyelli nuk është thjesht një vegël muzikore – ai është zëri i vetmisë, shoqëruesi i përditshëm, dëshmitari i mendimeve të heshtura dhe dëfrimi i shpirtit në mal. Në malet e Gramshit, ku njeriu dhe natyra janë një, fyelli ishte ura që lidhte barinjtë me botën dhe me vetveten. Ai i jepte zë qetësisë së kullotave, thërriste delet e shpërndara, por edhe pëshpëriste dashuri të fshehura, mall të pashprehur dhe kujtime që nuk mund të thuheshin me fjalë. Çobani i binte fyellit jo për t'u dëgjuar, por për të komunikuar me të padukshmen – me dashurinë, me shpresën, me shpirtin e tokës që i fliste përmes tingujve. Në këtë lidhje të heshtur, por të thellë, fyelli bëhej identiteti i tij i dytë – një vazhdim i frymës që rri ende pezull mbi malet e Gramshit. Por, kishte raste që fyelli shërbente edhe për të sinjalizuar rrezik apo për të shpërndarë mesazhe në male.

Gramshi ruan ende mjeshtri të rrallë në përpunimin e drurit të fyellit dhe është i njohur për një repertor të pasur me melodi baritore që rrokullisin emocionin nëpër luginat e thella. Në këtë sfond lindi edhe historia që do të bëhej pjesë e kujtesës popullore: *“Historia e Tanës dhe fyellit që flet”*.

Mesazhi

Fyelli në Gramsh nuk është thjesht një instrument i lashtë popullor; është një gjuhë e përjetshme që flet për dashurinë, besën, ndjenjat e pathëna dhe fuqinë e shpirtit njerëzor për të komunikuar përtej fjalës. Në historinë e Tanës, ai bëhet mjet shpëtimi, zë i dashurisë së mohuar dhe dëshmi besnikërie, në një shoqëri ku fjala e lirë nuk kishte gjithmonë vend. Në jetën e përditshme, fyelli shërbente si një urë që lidhte barinjtë me botën dhe me njëri-tjetrin – një sinjal për rrezikun, një këngë për mallit, një thirrje për dashuri.

Por mesazhi i kësaj trashëgimie është më i thellë: në një shoqëri që ndante njerëzit sipas gjinisë, klasës apo prejardhjes, fyelli i Gramshit nuk njihte kufij. Ai i përkiste kujtdo që kishte frymë, ndjesi dhe dëshirë për të thënë pa fjalë atë që ndjente. Në dorën e çobanit të thjeshtë, fyelli merrte fuqi hyjnore – bëhej zëri i së drejtës, dëshmia e ndjenjës dhe pohimi i jetës së përbashkët.



Fakti që Fyejt e Gramshit janë shpallur “Kryevlerë Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale” nuk është vetëm një akt institucional – është një njohje e një thesari shpirtëror që ka përballuar shekuj harrese, duke mbijetuar në duart e mjeshtëreve fyelltarë gramshiotë dhe brezave të panumërt që i kanë dhënë fyellit jetë.

Bibliografia

- Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale: *Shpallja e “Fyejve të Gramshit” si Kryevlerë Kombëtare të Trashëgimisë Jomateriale*. Tiranë: Ministria e Kulturës, 2023.
- Petrit Basha: Gramshi në 40-vjetorin e deklaramit qytet, Elbasan 2000.
- Gojëdhëna dhe këngë popullore nga zona e Gramshit.

Kulla e nguimit – pritja e heshtur për drejtësi

Një pasdite pranvere, një fjalë e keqkuptuar midis dy të rinjve, kushërinj të largët nga fise të ndryshme, përfundoi në tragjedi. Njëri prej tyre, Gjeto, goditi me pushkë tjetrin gjatë një grindjeje në kufirin e kullotave. Ishte një vrasje që nuk ishte paramenduar, por që sërish, sipas Kanunit, hapte gjak. Që atë çast, Gjetoja nuk mund të shkonte më në shtëpinë e vet. Fisi i viktimës ishte i njohur për nderin dhe rregullin e vet, por gjithashtu për ashpërsinë.

Brenda pak orësh, pleqtë e dy palëve u mbledhën në kuvend për të vendosur rregullat e para të besës dhe për të shmangur një hakmarrje të menjëhershme. Sipas zakonit, u vendos që Gjetoja të dorëzohej pa armë dhe të shkojë në Kullën e Nguimit, aty ku mbahej ai që kishte hapur gjak. Rojet, zakonisht djelmosha të fuqishëm dhe të ndershëm nga fisi i vet, e shoqëruan deri te kulla. Ai hyri brenda me kokë ulur dhe pa thënë fjalë, siç e kërkonte zakoni. Prej atij momenti, ai ishte i nguuar e nuk i lejohej të dilte nga kulla, nuk mund të merrte pjesë në jetën e fshatit, nuk mund të punonte tokën, nuk mund të merrte pjesë as në dasma e as në varrime. Vetëm gratë kishin të drejtë të lëviznin jashtë dhe të sillnin bukë e ujë.

Sigurisht qëndrimi në Kullën e Nguimit nuk zgjaste më shumë se 10-15 ditë, kohë e mjaftueshme për marrjen e vendimit. Sapo jepej vendimi, i akuzuari kishte 3 ditë kohë që të largohej. Gjetoja priste në heshtje. Një ditë i ngjan një jete dhe jeta në nguim ishte një ditë që nuk mbaronte kurrë. Ndërkohë, pleqtë vijonin hetimin për të kuptuar se si kishte ndodhur ngjarja. A e kishte vrarë me qëllim apo ishte në mbrojtje të vetes? Të gjitha këto kishin peshë për vendimin përfundimtar.

Më në fund, kur u vendos se vrasja kishte ndodhur pa paramendim dhe për shkak të një konflikti banal, pleqtë ndërmorën hapat për pajtim. Vizitat në shtëpinë e familjes së viktimës ishin të shpeshta. Fillimisht, fjalët nuk priteshin mirë, por koha, vuajtja dhe ndërmjetësimi i burrave me zë në fshat, e bënë të mundur që një mëngjes, familja e viktimës të pranonte të vinte në kullë për t'u përballur me të ngujuarin.

Në mes të odës, siç e kërkonte tradita, u vendos një djep, me një foshnje të lidhur me kokë poshtë si simbol i pafajësisë dhe i jetës që rrezikohej nga konflikti i njerëzve të rritur. Fëmija ishte i Gjetos apo nip i tij. Ishte e pamundur për askënd të shihte një fëmijë në atë gjendje pa ndjerë tronditje.

Pleqtë i drejtuan fjalën plakut të fisit të viktimës: *“A po e fal këtë kërthi, a po e le të vdesë?”* Ishte ky momenti i ndjeshëm, ai ku nderi dhe njerëzorja përballeshin në zemrën e njeriut. Pas disa çastesh të heshtura, plaku u ngrit dhe e ktheu djepin mbarë. Kaq mjaftonte që gjaku të quhej i falur. Por për ta vulosur, zakonisht bëhej edhe një akt simbolik: ose fëmijës i priteshin flokët nga plaku, që bëhej kështu kumbar i tij, ose dy burrat e palëve pinin nga i njëjti kupë gjaku të holluar me verë, në një rit të njohur si “vëllazëria e gishtit”.

Pas kësaj dite, Gjetoja mund të dilte nga kulla. Jeta nuk do të ishte më si më parë, por ai nuk do të ishte më i mbyllur, nuk do të ishte më i rrezikuar. Ishte një mënyrë për të mbyllur plagën dhe për të ruajtur bashkëjetesën në një komunitet, ku njerëzit duheshin dhe ziheshin brenda të njëjtit mal, të njëjtës fushë dhe shpesh, të njëjtit gjak.

Kanuni nuk e nxiste hakmarrjen por përkundrazi, përpiquej ta rregullonte atë brenda kornizave të nderit dhe besës. Ai nuk linte hapësirë për hakmarrje të pamenduar apo për gjak pa kriter.

Vrasja kërkonte përgjigje, por kjo përgjigje duhej të jepte me urtësi, duke lënë mundësi për pajtim. Kanuni ofronte një formë drejtësie komunitare në mungesë të shtetit e për shumë kohë ishte e vetmja formë që garantonte rend dhe stabilitet në viset e thella malore.

Kulla e ngujimit, në këtë kuadër, nuk ishte simbol frike, por simbol i ligjit tradicional. Pleqtë ishin gjykatës, rojet ishin polici, dhe vetë kulla ishte gjykatë dhe burg njëkohësisht. Në mungesë të institucioneve moderne, kjo strukturë funksiononte me rregull, autoritet dhe respektohej plotësisht nga të gjithë.

Periudha kohore: Shekujt XV–XX

Përmbledhje historike e periudhës

Në viset e veriut shqiptar, për shekuj me radhë, rendi nuk garantohej nga shteti, por nga një sistem zakonor i përpunuar brez pas brezi: Kanuni i Lekë Dukagjinit. I përmbledhur më vonë nga At Shtjefën Gjeçovi, Kanuni ishte më shumë sesa një kod ligjesh, pasi ishte një mënyrë jetese, një sistem i drejtësisë tradicionale që rregullonte çdo aspekt të jetës në male; nga marrëdhëniet familjare, te ndarja e tokës, e deri te dënimi i krimeve më të rënda. Në këtë kontekst, “Kulla e ngujimit” merrte një funksion qendror. Ajo nuk ishte një vend strehimi për fajtorët, por një hapësirë ku ndalonte koha, ku drejtësia kërkohej jo përmes dhunës, por përmes durimit, heshtjes dhe pritjes. Kulla shërbente si një formë paraburgimi tradicional për autorin e një vrasjeje ose për anëtarët e familjes së tij, në mënyrë që të shmangej hakmarrja derisa të ndërhnin pleqtë për të gjykuar rastin.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në një shoqëri ku gjakmarrja ishte pjesë e strukturës së nderit, por gjithashtu rregullohej me përpikmëri nga Kanuni, ngujimi ishte një formë për të pezulluar përkohësisht hakmarrjen. Pas një vrasjeje, njerëzit e fshatit thërrisnin pleq të urtë dhe të njohur për drejtësinë, të cilët vinin për të hetuar rrethanat dhe për të përcaktuar nëse gjaku ishte i drejtë, ose nëse ishte i hapur pa të drejtë dhe duhej kërkuar pajtim. Autori i vrasjes dorëzohej i çarmatosur dhe i shoqëruar deri te kulla, ku mbahej nën roje nga djem të besuar. Aty priste në heshtje, pa dalë jashtë, derisa pleqësia të jepte vendimin. Vetë prania e një individi në kullë ishte një shenjë që ai e pranonte përgjegjësinë dhe ishte i gatshëm të përballej me drejtësinë sipas Kanunit.

Mesazhi

Kulla e Ngujimit mishëron një formë të drejtësisë tradicionale shqiptare, e cila kërkonte maturi, përgjegjësi dhe respekt për normat e komunitetit. Ajo nuk ishte vendi i hakmarrjes, por i ndalimit të dhunës. Ajo nuk ishte simbol i kanunit që nxit vrasjen, por i përpjekjes për të ndaluar gjakun përmes një drejtësie të mbështetur te fjala dhe besa. Sot, kur sistemi ligjor shtetëror është konsoliduar dhe gjakmarrja është refuzuar si praktikë, Kulla e Ngujimit mbetet një monument i kujtesës historike dhe shpirtërore. Ajo i flet brezave të rinj për një kohë kur drejtësia kërkohej në mënyrë të ndershme, por edhe me një çmim të lartë personal, me vite pritjeje, vetmi dhe ndëshkim. Vizita në një kullë të tillë, si ajo në Theth, është një rikthim në një botë ku fjala kishte peshë dhe nderi vlente më shumë se jeta.

Bibliografia

- Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shtëpia botuese “Kuvendi”, 2001

- Durham, Edith. *Brenga e Ballkanit dhe veprat të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, Shtëpia botuese “8 nëntori”, Tiranë 1990
- Reportazhe mbi Kullën e Ngujimit në Theth

Legjenda: “Vrima e Nuses në Kanionin e Osumit”

Thuhet se në një ditë pranvere, një karvan dasmor po udhëtonte përmes kanionit, - rrugë e njohur për bukurinë, por edhe rrezikun e saj. Në mes të këtij karvani ishte nusja. E veshur me të bardha me dantella, me bizhuteri të argjendta që vezullonin në dritën e pasdites dhe me një kurorë trëndafilash të njomë mbi ballë. Ishte e qeshur, e ndrojtur, e mrekulluar nga kanioni që për herë të parë e shihte. Por rruga u ndërpre papritur.

Një kalorës solli urdhër nga pashai i krahinës: Nusën duhet ta sjellin menjëherë tek ai. Pashai kishte dëgjuar për bukurinë e saj dhe, si shumë të tjerë para tij, kishte vendosur ta bëjë të vetën.

Burri i saj nuk mund të bënte asgjë. As prindërit. Heshtja ra mbi karvanin që, tani, nuk ishte më dasmor, por kortezh dhimbjeje. Nusja kërkoi veç një lutje. U largua vetë, duke iu afruar një cepi të kanionit ku shkëmbi shikonte drejt qiellit. Mbi buzë të shkëmbit, ngriti sytë nga qielli, preku tokën me ballë dhe tha: *“Nëse toka më pranon, atëherë s’do më prekë poshtërimi. Po nuk më pranoi, do jem e humbur për jetë.”* Dhe u hodh.

Atë çast, toka nuk u çka. Por u zbut. Në vendin ku ajo goditi, u krijua një vrimë e rrumbullakët, një boshllëk i përkryer në zemër të shkëmbit, nga i cili filloi të pikojë ujë, si një sy që qan gjithmonë. Uji nuk thahet kurrë, edhe në verë. Dhe mbi atë pikë, nuk rritet asnjë bar. Banorët thonë se aty qëndron shpirti i nuses, që s’e deshi pushtetin, s’e deshi frikën, por deshi vetëm nderin e saj dhe dashurinë që s’e tradhtoi kurrë.

Nëse ndalesh dhe sheh nga ai vend, dëgjon një zë të lehtë që të pëshpërit: *“Mos më prek me mëkat”*. Dhe, deri më sot, asnjë fshatar i Skraparit nuk kalon aty pranë duke kënduar a duke qeshur, por pa zhurmë, në respekt të jetës së humbur.

Periudha kohore: Shek. XVIII–XIX, me rrënjë më të hershme në traditat oralo-mitike të trevës së Skraparit dhe figurën arketip të “nuses martire” në trashëgiminë popullore ballkanike.

Përmbledhje historike e periudhës

Në një kohë kur Shqipëria ishte nën sundimin osman dhe krahinat malore të Skraparit ishin të marginalizuara, autoriteti vendor përfaqësohej shpesh nga bejlerë e agallarë të ashpër që ushtronin pushtet pa kontroll mbi popullatën vendase. Struktura sociale ishte e ndarë qartë: fshatarët ruanin ndershmërinë dhe besën, ndërsa autoriteti administrativ dhe ushtarak osman shpesh përfaqësonte arbitraritetet dhe abuzim. Në këtë sfond, kanionet e Osumit nuk ishin vetëm rrugë kalimi - por edhe hapësira të shenjta të mbijetesës, rezistencës dhe vetëmbrojtjes. Mes këtyre gurëve, erërave dhe ujërave të fshehta, kanë lindur rrëfime që sfidojnë heshtjen dhe tregojnë me zë të ngadalshëm se nderi është më i fortë se frika, dhe se gruaja shqiptare, edhe kur është e pambrojtur, është e pathyeshme.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Gjeografia dramatike e kanionit dhe tradita e fortë e ruajtjes së “nderit të gruas” ishin terren i përsosur për të lindur një rrëfim të këtij tipi. Kanioni me shkëmbinjtë e tij vertikalë dhe rrjedhën e thellë të Osumit, është vend që përthith tragjedi dhe i kthen në legjenda. Në një shoqëri ku gruaja rrezikonte gjithçka për të mos humbur nderin, rrëfimi për nusen që “shpëtoi shpirtin duke flijuar trupin” është shndërruar në kult të heshtur të moralit dhe guximit. Vrima që gdhendet në shkëmb pas aktit të saj nuk është thjesht një ndodhi fizike: është shenjë hyjnore që natyra e pranoi flijimin dhe e shndërroi në përjetësi.

Mesazhi

Ky rrëfim është një manifest i heshtur i guximit të gruas, i sakrificës për një ideal dhe i refuzimit të dhunës. Në një kohë kur shumë zërave të grave u mungonte forca e fjalës, ajo nuse foli me aktin më të madh të njeriut të lirë: vetëflijimin për vlera. Vrima e Nuses nuk është vetëm një formacion shkëmbor, por më tepër një monument shpirtëror.

Sot, kur dhuna ndaj grave vazhdon në forma të ndryshme, kjo gojëdhënë shndërrohet në kryqëzim të traditës me ndërgjegjen sociale. Ajo na mëson se vlera morale dhe guximi i gruas nuk njohin kohë. Prandaj, "Vrima e Nuses" nuk është thjesht një destinacion turistik, por një vend pelegrinazhi i heshtur për të gjitha gratë dhe burrat që i druhen pushtetit të padrejtësisë.

Bibliografia

- Haxhihasani, Sadik. Toponimia dhe gojëdhënat e Skraparit. Tiranë: Akademia e Shkencave, 1984.
- Lamaj, Thanas. Folklori i Beratit dhe Skraparit. Tiranë: Instituti i Kulturës Popullore, 1992.
- Elsie, Robert. Albanian Folktales and Legends. London: I.B. Tauris, 2001.
- Arkivi i IKTK, intervista të mbledhura në Skrapar (1973–1985).

Lojërat popullore shqiptare, Kujtim i gjallë i gëzimit dhe traditës

Në një lagje të Tiranës, oborri i gjerë i shtëpisë së gjysh Vathit ishte vendi më i preferuar nga të gjithë fëmijët e lagjes, sidomos gjatë pushimeve të verës. Gjysh Vathi ishte një burrë me mustaqe të bardha, i njohur për humorin e tij të hollë dhe historitë që rrëfente me aq shumë shije. Ai qëndronte ulur gjithmonë nën hijen e madhe të fikut të vjetër dhe vështronte me një buzëqeshje të ngrohtë nipërit dhe mbesat që luanin lojërat e tyre.

Një pasdite të ngrohtë korriku, pasi dielli kishte zbutur pak rrezet, një grup fëmijësh dhe adoleshentësh u mbledhën në oborrin e gjysh Vathit. Ishte radha për lojën e tyre të preferuar që ata e quanin *“Raqe raqe - hip e zdrop”*. Gjyshi doli nga veranda dhe duke marrë një degë të vogël thane, vizatoi në tokë një rreth dhe u tha fëmijëve të hidhnin shortin. Dy skuadrat u formuan shpejt e shpejt me nga gjashtë veta secila. Secili grup shkroi numrin e vet në tokë, duke e mbuluar mirë që të mos e shihte grupi tjetër. Pas disa çastesh tensionesh e të qeshurash, skuadra e Gentit e gjeti numrin e skuadrës tjetër dhe kështu, ata do të nisnin lojën si kalorës. Skuadra tjetër nisi të krijonte *“kalin”* e lojës.

Ardiani, që ishte më i gjati, u vendos i pari, duke u përkulur përpara dhe duke u mbështetur me sup mbi krahun e shokut të tij, Erjonit, i cili qëndronte me shpinë në murin prej guri të oborrit duke u shndërruar në jastëkun e lojës. Pas tij erdhën edhe të tjerët, që formuan një varg të gjatë dhe të fortë. Më pas filloi pjesa më zbavitëse dhe sfiduese. Kalorësit, duke qeshur e duke bërë shaka me njëri-tjetrin, zgjodhën fshehurazi numrin që do të sfidonte *“kalin njerëzor”*. Njëri pas tjetrit filluan të hidheshin mbi shpinat e shokëve, duke bërë kujdes që të mos rrëzoheshin apo të preknin tokën. Tensioni rritej bashkë me të qeshurat që shpërthenin sa herë dikush mezi mbante ekuilibrin. Kur kalorësit hipën të gjithë, Genti, i pari ndër ta, ngriti dorën dhe bërtiti me zë të lartë: *“Raqe raqe ki ki ko, sa gishta janë këto?”* – ndërsa ngrinte fshehtazi katër gishta lart. Ardiani, që mbante më shumë peshë se të gjithë në trupin e tij, mendohej seriozisht ndërsa shokët i jepnin sugjerime të ndryshme. Në fund, me një frymëmarrje të thellë, tha numrin katër. Një shpërthim brohoritjesh dhe të qeshurash shpërtheu në oborr. Grupi i tij ia kishte qëlluar saktë numrit. Të dyja skuadrat ndërruan vendet dhe loja filloi përsëri, mes të qeshurash dhe ngacmimesh të mira.

Gjysh Vathi, duke parë të gjithë këtë skenë, nuk përmbahej dot pa qeshur edhe vetë. Kjo lojë i kujtonte rininë e tij, kur së bashku me shokët luanin të njëjtën lojë poshtë hijes së një arre të madhe. Në fund të lojës, ndërsa dlersët u shkonin rrëke nëpër ballë dhe fytyrat u shkëlqenin nga kënaqësia, gjyshi u tregonte se në kohën e tij, kjo lojë bëhej edhe më e vështirë sepse shpesh fëmijët nuk kishin as këpucë, dhe duhet të përballonin tokën e ashpër me këmbët e zbathura.

Periudha kohore: Të trashëguara brez pas brezi, të dokumentuara qartë sidomos gjatë shekujve XIX–XX.

Përmbledhje historike e periudhës

Lojërat popullore shqiptare janë një dëshmi e jashtëzakonshme e një kulture të pasur dhe krijuese, e cila ka shoqëruar breza të tërë në Shqipëri përgjatë kohërave. Në mungesë të lodrave moderne dhe teknologjisë së avancuar, fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë shpiknin lojëra të cilat i luanin në ambiente të hapura si oborret e shtëpive, livadhet e blerta apo rrugicat e fshatrave e qyteteve të vogla. Këto lojëra nuk ishin vetëm një mënyrë për të kaluar kohën, por edhe për të kultivuar marrëdhënie sociale, bashkëpunim dhe aftësi fizike e mendore.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në shoqëritë tradicionale shqiptare, fëmijët kalonin kohën së bashku, duke përdorur krijimtarinë dhe imagjinatën për të shpikur lojëra që kërkonin pak ose aspak mjete. Në këtë kontekst, lojërat ishin jo vetëm argëtuese, por edhe mënyra më e mirë për të mësuar rolet sociale, bashkëpunimin dhe aftësitë fizike e mendore.

Mesazhi

“Raqe raqe - hip e zdrop” është një dëshmi e qartë e gëzimit që bashkon njerëzit në lojë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit, solidaritetit dhe frymës së grupit që krijohet mes pjesëmarrësve. Kjo lojë tregon qartë se thjeshtësia dhe kreativiteti janë më shumë se të mjaftueshme për të krijuar kujtime të bukura dhe për të forcuar lidhjet shoqërore. Në kohët moderne, kur teknologjia ka pushtuar kohën e lirë të fëmijëve, ruajtja dhe promovimi i lojërave të tilla tradicionale janë më të rëndësishëm se kurrë. Ato janë një mënyrë e mrekullueshme për të edukuar brezin e ri me vlerat e shëndetshme të bashkëpunimit dhe argëtimit në natyrë.

Bibliografia

- Shala, Luigj. Lojrat popullore, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2021

Vallja e Osman Takës – një akt lirie në hijen e vdekjes

Në oborrin e pallatit të Valiut të Janinës, në atë verë të fundit të shekullit XIX, toka nuk dridhej nga tronditjet e perandorisë që po shembej, por nga hapat që do të ndryshonin një jetë dhe ndoshta do të sfidonin vetë idenë e drejtësisë së kohës. I rrethuar nga ushtarë e zyrtarë dhe i shoqëruar nga populli i Janinës, ku nuk mungonin edhe familjarë të Valiut, ecte i lidhur një i ri nga Konispoli, me flokë të errët dhe shikim të palëkundur. Ai quhej Osman Taka. Një shqiptar nga krahina e Çamërisë, i dënuar me vdekje. Ecte me çap të matur, të lehtë e të sigurt, jo sikur po shkonte drejt trekëmbëshit të ngritur për të në mes të qytetit, por sikur po shkonte në një dasëm. Vështrimi i tij humbiste mes maleve të larta të zonës.

Historia e tij kishte nisur më parë, në fshatrat e qeta të Çamërisë. Sipas gojëdhënës, motra e pamartuar e Osmanit ishte përdhunuar nga disa ushtarë osmanë. Siç e kërkonte nderi i asaj kohe dhe i atij vendi, Osman Taka nuk mund të rrinte pa marrë hak. Ai vrau ata që kishin shkelur kufirin e pafalshëm. U ndoq, u kap, dhe përfundoi në burg, përpara drejtësisë së perandorisë. Dënimi ndaj tij ishte i ashpër, sepse u dënua me varje. Por edhe drejtësia osmane ruante një zakon të vjetër: të dënuarit mund të kërkonin një dëshirë të fundit.

Osman Taka, me një zë të qetë dhe të prerë, tha: *“Dua të kërcej. Vallen time. Një herë të fundit.”*

Valiu e pa me habi, pastaj me kureshtje. Nuk ishte një dëshirë e zakonshme. U pranua. U sollën daullet dhe fyelli. U thirrën edhe valltarë të tjerë nga Konispoli që gjendeshin aty. Kur hapat e parë ranë mbi tokën e oborrit, heshtja mbuloi gjithçka. Osman Taka nisi vallen me një hijeshi të rrallë. Nuk kishte asgjë të zakonshme në lëvizjet e tij, pasi ai nuk po kërcente si dikush që e dinte se do vdiste, por si një shpirt që sapo kishte lindur. Me çdo hap, ai ngjitej mbi dhimbjen e mbi frikën. Kur u gjunjëzua në mes të rrethit të valltarëve dhe u përkul pas, me kokën që preku tokën, kraharori i tij u hap. Një tjetër valltar, sipas traditës, vendosi këmbën mbi gjoksin e tij, një gjest që simbolizonte peshën e shtypjes, por edhe durimin e atij që nuk dorëzohet. Të gjithë menduan se gjithçka mbaroi. Por me një prekje të lehtë si vetë fryma, Osman Taka u ngrit. Ngadalë, duke u mbështetur vetëm mbi një dorë. Si një lule që çel nga dheu pas stuhisë. Si një popull që ngrihet nga rrënojat. Si një njeri që edhe i shtypur, ringjallet nga bukuria.

Valiu mbeti pa fjalë. Familja e tij heshti e mallëngjyer. Zonja e tij, foli e para: *“Një njeri që kërcen kështu, nuk mund të varet”*. Fjala mori dhenë. Të gjithë tundën kokën. Edhe ata që kishin humbur njerëz nga dora e tij, ndjenin se ai nuk ishte vrasës. Ishte një shpirt që shëronte përmes kërcimit.

Valiu, burrë i ashpër por i drejtë, më në fund u ngrit dhe tha: *“Ky njeri nuk do të vdesë sot. Ai do të jetojë që të kërcejë sërish. Dhe që ne ta kujtojmë, jo për gjakun, por për dritën që na dha”*.

Dhe kështu ndodhi. Osman Taka u kthye në Konispol. Ai nuk foli shumë. Por në netët kur hëna e plotë qëndron pezull mbi detin e Butrintit dhe era sjell tinguj nga malet e Çamërisë, djemtë e fshatit kërcëjnë vallen e tij. Në atë kërcim nuk ka vetëm hap dhe ritëm. Ka një histori. Një jetë që u shpëtua nga bukuria. Shtëpia e tij është ende aty. E rrënuar, por krenare. Pa

pllakë, pa monument, por plot me kujtime. Çdo vit, kur të rinjtë mësojnë të kërcejnë vallen e Osman Takës, ata mësojnë edhe një të vërtetë: ndonjëherë, vallja është më e fortë se vdekja.

Periudha kohore: Fundi i shek. XIX (periudha e Rilindjes Kombëtare)

Përmbledhje historike e periudhës

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, shqiptarët që ndodheshin ende nën sundimin osman filluan të organizohen më fuqishëm dhe me më shumë vetëdije drejt synimit për lirinë kombëtare dhe ruajtjen e identitetit të tyre kulturor. Kjo periudhë përkon me Rilindjen Kombëtare, një proces i shumëanshëm që nuk kufizohej vetëm në përpjekjet politike apo arsimore, por përfaqësonte një ngritje të përgjithshme shpirtërore dhe shoqërore të kombit. Kjo periudhë e artë përkon me përhapjen e gjuhës shqipe, përmes veprave të shkruara, kërkimin e të drejtave kombëtare, ndërtimin e shkollave dhe organizimin e qëndresës ndaj padrejtësive të administratës osmane.

Në këtë kontekst, kultura popullore si këngët, valljet e legjendat, nuk mbetën vetëm një formë argëtimi, por u shndërruan në një instrument të fuqishëm për mbijetesë, vetëdije kombëtare dhe rezistencë ndaj shtypjes. Kjo kulturë u bë zëri i një populli që, ndonëse i shtypur politikisht, vazhdonte të afirmonte identitetin dhe dinjitetin e tij përmes shprehjes artistike dhe simbolike.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Sipas gojëdhënës së trashëguar në trevat e Çamërisë, Osman Taka ishte një figurë e njohur për guximin, dinjitetin dhe shpirtin e tij të lirë. Rrëfimi popullor tregon se ai u arrestua dhe u dënua me vdekje nga autoritetet osmane, për shkak të një akti hakmarrjeje që kishte lidhje me një padrejtësi të rëndë ndaj familjes së tij. Asokohe ky veprim konsiderohej si diçka që vinte në vend nderin e humbur. Në prag të ekzekutimit, Osman Taka, në përputhje me një zakon të njohur të kohës që u lejonte të dënuarve të kërkonin një dëshirë të fundit, kërkoi të kërcente vallen e tij çame. Ajo që pasoi nuk ishte thjesht një akt simbolik, por një manifestim i dashurisë për jetën përballë vdekjes. Vallja, me lëvizje të ngadalta dhe të përmbajtura, me gjunjëzime solemne dhe ngritje të hijshme, u përjetua nga të pranishmit si një lutje pa fjalë, si një apel për jetë përmes bukurisë dhe dinjitetit. Sipas rrëfimit gojor, forca emocionale e atij çasti ndikoi ndjeshëm në zemrat e të pranishmëve, përfshirë edhe vetë familjen e Valiut të Janinës, i cili i fali jetën. Vallja që ai kërceu, që sot mban emrin e tij, u bë pjesë e kujtesës kolektive dhe e traditës popullore, jo vetëm si shprehje e artit të shqiptarëve, por si dëshmi e rrallë e fuqisë së shpirtit dhe bukurisë për të sfiduar vdekjen.

Mesazhi

Vallja e Osman Takës nuk është thjesht një pasuri e folklorit shqiptar, por një dëshmi e gjallë e rezistencës shpirtërore të shqiptarëve të Çamërisë për ruajtjen e dinjitetit familjar e kombëtar përballë padrejtësisë. E lindur në rrethana të errëta, kur perandoria osmane përpiqej të shtypte çdo shenjë kundërshtimi, kjo valle u kthye në simbol të një fitoreje jo ushtarake, por shpirtërore. Osman Taka, i lindur në Konispol, në zemër të Çamërisë, nuk u bë i pavdekshëm përmes armës, por përmes artit. Në epopenë e dhimbjes çame, vallja e Osman Takës merr një kuptim të ri. Ajo nuk është më vetëm një kujtim, por përfaqësim i vetë shpirtit të një populli të persekutuar, një shfaqje e hijshme krenarie, që nuk u mposht dot as nga shpatat osmane

dhe gjenocidi i mëvonshëm etnik. Sot, kërcimi i valles së Osman Takës i kujton brezave të rinj jo vetëm trashëgiminë e të parëve, por edhe dramën e një populli që kërkon ende drejtësi.

Bibliografia

- Fabrizio Polacco, "Osman Taka, a young warrior who saves himself from a death sentence...", 20/08/2018.
- Instituti i Kulturës Popullore, fondi "Çamëria"

Xhamia e Gjin Aleksit, ura e besimit ndërmjet kohëve

Në Delvinën e djegur nga luftërat e gjata për liri e ekzistencë lindi e u rrit një burrë i quajtur Gjin Aleks. Ishte nga ata njerëz që nuk kërkonte lavdi, por që gjithsesi mbetej në mendjen e të tjerëve. Prijës vendi, i krishterë nga feja dhe i marrosur pas dheut të të parëve të tij, Gjin Aleks ishte njeriu që ndërtonte kur të tjerët shkatërronin e përvëltonin gjithçka.

Thuhet se ai ngrii me mund dy kisha, atë të Rusanit dhe të Papuçisë dhe se fliste rrallë, por fjala e tij zinte vend. Ishte koha kur çdo ndërtim kishte një rëndësi më të madhe se mund të imagjinohej sepse një gur i vënë mirë, mund të qëndronte për qindra vjet.

Por nuk kaloi shumë, dhe një tjetër fuqi më e fortë, u shfaq në viset e Shqipërisë. Osmanët nuk erdhën thjesht si pushtues të huaj, por si një rend i ri, me ligj të huaj dhe besim të huaj. Shumë prej atyre që deri dje luteshin në kishë, tashmë ndodheshin përballë zgjedhjes së vështirë: të iknin apo të përshtateshin me besimin e ri fetar. Disa i braktisën kishat, të tjerë u përshtatën.

Gjin Aleks, siç thotë një gojëdhënë e ruajtur në zonë, zgjodhi të mos e linte fatin e popullit të tij në duart e të tjerëve. Ai pranoi fenë e re, por pa e braktisur shpirtin e tij. Vendosi që aty ku dikur kishte ndërtuar për të krishterët, të ndërtonte për myslimanët. Jo nga dashuria për sulltanin e as për para, por nga përgjegjësia për njerëzit e tij.

Atë mëngjes, kur vendimin e kishte marrë, Gjin Aleks zbriti në sheshin e fshatit dhe u drejtua nga burrat që po e prisnin. Fjalët i kishte të pakta, por të rënda: *"Nuk po ndërroj as kujtimin e të parëve tanë, e as vendin tim. Po ndërroj mënyrën si do ta mbroj këtë tokë. Këtu, ku dikur ndërtuam për shpirtin, do të ndërtojmë sërish. Një vend të ri lutjeje, për një kohë të re. Po gurët do jenë tanët, dhe emri, emri im do mbetet në portë. A jeni me mua?"*

Plaku Lekë, që kishte rritur tre djem në atë lagje, ngrii kokën dhe tha ngadalë, sikur pëshpëriste, ndonëse të gjithë e dëgjuan qartë e shkoqur: *"Po ti, Gjin, do të lutesh me ne?"*

Ai u përgjigj: *"Do të lutem që kjo tokë të mos na mallkojë, që të mos harrojmë kush ishim, edhe kur ndryshojmë në dukje. Unë do jem me ju. Por ky nuk është premtimi i një burri. Ky është premtim i gjithë vendit. Na bashkon gjuha, traditat e zakonet e popullit tonë dhe jo feja",* u përgjigj Gjini.

Një tjetër burrë, Tanushi, që kishte qenë shërbëtor në shtëpinë e tij, foli: *"Nëse do të jetë me dorën tënde e jo të të huajve, nëse do ngrihet me gurët tanë, atëherë po. Po na e drejtëve ti, ne vijmë pas teje."*

Të nesërmen filloi puna. Gurë, qerpiçë, mure të ringritur, duar që gdhendnin me kujdes, fjalë që nuk thuheshin, por kuptoheshin. Në atë kodër, populli i vogël i Delvinës ndërtoi xhaminë e vet, me heshtjen e të kaluarës dhe durimin e të tashmes.

Sot, kur kalon nëpër Delvinë dhe sheh xhaminë e vjetër mbi kodër, me gurët që s'kanë lëvizur prej shekujsh, ndjen një lloj qetësie që vjen jo nga madhështia, por nga përlësia. Ajo xhami nuk flet me zë të lartë, por flet drejt, sepse tregon historinë e një kohe të trazuar, ku njeriu zgjedh të mos zhduket, por të përshtatet pa harruar kush ishte.

Periudha kohore: Shekujt XVI–XVII**Përmbledhje historike e periudhës**

Shekujt XVI–XVII përbëjnë një periudhë vendimtare për shndërrimet fetare dhe kulturore në Shqipëri. Me konsolidimin e sundimit osman, në shumë zona të vendit filloi kalimi gradual nga krishterimi në besimin islam. Ky proces nuk ishte linear dhe homogjen, por i shtrirë në kohë dhe i ndikuar nga faktorë të ndryshëm politikë, ekonomikë, shoqërorë dhe shpirtërorë. Ndërkohë që ndërtimi i xhamive të reja dëshmonte konsolidimin e besimit islam, shumë kisha të vjetra u përshtatën për rite të reja, duke reflektuar jo vetëm ndryshimin fetar, por edhe një vazhdimësi të kujtesës kolektive. Në këtë sfond, Xhamia e Gjin Aleksit në Delvinë është një rast emblematic për ndërthurjen e besimeve dhe kujtesës historike.

Sipas të dhënave të mbledhura nga etnologët në vitet 1950–1960, Gjin Aleksi përshkruhet si një figurë historike që veçoi në prag të pushtimit osman në jug të Shqipërisë. Ai konsiderohej si një prijës vendas i krishterë i zonës së Delvinës, që kishte luftuar kundër forcave osmane, por edhe kundër venecianëve. Sipas kësaj tradite gojore, ai kishte ndërtuar dy kisha: atë të Rusanit dhe të Papuçisë. Pas rënies së Delvinës nën sundimin osman, këto kisha u shndërruan në xhami.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Xhamia e Gjin Aleksit është ndërtuar mbi themelet e një kishe të hershme. Shumë vizitorë e përshkruajnë këtë xhami si një nga objektet më të veçanta për nga ndërthurja arkitektonike. Struktura e saj përfshin elementë që tregojnë përdorimin paraprak si kishë, gjë që është e zakonshme për shumë ndërtesa fetare të zonës ballkanike gjatë shekujve të islamizimit. Xhamia gjendet në Delvinë, në një pozicion të ngritur dhe është ndërtuar me gurë të latuar me përpikmëri. Dritaret dhe kolonat ruajnë një stil që ndërlidhet me ndërtimet kishtare bizantine, ndërsa kupola dhe minarja janë shtesa osmane të mëvonshme. Kjo dëshmi materiale konfirmon se objekti nuk ishte ndërtuar nga e para, por ishte përshtatur me ndryshime të vogla për të përmbushur nevojat e ritit islam.

Mesazhi

Xhamia e Gjin Aleksit është shumë më tepër se një monument fetar. Ajo është një pikëtakim i memories historike me realitetin kulturor të ndryshimeve shoqërore. Ruajtja e emrit të një princi të krishterë në një objekt kulti islam flet për një ndjeshmëri të thellë ndaj historisë, për respektin që një komunitet ka treguar për të kaluarën e vet, pavarësisht transformimeve ideologjike apo fetare. Në këtë kuptim, xhamia është një simbol i tolerancës, i ndërgjegjes historike dhe i vazhdimësisë së identitetit lokal.

Kjo histori sjell një interpretim të rëndësishëm mbi ruajtjen e emrit të themeluesit origjinal, një figurë e krishterë, edhe pasi objekti u përshtat për fenë islame. Ky fakt tregon për një formë të trashëgimisë kulturore të ndërthurur, ku kujtesa e komunitetit i mbijetoi konvertimit fetar dhe krijoi një simbolikë lokale të vazhdimësisë dhe bashkëjetesës.

Bibliografia

- Kiel, Machiel. *Ottoman Architecture in Albania*. Istanbul: IRCICA, 1990.



- Elsie, Robert. *Historical Dictionary of Albania*. Lanham: Scarecrow Press, 2010.
- Instituti i Antropologjisë, fondi “Lluka Karafili”, legjenda dhe gojëdhëna nga Shqipëria e Jugut, 1950–1960.

Legjenda e Grykës së Vajës

Sipas gojëdhënës së ruajtur brez pas brezi në Malësinë e Krujës, ngjarja ndodhi në ditët e zymta që pasuan rënien e qytetit të Krujës më 16 qershor 1478, një moment vendimtar për fatin e trojeve shqiptare. Pasi muret e kështjellës ranë dhe porta u hapën për ushtrinë osmane, një valë e errët pasigurie dhe dhune nisi të përhapej në qytet dhe në fshatrat përreth. Njerëzit që kishin qëndruar me vite në mbrojtje të atdheut e kuptuan se gjithçka kishte ndryshuar. Për gratë e reja kjo do të thoshte përballje me një fat më të keq se vdekja: robëri, turp, dhunë, dhe ndoshta një jetë në haremet e pushtuesve.

Në këtë terr të frikshëm dhe pa shpresë, nëntëdhjetë vajza të reja krutane, shumica nga familje që kishin dhënë luftëtarë në mbrojtje të kështjellës, morën një vendim të jashtëzakonshëm. Në fshehtësi, gjatë natës, ato u ngjitën drejt një shkëmbi të lartë dhe të thepisur, në anën veriore të malit. Ishin të veshura me rrobat e tyre të thjeshta, me shallin mbi kokë.

Kishin ardhur në atë vend jo si viktimë, por si gra që donin të ruanin kontrollin mbi fatin e tyre, për të mos ia dhënë trupin asnjë pushtuesi, për të mos ia ulur nderin familjes, për të mos e ndotur kujtimin e të rënëve.

Me një lëvizje të heshtur, si të ishte një rit i përgatitur më parë, ato u hodhën njëherazi në humnerë. Trupat e tyre u zhdukën në errësirën e thellë të shkëmbinjve, ndërsa mbi sipërfaqe mbeti vetëm heshtja e rëndë.

Populli nuk i kujtoi me thirrje, por me respekt të thellë dhe me emërtim të përhershëm të vendit ku ndodhi tragjedia: Gryka e Vajës, ose Shkëmbi i Vashave. Thuhet se në atë vend, edhe era fryn më ngadalë, edhe gjëmat e natyrës kanë një përmbajtje solemne. Në ditë të qeta, malësorët thonë se jehona që vjen nga poshtë është si zëri i një kori të heshtur vajzash.

Ky akt i jashtëzakonshëm mbeti në kujtesën popullore jo si thjesht një ngjarje tragjike, por si një sakrificë e ndërgjegjshme dhe kolektive, një qëndrim i rrallë që thyen kufijtë e kohës dhe e ngre granat shqiptare në lartësinë e heroinës së heshtur, që nuk lufton me armë, por me dinjitet.

Periudha kohore: Shekulli XV

Përmbledhje historike e periudhës

Shekulli XV shënon përpjekjet e fundit të shqiptarëve për të ruajtur pavarësinë përballë zgjerimit të Perandorisë Osmane në Ballkan. Pas vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut në vitin 1468, fronti i qëndresës u dobësua, ndërsa qytete të rëndësishme si Kruja, që ishin mbrojtur për dekada, filluan të bien një nga një. Më 16 qershor 1478, pas një rrethimi të gjatë dhe të vështirë, Kruja u dorëzua përfundimisht. Me rënien e saj, jo vetëm që humbi një bastion

i rëndësishëm i rezistencës shqiptare, por edhe nisi një kapitull i ri i nënshtrimit politik, ekonomik dhe kulturor. Në këtë klimë pasigurie, të frikës dhe poshtërimit të mundshëm nga ushtria osmane, shumë gra dhe vajza përballeshin me zgjedhje të pamundura: nënshtrim ose vetëflim. Pikërisht në këtë kontekst lindi një nga legjendat më të fuqishme të sakrificës kolektive në historinë shqiptare.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Pushtimi i qytetit të Krujës nga osmanët u shoqërua me masa të dhunshme kundër popullsisë civile, përfshirë plaçkitjen, masakrat, djegiet dhe veçanërisht robërimin e grave dhe vajzave, të cilat konsideroheshin si plaçkë lufte. Në një rend shoqëror ku nderi dhe dinjiteti i familjes identifikoheshin ngushtësisht me pastërtinë e gruas, rreziku i robërisë dhe përdhunimit shihej si poshtërim i pashlyeshëm, jo vetëm personal, por edhe familjar. Kultura e kohës e përforconte rolin e gruas si ruajtëse e moralit dhe e vazhdimësisë së gjakut, dhe çdo akt që cenonte këtë dimension përjetohej si fundi i jetës me nder.

Në këtë realitet dramatik, për të shmangur robërimin, përdhunimin apo shitjen në tregjet e skllevërve, një grup prej 90 vajzash nga Malësia e Krujës, shumica nga familje që kishin kontribuar në mbrojtjen e qytetit, morën vendimin për vetëflim. Akti i tyre nuk ishte vetëm një refuzim ndaj robërisë fizike, por mbi të gjitha ishte një protestë e heshtur dhe tragjike ndaj zhdukjes së lirisë kombëtare e shpirtërore, nënshtrimit të trupit dhe dhunës ndaj gruas si bartëse e nderit, kujtesës dhe identitetit të një kombi. Ky vendim kolektiv përfaqësonte një formë të rrallë qëndrese pa armë – qëndresë përmes vetëflimit dhe ruajtjes së një të drejte që pushtuesi nuk mund ta merrte dot: të drejtës për të mos u kthyer në robëri pa vullnetin e vet.

Mesazhi

Kjo histori është një nga dëshmitë më të rralla të sakrificës kolektive të grave në historinë shqiptare. Ajo përçon mesazhin e ruajtjes së nderit dhe dinjitetit njerëzor përballë dhunës, si dhe thekson vlerat e qëndresës morale. Në qendër qëndron figura e gruas shqiptare si mbrojtëse e kufirit të fundit të lirisë, kur gjithçka tjetër është humbur. Ky akt vetëflimi nuk është një gjest dëshpërimi, por një qëndrim aktiv ndaj padrejtësisë dhe pushtimit, që ruhet në kujtesën historike si vepër heroike.

Gryka e Vajës është gjithashtu një potencial i madh për turizmin përkujtimor dhe kulturor, duke e kthyer këtë vend në një pikë takimi midis historisë, ndjenjës dhe angazhimit qytetar.

Bibliografia

- “Legjenda e Grykës së Vajës ose Shkëmbi i Vashave, çfarë ndodhi 539 vite më parë”, BalkanWeb, 19 qershor 2017.
- “90 vajza krutane u hodhën nga Shkëmbi i Vajës”, ObserverKult, 4 tetor 2023.
- Duka, Valentina. *Histori e Shqipërisë (nga lashtësia deri në vitin 1912)*, Tiranë: Kristalina KH, 2007.
- Instituti i Kulturës Popullore, *Tradita dhe Trashëgimia Gojore*, Tiranë: 1996.

Shenjtëria e Kaprollit, historia e drekës së thyer

Në një fshat të thellë malor, ku hijet e drurëve të vjetër mbulonin shtigjet dhe zëri i përrenjve përzihej me këngën e bilbilit, jetonin njerëz që e dëgjonin natyrën siç dëgjonin prindin a shenjtorin. Ata ecnin me kujdes në pyll, nuk preknin degë pa arsye, nuk ngrinin zë në mriz, sepse *“aty pushonte zoti i kafshëve”*, siç thoshin të moshuarit. Në ato anë, çdo gjë kishte frymë: dheu, bari, uji, madje edhe gurët. Por mbi të gjitha, aty jetonte edhe një kafshë që nuk prekej kurrë – kaprolli. E quanin *“i bekuari i pyllit”*, *“shpirti që sheh e s’flet”*..

Më i vjetri ndër ta, plaku Dodë, e mbante mend si sot një verë të largët kur gjyshi i kishte treguar për një kaproll që ishte shfaqur pranë stanit. Kishte zbritur vetëm, pa tufë, pa frikë, dhe kishte pirë ujë në kroin e poshtëm, pastaj ishte kthyer në pyll pa u kthyer kokën. *“Mos e prekni,”* kishte thënë gjyshi. *“Ai është i shenjë. Vjen kur koha është paqësuar, ose kur njerëzit kanë harruar të kenë frikë nga vetja.”*

Por koha rrjedh dhe me të vjen harresa. Ritet bëhen zakon, zakonet plaken dhe kujtimet thahen, e bien si gjethet në vjeshtë. Një verë, kur uji u pakësua dhe bagëtia u ligështua, djemtë e fshatit vendosën të ngjiteshin më thellë në mal për gjah. Ndër ta ishte edhe Leka. Një djalë i heshtur dhe i ndjeshëm, i cili herë dëgjonte njerëz që kaprollin e quanin “kafshë e shenjtë”, por shpesh herë edhe si “mish i rrallë për tryezë”. Por, kishte kohë që s’ishte parë ndonjë kaproll në ato anë dhe pylli e thërriste.

Pas një dite të gjatë ndjekjesh, aty ku pylli ishte më i dendur, aq sa dielli mezi depërtonte në të, u shfaq një kaproll. Ishte i hijshëm, me qafë të hollë dhe me lëkurë që i shkëlqente. Hodhi sytë nga gjuetarët e nuk lëvizi. Dukje se nuk kishte frikë. Ishte një qëndrim që të bënte të stepeshe.

“Nuk është gjah, por ogur,” tha njëri, me zë të ulët.

Por pushka krisi. Një shkrepje e vetme dhe kaprolli u rrëzua. Gjithçka mbeti në heshtje. Leka, që kishte shtënë, u afrua i pari. Kaprolli nuk kishte ngordhur ende. Frymëmarrja i dridhej dhe sytë i lotonin. Sytë e tij nuk ishin të një kafshe: ishin sy që pyesnin, sy që shikonin drejt në shpirt.

“Po qan,” - tha Leka, dhe gjaku i ngriu në trup. U ul pranë tij dhe nuk foli më. As kur të tjerët e thirrën për të ngritur trupin, as kur e nxitën të festonte. Në mbrëmje, pranë zjarrit, kur po piquin mishin dhe kupat trokëllinin, Leka qëndroi mënjane dhe tha veç një fjali: *“A ndjeni? Diçka që ishte me ne, nuk është më.”*

Fjalët nuk patën nevojë për shpjegim. Që nga ajo natë, askush nuk doli për gjueti kaprolli. Po ashtu, asnjë pushkë nuk u ngrit më edhe kundër sorkadhes apo dhisë së egër që zbriste në mëngjes afër fshatit. Në mriz, të gjithë shkonin me kokën ulur dhe pëshpëritnin *“Atje, në hijen e tij, kaprolli pret të mos harrohet.”*

Mali e mori vesh. Dhe një vit më vonë, kur bari u rrit i gjatë e i njomë, pasi uji nuk mungoi, plaku Dodë pa sërish një kaproll të ndalej pranë burimit. Ishte tjetër kaproll, sigurisht. Por qetësia e tij ishte e njëjtë. Një qenie që nuk kërkonte asgjë, veçse të mos cenohej.

Thonë se që atëherë, në atë fshat, askush nuk ngriti më dorë kundër kaprollit. Edhe kur të huajt vinin për gjah, vendasit u rrëfenin Drekën e Thyer dhe thoshin: *“Kaprolli nuk është mish. Është i shenjtë. Po e vrave, ke shkelur mbi atë që je vetë.”*

Periudha kohore: Nga lashtësia deri në shekullin XX

Përmbledhje historike e periudhës

Në traditën shqiptare, veçanërisht në zonat malore dhe rurale ku jeta ishte e lidhur ngushtë me natyrën, ekzistonte një ndjeshmëri e thellë ndaj kafshëve dhe peizazhit përreth. Që nga periudhat parakristiane e deri në fundin e shekullit XX, shqiptarët kanë kultivuar mite dhe zakone që mishërojnë një formë të hershme të ekologjisë kulturore, një respekt për krijesat dhe vendet që konsideroheshin të shenjta. Kafshë të caktuara, si kaprolli, sorkadhja apo dhia, por edhe drurë të mëdhenj që rriteshin pranë mrizeve ku pushonte bagëtia, përfaqësonin simbole të paprekshme, të shenjta, e të lidhura me botën hyjnore ose me fatin e komunitetit.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Shoqëria tradicionale shqiptare, e vendosur përballë sfidave të mbijetesës në një mjedis të egër por të pasur natyror, ndërtoi një sistem simbolik dhe normativ që shërbente si mburojë për ruajtjen e ekuilibrit natyror. Përtej funksionit mitik dhe fetar, këto ndalesa dhe besëtytni shërbenin edhe si mekanizma për të ruajtur burimet e jetesës: ujërat, pyjet, bagëtinë dhe kafshët e egra. Ndalohej vrasja e disa kafshëve, si kaprolli, për shkak të hijeshisë dhe sjelljes së qetë dhe të pafajshme, ndërsa dhitë e egra apo sorkadhja ruheshin si mbartëse të begatisë dhe pjellorisë. Po kështu, në mrize, pra ato zona të qeta dhe me hije ku bagëtia pushonte gjatë verës, nuk duhej bërë zhurmë, nuk duhej therur bagëti dhe as të priteshin drurët që i hijeshonin këto vende. Këto ishin jo vetëm zona të shenjta, por edhe ekologjikisht të domosdoshme për ciklin jetësor të barinjve dhe gjësë së gjallë.

Tregimi “Gjahu i Malësorëve” i Kostandin Kristoforidhit është një nga rrëfimet më prekëse që shpjegon këtë marrëdhënie mes njeriut dhe natyrës. Në të, një grup malësorësh niset për gjueti dhe pas shumë përpjekjesh, arrin të vrasë një kaproll. Gëzimi i zakonshëm i gjuetisë zbehet menjëherë kur njëri nga gjahtarët afrohet dhe sheh që kaprolli, i plagosur, *“qan si njeri”*. Kjo skenë e mbushur me dhimbje kthehet në një kthesë morale për gjahtarin, i cili shprehet i penduar, duke thënë: *“Më mirë të mos e kisha vrarë.”* Ky moment është një apel i fortë etik dhe filozofik, që ndan botën e instinktit nga ajo e ndërgjegjes. Kaprolli këtu nuk është më një gjah, por një qenie me ndjeshmëri, e shenjtëruar nga vetë forca e dhimbjes që shfaq. Kristoforidhi, përmes këtij rrëfimi, na lë trashëgimi një mit të fuqishëm për çdo kohë: natyra, nëse nuk trajtohet me respekt, shndërrohet në burim vuajtjeje fizike e shpirtërore për vetë njeriun.

Veç kaprollit, në zonat malore të Shqipërisë ekzistonin edhe tabu të tjera që ndalonin vrasjen e dhisë së egër apo sorkadhes, veçanërisht kur ato shfaqeshin vetëm pranë fshatit apo ishin shtatzëna. Njerëzit e kohës besonin në fuqinë mbrojtëse e shëruese të këtyre kafshëve. Po ashtu në zonën e Mirditës, etnologu Mark Tirta rrëfen për drurët e mëdhenj që rriteshin në mrize që kishin një status mistik, e prandaj në to s’mund të bëhej dru zjarri, nuk duhej të dëmtoheshin e madje ndonjëherë u ofroheshin flijime simbolike.



Këto rregulla zakonore, ndonëse nuk përmendin drejtpërdrejtë kaprollin, bartin ide të ngjashme mbi kufijtë e sjelljes së lejuar ndaj natyrës. Shenjtërimi i drurëve apo i kafshëve ishte në thelb një kod ekologjik i transmetuar gojarisht.

Mesazhi

Miti i shenjtërisë së kaprollit dhe tregimet popullore na kujtojnë se njeriu nuk është zot mbi natyrën, por pjesë e saj. Vrasja e kaprollit, në vend që të sjellë triumf, sjell pendim. Ky është një mësim i thellë moral që thekson nevojën për ndjeshmëri, respekt dhe vetëpërmbytje në raport me natyrën. Kjo trashëgimi kulturore përçon vlera të rëndësishme për marrëdhënien tonë me ambientin, ku mbrojtja e një kafshe ose e një druri është një akt që mbron edhe ekuilibrin e brendshëm të njeriut.

Bibliografia

- Kristoforidhi, Kostandin. *Gjahu i Malësorëve*, Ndërmarrja Shtetnore e Botimeve dhe Shpërndarjes, Tiranë 1950.
- Tirta, Mark. *Mitologjia ndër shqiptarë*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004.
- Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, botimi i përpunuar. Tiranë: Argeta LMG, 2001



Nëna Shqipëri, simboli i ndërgjegjes kombëtare

Në fillimvitin 1970, tre skulptorë shqiptarë punonin me përkushtim të pazakontë në një studio të heshtur të Tiranës. U ishte besuar një detyrë e jashtëzakonshme: ngritja e një përmendoreje për Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, që nuk do të përkujtonte thjesht të rënët, por do të mishëronte vetë ndërgjegjen kombëtare.

Ata nuk synonin të ngjisinin në lartësi një figurë të zakonshme. Por, ata kërkonin një qendër graviteti shpirtëror, një trup që të mbante kujtesën dhe frymëzimin e një kombi të tërë, një figurë që të mos përfaqësonte vetëm të kaluarën, por edhe thirrjen morale për të ardhmen.

Në mes të punës, në heshtjen e ngjeshur me baltë dhe mendim, ata bisedonin me njëri-tjetrin:

- *“Duhet të qëndrojmë, siç ka qëndruar Shqipëria”,* - foli njëri prej tyre.
- *“Duhet të mos flasë, por të të përflakë me vështrim”,* - shtoi tjetri.
- *“Dhe duhet të jetë nënë”,* - e mbylli diskutimin kolegu tjetër. – *“Nënë që nuk i qan bijtë, por u jep përjetësinë”!*

Gjatë ditës modelonin me ngulm: një trup i drejtë, një kokë e lartë dhe e përmbajtur, fytyra pa individualitet të përcaktuar, por me tipare që do t'i përkisnin çdo shqiptareje në të gjithë rrjedhën e historisë.

Por nata sillte me vete një tjetër dimension. Në qetësinë e orëve të vona, balta dukej sikur merrte frymë. Një zë i brendshëm, i dalë prej guri e dheu, u fliste heshtur mjeshtërve që e punonin:

“Unë jam Nëna Shqipëri.

Ju më jepni formë, por unë kam lindur para shekujsh.

Kujdesem për bijtë që kanë rënë për Atdheun dhe i mbaj përherë pranë meje.

Jam kujtesë e përgjakur, por edhe frymëzim që pret t'i flasë brezave që vijnë.

Mos më bëni të bukur.

Më bëni të denjë për dhimbjen dhe krenarinë që përfaqësoj.

Qëndrimi im le të jetë urdhër i heshtur dhe pamja ime le të jetë më shumë ndërgjegje, sesa dekor.”

Kur përmendorja u përfundua dhe u vendos në kodrën e varrezave në vitin 1971, shumë prej atyre që e panë për herë të parë nuk gjetën fjalë. Ajo nuk kërkonte as duartrokitje, as himne. Me një lartësi prej 12 metrash, qëndronte jo si imitim i një gruaje të gjallë, por si përfaqësim i gjithë grave shqiptare që kishin lindur e përcjellë djem në luftë, që kishin mësuar gjuhën shqipe në fshehtësi, që kishin mbajtur ndezur flakën e identitetit ndër shekuj.

“Nëna Shqipëri” qëndron e drejtë, me një kompozim të theksuar vertikal, e ngurtë, pa ornament dhe pa zbukurime, e ndërtuar si një shtyllë force, për të përçar autoritet dhe qëndrueshmëri. Dora e ngritur nuk bekon, as nuk përqafton – ajo thërret! Ajo kërkon përkushtim, përgjegjësi, ndjenjë për një atdhe që nuk është dhuratë, por amanet i vjetër.

Në vështimin e saj nuk ka mall, as dhimbje. Ka thirrje! Ajo edukon në heshtje! Ajo përpiqet të flasë me çdo brez që ecën përballë saj. Është një monument ndërgjegjeje e memorieje. Një pikë referimi për të kuptuar jo vetëm kush ishim, por çfarë duhet të jemi.

Që prej asaj dite, përmendorja nuk u bë thjesht vend homazhi për të rënët. U bë vend i reflektimit kombëtar. U bë një shkëmb bronzi dhe fryme, ku përplasen heshtur kujtimi dhe sfida, nderimi dhe përgjegjësia. Nëna Shqipëri, qëndron aty, ditë e natë, duke u kujdesur për dëshmorët e saj, dhe duke frymëzuar brezat që ngjiten për ta parë. Nuk flet me zë, por kush ndalet përballë saj, dëgjon pa gabuar pyetjen që përsëritet në çdo kohë:

“A e do sa duhet këtë tokë? A e meriton këtë nënë?”

Periudha kohore: Artistikisht shek. XX. Si ndjenjë kombëtare – shekullore.

Përmbledhje historike e periudhës

Koncepti i “Nënës Shqipëri” nuk është një sajese letrare apo politike. Ai është mishërim i një ndjenje të thellë kolektive që ekzistonte te kombi shqiptar shumë përpara formulimeve ideologjike të Rilindjes Kombëtare. Shqiptarët, edhe në periudhat kur nuk kishin shtet, e perceptuan veten si një bashkësi gjaku, gjuhe dhe zakonesh. Këtë bashkësi e përfytyruan shpesh si një nënë simbolike që ruan, thërret, mbron dhe qorton bijtë e saj. Qysh në lashtësi, mesjetë edhe më vonë, gjuha shqipe, e drejta zakone, zakonet e të parëve dhe këngët e trimërisë ishin format e ruajtjes së një vetëdijeje që ende nuk mund të quhej kombëtare, por që i paraprinte asaj.

Në periudhën e Rilindjes Kombëtare, kjo ndjenjë e vjetër mori emër dhe fjalë. Në poezitë e Naimit, në betimet e Abdyl Frashërit etj., u bë e qartë se shqiptarët ishin bij të një nëne, Nënës Shqipëri. Kjo “nënë” ishte gjuhë, ishte histori, ishte kujtesë kombëtare që ushqente shqiptarizmin.

Kështu, identiteti kombëtar shqiptar në shek. XIX nuk është një konstrukt i huazuar apo romantik, por është përmbledhje dhe artikulum i një ndjenje përbashkësie që jetonte në gojëdhëna, në kanune, në këngët e kreshnikëve dhe në ritualet e përbashkëta të festave e mortit. Figura e Nënës Shqipëri lindi në këtë kontekst si mbiemër shpirtëror i Atdheut, duke u bërë simbol i bashkimit përmes përkatësisë.

Kushtet që sollën lindjen e simbolikës

Shekujt e gjatë të pushtimeve të huaja nuk e arritën dot nënshttrimin dhe asimilimin e shqiptarëve. Përkundrazi, ato stimuluan rritjen e ndjenjës së mbijetese etnike e kulturore, çka u transmetua nga brezi në brez nëpërmjet trashëgimisë shpirtërore. Kjo ndjenjë përkatësie, ndonëse nuk kishte ende emrin e një identiteti kombëtar të artikuluar, jetonte si ndërgjegje etnike dhe kulturore: në rituale të përbashkëta, në kodin zakonor, në refuzimin e përzierjes gjuhësore dhe në ruajtjen e emrit të të parëve.

Kjo vetëdije u ngjesh dhe u thellua gjatë shekujve XVIII–XIX, kur nisën të marrin trajtë të mëvetësishme gjuha shqipe, mitologjia historike dhe kujtesa për figurën e Skënderbeut, si prijës i lirisë dhe nderit. Këto elemente nuk ishin të shpikura rishtazi, por u aktivizuan dhe u simbolizuan në mënyrë të re, për të krijuar ndjesinë e një trashëgimie të përbashkët.

Në këtë proces përforcues të kujtesës kolektive dhe shpirtit të bashkimit, figura e Nënës Shqipëri mori trajtë shpirtërore dhe emocionale përmes grave shqiptare. Në këngët mortore ku qanin jo vetëm të vdekurit, por edhe dhimbjen e atdheut të plagosur; në urimet e dasmave ku përmendej malli për vendlindjen; dhe në epikat familjare ku Atdheu përfytyrohej si një nënë

që pret, lutet apo mallkon, u formua një figurë universale që mishëronte dhimbjen dhe dashurinë për tokën amë. Kjo nënë ishte e lënduar, e gërmuar, e nëpërkëmbur, por gjithmonë e gjallë dhe thirrëse – një simbol i pashuar i qëndresës dhe shpresës.

Ndryshe nga figurat simotra të kombeve të tjera, të cilat shpesh lindën si përfaqësime të shtetit modern ose të idealit republikan, Nëna Shqipëri nuk u artikulua nga lart-poshtë, si simbol i një ideologjie shtetformuese. Ajo lindi nga poshtë-lart, si frymë popullore, si ndjenjë që përshkoi këngët, lutjet, ritualet dhe qëndresën e grave dhe burrave të zakonshëm.

Prandaj, veçantia e Nënës Shqipëri qëndron në rrënjët e saj etike dhe shpirtërore, në lidhjen me gjakun, gjuhën dhe dheun, jo me doktrina politike të momentit. Ajo është më pak një alegori e shtetit dhe më shumë një ndërgjegje kolektive kombëtare, që i ka paraprirë dhe i ka mbijetuar çdo regjimi.

Mesazhi

Nëna Shqipëri nuk është thjesht një figurë artistike, as një objekt monumental që përkujton një epokë të shkuar. Ajo është përfytyrimi më i përmbledhur i ndërgjegjes kolektive shqiptare, i atij zëri të brendshëm që ka ruajtur identitetin kombëtar në shekuj, pa pushtet e pa kurorë, por me kujtesë të gjallë dhe gjuhë të pashuar. Nuk është vetëm nëna e atyre që ranë, por edhe kujdestare e atdheut në gjithë përmasat e tij: tokës, gjuhës, nderit, përkatësisë kombëtare.

Ajo qëndron jo për të vajtuar, por për të urdhëruar në heshtje. Ajo nuk thërret për të kaluarën e lavdishme, por si barrë e shenjtë që kërkon vazhdimësi. Nëna Shqipëri i kujton çdo brezi se shqiptar nuk bëhesh vetëm nga emri i mbiemrit, por nga përkushtimi ndaj tokës që të rriti, ndaj gjuhës që flet dhe ndaj gjakut që të mban gjallë dinjitetin. Është përfytyrimi i asaj që nuk dorëzohet, as kur të tjerët largohen, as kur koha ndryshon, sepse është rrënjë, zemër dhe kujtesë.

Bibliografia

- Moikom Zeqo – *Misteret e figures*. Tiranë: Onufri, 2001.
- Fuat Dushku – *Art dhe ideologji: monumentet në Shqipëri (1945–1990)*
Tiranë: Akademia e Shkencave, 1985.
- Muntaz Dhrami – *Rruga ime në skulpturë: Kujtime dhe reflektime mbi artin monumental*, Tiranë: Uegen, 2012

Nënë Tereza, shenjtoria e mëshirës

Në një botë ku fjalët shpesh humbin kuptimin, Nënë Tereza foli me vepra. Me duart e saj të vogla, ajo i lau plagët e lebrozëve, mbajti në prehrin e saj fëmijë të braktisur, i fshiu ballin e fundit të sëmurëve që po jepnin shpirt. Nuk kishte frikë nga pislleku, nga era e rëndë e vdekjes apo nga shikimi bosh i dhimbjes. Ajo shkonte aty ku askush nuk guxonte, në lagjet më të varfra të Kalkutës, mes barakash, rrugësh të pluhurosura dhe shpirtrash të harruar.

E vogël në trup, por e madhe në shpirt, ajo ndërtoi një tempull mëshire që nuk kishte mure, por zemra njerëzish. E jetoi jetën në heshtje, pa kërkuar lavdi, pa zhurmë, pa kamera. Dhe kur u nda nga kjo botë më 5 shtator 1997, ishte sikur një dritë u fik. Por në të vërtetë, ajo nisi të ndriçonte më shumë se kurrë.

Pas vdekjes së saj, Kisha Katolike hapi procesin e shenjtërimit. Por ajo nuk kishte kërkuar kurrë të ishte shenjtore. Për të, çdo njeri kishte dinjitet dhe çdo vepër dashurie vlente më shumë se çdo titull. Ajo thoshte se *“ne nuk jemi thirrur të jemi të suksesshëm, por të jemi besnikë”*. Dhe ajo ishte besnike deri në fund.

Sidoqoftë, mrekullitë që ndodhën pas vdekjes së saj nuk mund të shpërfillëshin.

E para ndodhi në Indi, aty ku ajo kishte kaluar pjesën më të madhe të jetës. Një grua e varfër, Monica Besra, vuante nga një tumor i rëndë. Ajo nuk kishte para për ilaçe, as mbështetje. Por kishte besim. Iu lut Nënës Terezë me zemër të thyer dhe pas pak ditësh, pa asnjë ndërhyrje tjetër mjekësore, tumori u zhduk. Mjekët nuk patën shpjegim, por familja e saj e dinte mirë se kush kishte ndërhyrë. Për ta, ajo nuk ishte një ish-murgeshë – ishte një dritë që ende jetonte.

E dyta ndodhi në Brazil. Një burrë i ri, i sëmurë rëndë, i shtruar në spital dhe në koma, u shpall pa shpresë. Mjekët i thanë familjes të përgatitej për fundin. Por familja nuk u dorëzua. Ata vendosën një fotografi të Nënës Terezë mbi jastëk dhe iu lutën me gjithë shpirt. Kaluan ditë të gjata pa përgjigje, dhe pastaj, papritur, ndodhi ajo që askush nuk mund ta shpjegonte: i riu hapi sytë. Ishte gjallë. Dhe kështu, ajo preku për së dyti botën me një mrekulli.

Më 4 shtator 2016, nën qiellin e hapur të Vatikanit, Papa Françesku shpalli Nënë Terezë shenjtore. E quajti *“shenjtoria e mëshirës”*. Njerëz nga mbarë bota, të çdo feje, ngjyre e kombësie, u bashkuan për të nderuar jetën e saj. Sepse ajo nuk i përkiste më vetëm katolikëve, as vetëm shqiptarëve apo indianëve. Ajo i përkiste njerëzimit. Ishte zëri i të heshturve dhe shpresa e atyre që nuk kishin askënd.

Në atë ditë, shqiptaria – si ndjenjë e përbashkët, si kujtesë gjaku dhe frymë shpirtërore – e përqafoi bijën e vet me një krenari të heshtur. Emri i saj u përmend në Shkup, në Tiranë, në Prishtinë, në Ulqin, në Tetovë, në Preshevë e deri në viset e arbëreshëve. Në shtëpitë e thjeshta shqiptare u ndezën qirinj, në kisha e xhami u ngritën lutje, e në zemrat e njerëzve ndriçoi bindja se njëra prej tyre, një bijë e kësaj toke, kishte shkuar në qiell si dritë e pastër njerëzore.

Ajo kishte qenë gjithmonë e pranuar, gjithmonë e dashur, por atë ditë u bë pjesë e përjetshme e shpirtit tonë. Jo sepse ishte e famshme, por sepse ishte e vërtetë. Nuk kërkoi pushtet, nuk desh lavdi, por përulur u dha dashuri atyre që nuk kishin asgjë. Ishte ndoshta e vetmja shqiptare që arriti t'i bashkojë të gjithë – të krishterë, myslimanë, ateistë – rreth vlerës më të thjeshtë e më të fortë: dashurisë.

Ajo e pati thënë vetë më mirë se kushdo: *“Nëse nuk mund të bësh gjëra të mëdha, bëj gjëra të vogla me dashuri të madhe.”* Dhe ishte pikërisht kjo dashuri që e bëri të pavdekshme.

Periudha kohore: 1910–1997, me ndikim që shtrihet përtej jetës së saj fizike, deri në ditët tona.

Përmbledhje historike e periudhës

Fillimi i shekullit XX përbëhej nga përplasja të mëdha mes perandorive dhe lindjes së kombeve. Ballkani digjej nga luftërat, Shqipëria sapo kishte shpallur pavarësinë, ndërsa në viset shqiptare jashtë kufijve, si në Shkup, shqiptarët përballeshin me represion, varfëri dhe margjinalizim. Ishte një kohë kur identiteti shqiptar mbahej gjallë më shumë nga fjala, zakoni dhe sakrifica sesa nga shteti. Në këtë realitet, lindi një vajzë e vogël me emrin Gonxhe, në një familje shqiptare katolike të përkushtuar, e cila më vonë do të njihej nga bota si Nënë Tereza.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në një botë të ndarë mes Lindjes e Perëndimit, midis pasurisë ekstreme dhe mjerimit të thellë, u formësua një shpirt që zgjodhi jo të predikojë, por të jetojë dashurinë. Shkupi i asaj kohe ishte një qytet me shumë kultura, me tensione politike dhe ndarje fetare, por njëherazi edhe një vend i heshtur ku rrënjët shqiptare, të krishtera e myslimane, ruanin një frymë të përbashkët njerëzore. Edukimi fetar i marrë në familje dhe në rrethin jezuit e solli Gonxhen drejt një thirrjeje që do ta çonte larg vendlindjes, por kurrë larg prejardhjes.

Mesazhi

Në një botë të tejmbushur me fjalë boshe dhe protagonizëm të zbrazët, figura e Nënë Terezës është një sfidë për të gjithë ne. Ajo është një kujtesë se dashuria nuk ka komb, por ka rrënjë. Në një kohë kur identiteti shpesh matet me flamuj e deklarata, ajo e lidhi shqiptarinë me përulësinë, shërbimin dhe sakrificën. Shenjtorja shqiptare na thotë ende sot: *“Nëse nuk ke ç’të japësh, jep një buzëqeshje. Dhe mbi të gjitha, të jesh njeri”*.

Bibliografia

- Spink, Kathryn. *Mother Teresa: A Complete Authorized Biography*. HarperOne, 2011.
- Egan, Eileen. *Such a Vision of the Street: Mother Teresa – The Spirit and the Work*. Doubleday, 1985.
- Congregation for the Causes of Saints, *Decree on the Miracle for the Canonization of Mother Teresa*. Vatican Press, 2015.

- Kisha Katolike Shqiptare, *Nënë Tereza – Shenjtëresha Shqiptare e Dashurisë*.

Kodikët e Beratit

Në qytetin e një mbi një dritareve, në Kalanë e Beratit, njerëzit flisnin gjithmonë nën zë për dy libra të shenjtë e të rrallë – të shkruar me germa të arta mbi purpur, të ruajtur si amanet. Thuhej se këto dorëshkrime të shenjta nuk ishin vetëm fjalë, por dritë që kalonte përmes heshtjes së shekujve.

Në vitin 1865, udhëtari francez Pierre Batiffol mbërriti në Berat dhe i zbuloi këta dorëshkrime, duke i përshkruar me admirim të thellë. Por historia e tyre kishte nisur shumë më herët.

Në vitin 1356, kur trupat serbe dogjën Beratin, meshtari Skuripeqi dhe murgu Theodhulos mbushën disa thasë me dorëshkrime dhe i fshehën në galeritë e kishës për të shpëtuar shkrimet nga zjarri. Këto dorëshkrime, ose sikurse quhen ndryshe Kodikët, i mbijetuan edhe Luftës së Parë Botërore, ku tentuan t'i grabisin austriakët; edhe pushtimit italian të vitit 1939 dhe më pas, gjermanëve që kërkonin t'i merrnin si relike.

Një nga mbrojtësit më të heshtur të kësaj trashëgimie ishte prifti Papapavli, i cili ia tregoi të birit, Nasit, vendin se ku ishin fshehur Kodikët: nën një kapak druri në Kishën e Shën Trinisë. Pas vdekjes së të atit, Nasi Papapavli u kthye nga emigracioni dhe trokiti në Institutin e Shkencave në Tiranë, në vitin 1956. Takoi Prof. Aleks Budën, të cilit ia rrëfeu historinë. Prof. Buda e mori seriozisht çështjen dhe ia përcolli pushteti vendor në Berat. Po ashtu, ai shkoi vetë disa herë në qytet për të kërkuar.

Por Kodikët nuk u zbuluan menjëherë. Nasi Papapavli, për plot 15 vjet me radhë, erdhi çdo dy javë në Institutin e Shkencave me të njëjtën pyetje: *“A keni mësuar gjë për kodikët?”*

Më në fund, në vitin 1968, kodikët u gjetën në një nga kishat e Kalasë, të mbështjellë me cohë, të dëmtuar nga lagështira, por të paprekur në shpirt. U dërguan për restaurim në Kinë dhe, pas rikthimit, u depozituan në Arkivin Qendror të Shtetit, ku ruhen edhe sot e kësaj dite.

Më 28 janar 1972, në gazetën *“Zëri i Popullit”*, Prof. Aleks Buda publikoi artikullin që shpalli rëndësinë e zbulimit të Kodikëve dhe përmendi me respekt Nasi Papapavlin, “patriotin plak”, i cili për një dekadë e gjysmë mbajti të gjallë amanetin.

Kur i biri i Papapavlit e falënderoi Budën, ky u përgjigj me një fjali të thjeshtë, por domethënëse: *“U çlirova nga një barrë e rëndë morale ndaj babait tuaj. Ai nuk pushoi për 15 vjet. Erdhi pa pushim...”*

Periudha kohore: Shekujt VI–XIV e.s.

Përmbledhje historike e periudhës

Gjatë mesjetës së hershme dhe të vonë (shek. VI–XIV), Berati ishte një nga qendrat më të rëndësishme kishtarë dhe kulturore në jug të Shqipërisë. I përfshirë në sferën bizantine, qyteti përjetoi një lulëzim të jetës religjioze dhe intelektuale. Manastiret dhe kishat e zonës u shndërruan në qendra të shkrimit (skriptore), ku u përkthyen, u kopjuan dhe u stolisën dorëshkrime të shenjta. Këto dorëshkrime shërbenin si bartës të dijes teologjike, liturgjike dhe gjuhësore të kohës. Dorëshkrimet ruheshin si objekte të shenjta, dhe shpeshherë përdoreshin për përhapjen e mësimave të krishtera në mbarë territorin. Pavarësisht pushtimeve dhe lëvizjeve politike, Berati ruajti identitetin e tij si qendër e peshës shpirtërore ortodokse në trojet shqiptare.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Kodikët e Beratit u shkruan me dorë mbi pergamenë dhe letër, në kushte të veçanta skriptorale, nga murgj dhe klerikë të arsimuar. Përkushtimi i klerit ortodoks, izolimi gjeografik i Kalasë së Beratit dhe ndjenja e shenjtërisë së librit luajtën rol vendimtar në ruajtjen e tyre. Në kohë pushtimesh dhe përndjekjesh, kodikët fshiheshin në mënyrë të kujdesshme, ndërsa populli i besimit dhe kisha i konsideronin si amanet të shenjtë të përbashkët. Tradita e përcjelljes së tyre nga brezi në brez, shpesh në heshtje e me përkushtim, bëri të mundur që kjo pasuri unike të mbijetojë deri sot.

Nga gjithë kodikët e ruajtur në Berat, dy janë më të vjetrit dhe më të çmuarit: Kodiku i Purpurt i Beratit (*Codex Purpureus Beratinus*), shek. VI – përmban fragmente nga ungjijtë e Mateut dhe Markut, i shkruar mbi pergamenë të purpurt me germa ari dhe argjendi. I dyti, Kodikusi i Artë (*Codex Aureus Anthimi*), shek. IX – përmban të katër ungjijtë në formë të plotë, i shkruar me përkujdesje të jashtëzakonshme dhe stolisje të sofistikuar. Këta kodikë përfaqësojnë një trashëgimi unike në Evropë për nga teknika, përmbajtja dhe ruajtja. Janë dëshmi e lidhjes së hershme të Shqipërisë me kulturën kristiane lindore dhe i japin Beratit statusin e një qyteti muze të trashëgimisë shpirtërore të Ballkanit.

Mesazhi

Në shoqërinë e sotme të konsumit dhe rrjeteve sociale, ku fjalët shpesh humbin kuptimin dhe historia lihet pas dore, Kodikët e Beratit na kujtojnë domosdoshmërinë e kujdesit për trashëgiminë kulturore. Ata janë një thirrje për të ruajtur identitetin tonë nëpërmjet dijes, gjuhës dhe besimit në vlera që i mbijetojnë kohës. Më shumë se objekte muzeale, ata janë pasqyra ku mund të shohim se çfarë kemi qenë dhe çfarë rrezikojmë të harrojmë. Në një kohë të sfidave globale dhe të fshirjes së dallimeve kulturore, kuptimi i thellë i kodikëve qëndron te vetëdija se çdo brez ka detyrën jo vetëm të njohë, por edhe të mbrojë kujtesën shpirtërore të kombit.

Bibliografia:

- Buda, Aleks. “Zbulimi i dy kodikëve të Beratit”, *Zëri i Popullit*, 28 janar 1972.
- Sinani, Shaban. *Berat, Beratinus, Buhara*, Naimi, Tiranë, 2004.
- Polovina, Ylli. “Kush i Zbuloi Kodikët e Beratit”, *Shqiptarja.com*, <https://shqiptarja.com/lajm/misteri-kush-i-zbuloi-kodiket-e-beratit-psalti-papapavli-aleks-buda-apo-sigurimi-i-shtetit>.
- Sahatçiu, Parashqevi. “Enigma e kodikëve të Beratit. Si arriti t’i shtjerë në dorë Sigurimi i Shtetit”, *Gazeta Shqiptare*, shtojca “Milosao”, 12 qershor 2011

Udha e krushqve, udhëtimi i shenjtë i martesës shqiptare

Në mëngjesin e asaj të dite të qetë vere, rrugët e fshatit gumëzhnin ndryshe. Burrat më të urtë të fisit, të veshur me kostume tradicionale, u mbledhën njëri pas tjetrit si në një procesion solem. Në krye të grupit ishte “kryekrushku”, zakonisht një burrë i moshuar e me përvojë, që njihte zakonet dhe dinte si të nderonte të dyja familjet. Ai udhëhiqte grupin jo vetëm në rrugë, por edhe në fjalë, në përshëndetje e në trajtim të situatave të mundshme.

Mes gjelbërimit dhe gurëve të mëdhenj që përshëndesnin kohën, nisi rruga e krushqve. Jo thjesht një udhëtim për të marrë një nuse, por një kalim i shenjtë, një rit i lashtë që rridhte nga zemra e zakoneve shqiptare. Krushqit nuk udhëtonin në heshtje. Ata këndonin. Kënga ngjitej në ajër, e përzier me tinguj çiftelie dhe jehona fyejsh. Në duar mbanin armët e dekoruara, jo për frikë, por për zakon: krushqit nuk shkonin të paarmatosur. Kishte raste, rrëfenin të vjetrit, kur ndonjë hasëm përpiquej të ndalte dasmën e të njolloste nderin. Për këtë arsye krushqit nuk ishin vetëm këngëtarë, por edhe rojtarë të nderit të shtëpisë së djalit.

Sidoqoftë respekti për kalimin e karvanit të krushqve ishte i rregulluar hollësisht edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Krushqit ndaleshin herë pas here. Nuk ishin ndalesa për të pushuar. Ishin stacione shpirtërore. Pranë një guri të madh, kryekrushku derdhi një pikë verë dhe hodhi një monedhë mbi tokë. Të gjithë heshtën. Ai tha me zë të ulët: *“Për fatin e mirë të çiftit. Për rrugë të mbarë. Për jetë të gjatë”*. Disa hodhën sytë nga qielli. Disa të rinj ngritën doli. E dinin se kjo nuk ishte vetëm një martesë, por ishte një aleancë. Dy familje, dy shtëpi, dy histori po bëheshin një. Dhe kjo s’mund të ndodhte pa rrugën e shenjtë që të çonte nga dera e vajzës te pragu i burrit.

Në shtëpinë e nuses, gjithçka kishte marrë frymë solemniteti. Nëna e saj nuk kishte fjetur gjithë natën. Kishte qëndisur me dorë shaminë e fundit, shenjën e dhimbjes dhe të bekimit. Nusja qëndronte në heshtje, me sytë e ulur, por fytyrën që i ndriste nga emocionet.

Vajzat e lagjes i këndonin në kor, një këngë që ishte lutje dhe lamtumirë: *“Mos qaj nuse, mos derdh lot, se me lule shkon në botë...”*

Kur krushqit mbërritën, i zoti i shtëpisë po qëndronte i heshtur. Të gjithë prisnin fjalën e parë të kryekrushkut. Ai trokiti në derë, pastaj foli me zë të fortë: *“Kemi ardhur për ta marrë vajzën e shtëpisë suaj. Jo për t’jua marrë, por për ta bërë tonën. Me nder e me besë, siç e do zakoni i vendit.”*

Dhe shtëpia u hap. Nusja, e mbuluar me shami të bardhë, doli nga dera mes luleve, lotëve dhe bekimeve. Nëna ia vendosi bukën e kripur në dorë dhe një pikë ujë në ballë, për të mos harruar kurrë prej nga vinte. Kënga *“Krushqit po shkojnë me lule”* ishte një ndër më të njohurat që e shoqëronte këtë procesion. Me vargje që shprehnin njëkohësisht gëzim dhe trishtim, ajo përshkruante bukurinë e nuses, krenarinë e familjes dhe mallin e ndarjes. Kjo këngë ishte një

urë emocionale mes shtëpisë së vajzës dhe asaj të burrit, një kujtesë se martesë ishte edhe një humbje, edhe një fitore.

Rruga e kthimit ishte më e heshtur. Krushqit nuk këndonin më me të njëjtin ritëm. Tani ndjenja e përgjegjësisë ishte më e madhe. Po sillnin në shtëpi një jetë të re, një nder të ri.

Në një burim në mes të rrugës, ndalën sërish. Hodhën pak ujë mbi sytë e nuses. Një i moshuar tha: *"Që sytë e saj të shohin gjithnjë mirë. Dhe zemra e saj të ndiejë mirësi"*.

Kur mbërritën në shtëpinë e dhëndrit, dasmorët shtinë pushkë në ajër dhe nisi festa e madhe. Por askush nuk harronte se rruga e bërë kishte qenë shumë më shumë se një udhëtim. Kishte qenë një proces shpirtëror e një rit kalimi plot rregulla e emocione.

Periudha kohore: Shekujt e Mesjetës deri në shek. XX

Përmbledhje historike e periudhës

Martesa në shoqërinë tradicionale shqiptare përbënte shumë më tepër se bashkimin e dy individëve, pasi ajo ishte një akt që përcaktonte marrëdhëniet mes familjeve, fiseve dhe komuniteteve. Si e tillë, martesë ishte ngushtësisht e lidhur me konceptet e nderit, aleancës dhe statusit shoqëror. Në veçanti, ceremonia e marrjes së nuses dhe "udha e krushqve" reflektonin kalimin simbolik të vajzës nga shtëpia e saj e lindjes drejt shtëpisë së burrit. Kjo rrugë dhe ritualet e saj shoqëruese ishin thellësisht të kodifikuara dhe të ngarkuara me simbolikë të rëndësishme kulturore e shpirtërore.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në shoqëritë shqiptare, sidomos në zonat rurale dhe malore, martesat realizoheshin kryesisht në formën e marrëveshjeve midis familjeve. Këto marrëveshje ndërmjetësoheshin nga "krushqit", burra me autoritet, që përfaqësonin interesat e familjes së dhëndrit. Në këtë mënyrë, udhëtimi për të marrë nusen u kthye në një procesion solemn dhe të shenjtë, duke u shoqëruar me rite të ndryshme simbolike: këngë, valle, dolli, shkrepje armësh në ajër dhe ndalesa të posaçme rituale në vende të caktuara.

Mesazhi

"Udha e krushqve" nuk ishte vetëm një udhëtim për të marrë nusen. Ishte një akt i ritit të kalimit, një shfaqje e thellë e vlerave si nderi, bashkimi, solemniteti dhe kujtesa kolektive. Në këtë rrugë, burra dhe gra, të rinj dhe të moshuar, sillnin me vete gjithë historinë e një populli që e nderon jetën përmes riteve. Edhe pse në ditët tona karvanët i kanë lënë vend makinave me boritë e dasmës, thelbi i këtij udhëtimi të shenjtë nuk është zhdukur. Kur qytetet shqiptare përshkohen nga kolonat festive, është jehona e asaj rruge që përsëritet: një kujtesë që martesë nuk është vetëm një akt civil, por një bashkim që mbështetet në vlera, rite dhe ndjeshmëri.

Bibliografia

- Dibra, Miasser. *Ceremoniali i dasmës në qytetin e Shkodrës*, Tiranë: Akademia e Shkencave, 2004.

- Velianj, Albana. *Rite e simbole në dasmën tradicionale shqiptare*, Tiranë: Akademia e Shkencave, 2017.
- Gjeçovi, Shtjefën. *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Shtëpia Botuese Kuvendi, 2001

Varri i Ashikut, kujtim i përjetshëm i një dashurie të ndaluar

Bedriu ishte një djalë i varfër nga Kruja, që falë trimërisë kishte arritur të gradohej në ushtrinë osmane. Pas shkurtimit të ushtrisë, Bedriu kthehet në vendlindje, me një pasiguri për të ardhmen e tij. Në një pyll afër një burimi, atë e viziton një zanë e bukur, e cila e paralajmëron me një këshillë enigmatike: "***Ruaju nga trau dhe kaprolli. Tek burimi je më i sigurt se te rrënja.***"

Pak më vonë, Bedriu pushonte pranë një burimi kur një grup kalorësish, që shoqëronin një vajzë të re me vello, ndalojnë aty. Një shikim i vetëm mes tij dhe vajzës, që më vonë e mëson se quhet Drenushë (që simbolizon "kaprollin"), mjafton për t'i ndezur zemrën me një dashuri të menjëhershme dhe të pakthyeshme.

Kalorësit vazhdojnë rrugën drejt Tiranës, dhe Bedriu, i vendosur të ndjekë zemrën, shkon pas tyre. Në Tiranë ai përfshihet pa dashur në një konflikt lokal dhe pothuajse humb jetën, por shpëton falë pozitës së tij ushtarake. Në shtëpinë ku gjeti strehë, zbulon se vajza e ëndrrave të tij ishte fejuar me qeveritarin e Tiranës kundër vullnetit të saj.

Kur Drenusha e sheh Bedriun përsëri, ajo i shpreh dashurinë dhe e lut që ta shpëtojë nga ajo martesë e padëshiruar. Me guxim dhe duke injoruar të gjitha rreziqet, Bedriu merr një kalë dhe shpëton vajzën nga burgu i saj duke thyer dritaren prej druri ("trau"). Në një ikje dramatike, ata largohen bashkë mbi kalin e bardhë. Kur arratisja zbulohet, qeveritari i Tiranës dhe njerëzit e tij i ndjekin për t'i ndaluar. Në vend që të shkojë drejt Krujës (që simbolizon "burimin"), Bedriu zgjedh rrugën drejt Ndroqit ("rrënjës"), duke harruar këshillën e zanës. Gjatë rrugës ai kupton se çfarë do të thoshte këshilla e saj, por tashmë është vonë. Në Ndroq ndjekësit i arrijnë dhe Bedriu, duke parë se nuk ka shpëtim, vendos që më mirë është vdekja sesa turpi apo dorëzimi i vajzës në duart e armikut. Ai e vret vajzën dhe pastaj edhe veten. Fryma e fundit e tyre shkon në lutjen që të varrosen bashkë.

Periodha kohore : Shekujt XVIII–XIX, me rrënjë më të hershme në traditën popullore të Shqipërisë së Mesme.

Përmbledhje historike e periudhës

Në një shoqëri patriarkale shqiptare, ku besa, nderi dhe familja ishin themelet mbi të cilat ndërtohej gjithçka, dashuria e lirë ishte një ëndërr e largët dhe shpesh e rrezikshme. Martesat organizoheshin për të ruajtur interesat fisnore dhe ekonomike, duke i bërë ndjenjat personale

të papërfillshme përpara vullnetit të familjes. Konfliktet e vazhdueshme mes qyteteve dhe fiseve ndikonin edhe më shumë në pamundësinë e realizimit të një dashurie të pastër dhe të singertë.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Përplasjet mes qyteteve dhe detyrimet familjare bënë që dashuria e vërtetë të shndërrohej në një akt rebelimi. Këto kushte bënë që ndjenja të tilla të ruheshin në legjenda, të cilat populli i përcolli brez pas brezi, duke i kthyer në simbole të sakrificës dhe idealit.

Johan Georg von Hahn dhe Spiridon Gopçeviç, në shekullin XIX, dokumentuan ekzistencën e "Varrit të Ashikut" në Ndroq. Robert Elsie në versionin e tij të përpunuar e sjell historinë e dy të rinjve si një shembull të idealit romantik të epokës. Një version tjetër popullor flet për një çift të rinjsh, Bukurien dhe Faqebardhin, që nuk mundën të bashkoheshin për shkak të statusit social dhe traditës, dhe që u varrosën së bashku në vendin që sot njihet si "Varri i Ashikut".

Mesazhi

"Varri i Ashikut" është një monument simbolik për dashurinë që e sfidon çdo pengesë. Është një kujtim i përjetshëm që flet për fuqinë dhe tragjedinë e dashurisë së pastër, duke treguar se kjo ndjenjë mund të mposhtë edhe vdekjen.

Ky vend është një dëshmi e rëndësishme kulturore, një simbol që na kujton se dashuria e vërtetë, edhe pse shpesh sfidon normat sociale, vazhdon të jetojë në legjendat dhe kujtesën e një populli. Duke e ruajtur dhe valorizuar këtë histori, ne ruajmë edhe mesazhin e fuqishëm që ajo mbart për shoqërinë e sotme.

Bibliografia

- Elsie, Robert. *Albanian Folktales and Legends*. I.B. Tauris, 2001.
- Gopcevic, Spiridion. *Oberalbanien und seine Liga*. Leipzig, 1881.
- Frashëri, Kristo. *Historia e Tiranës*. Tiranë: Toena, 2002.
- www.elsie.

“Zëri që rri varur në gur”, Legjenda e Vashës në Kanionin e Holtës

Kur hyn në zemër të kanionit të Holtës, aty ku uji rrjedh përmes shkëmbinjve me një murmurimë të qetë e të përhumur, banorët vendas të thonë se nuk është vetëm natyra që flet, por edhe një zë vajze që s’ka gjetur prehje. E quajnë “zëri i vashës”, dhe legjenda që fshihet pas tij është aq e vjetër, sa vetë rrjedha e lumit.

Thuhet se dikur, në një fshat mbi kanion, jetonte një vashë me bukuri të rrallë, me flokë të gjatë si nata dhe sy që pasqyronin dritën e malit. Ishte rritur me dashuri, por edhe me rregulla të forta, siç ishte zakoni në kohët e hershme. Zemra e saj i përkiste një bariu të ri, të varfër por me shpirt fisnik, që jetonte në një kasolle përtej bregut të lumit dhe që çdo mbrëmje i binte fyellit për ta përshëndetur nga larg.

Dashuria e tyre ishte fshehtësi e njohur për të gjithë, përveç një njeriu: babait të saj, që kishte bërë një marrëveshje martesore me një bej të moshuar nga Elbasani, njeri i pushtetshëm dhe i pasur, që kërkonte një grua të re për të rilindur emrin e tij.

Kur lajmi i martesës së detyruar u dha, bariu u largua nga fshati natën, pa lënë gjurmë. E dëshpëruar, vasha kërkoi të mund të takohej edhe një herë me lumin, *“për t’i larë sytë dhe për të folur me natyrën që kishte qenë dëshmitare e dashurisë së saj”*.

U vesh me rrobat e nusërisë, me jelekun e bardhë të qëndisur me fije ari dhe shallin mbi flokë, dhe zbriti deri në cep të kanionit. Atje, në një pikë të lartë ku shkëmbi qëndron si i varur mbi thellësi, ajo ngriti duart drejt qiellit dhe lëshoi një klithmë që, sipas gojëdhënës, nuk është shuar kurrë. Më pas, u hodh. Uji përthithi trupin e saj dhe heshti.

Njerëzit që shkuan ta kërkonin nuk gjetën as trup, as rroba, vetëm një shall të bardhë të kapur në degët e një shelgu buzë lumit.

Prej asaj dite, kanioni u quajt “i vajit”, ndërsa një pikë e lartë e tij, ku u hodh vajza, njihet sot si Shkëmbi i Vashës. Plakat e vjetra tregojnë se herë pas here, kur era bie nga veriu dhe dielli fundoset, dëgjohet një vaj i lehtë nëpër ujë, si pëshpërimë që nuk vjen nga gjallët.

Sot, vizitorët që ecin nëpër kanionin e Holtës, përveç bukurive natyrore, preken edhe nga ky rrëfim që jeton në gurë, në ujë, dhe në zërat e banorëve që vazhdojnë ta tregojnë me një përlule të thellë dhe një ndjenjë përkujtimi.

Periodha kohore: Shekulli XVIII-XIX

Përmbledhje historike e periudhës

Shekulli XIX shënon një periudhë trazirash dhe ndërrimesh të mëdha në shoqërinë shqiptare nën Perandorinë Osmane. Përplasjet midis rendit të vjetër patriarkal dhe aspiratave individuale për liri personale u pasqyruan në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Zona e Gramshit, si pjesë e malësive të Shqipërisë së Mesme, ruante struktura të forta patriarkale ku feja, zakoni dhe nderi përcaktonin vendimet kryesore të jetës. Martesat e rregulluara ishin norma dhe figura e gruas ishte e lidhur me konceptin e nderit të familjes. Në këtë kontekst, gojëdhëna e Vashës së Holtës mishëron një qëndrim të jashtëzakonshëm ndaj rregullave të imponuara nga tradita, dhe paraqet një zë të rrallë rebelimi të brendshëm që shpërfaqet përmes tragjedisë individuale.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes

Në një klimë shoqërore ku martesat bëheshin pa vullnetin e vajzës dhe dashuria e lirë shihej si shkelje e rëndë e rendit moral, tragjedi si ajo e Vashës së Holtës lindën si reagime të rralla, por të fuqishme. Kanioni i Holtës në Gramsh, një mrekulli natyrore i formuar nga erozioni i lumit të Holtës që zbrit nga malet e Poroçanit, shërbeu si sfond dhe si simbol i rrjedhës së ndjenjës kundër prangave sociale. Kanioni me brigje të thepisura, shkurre të dendura dhe një qetësi që i flet njeriut me gjuhën e natyrës, nuk është vetëm sfond i një legjende, por një pjesëmarrës aktiv në ngjarje: një teatër ku ndjenjat e njeriut ndeshen me peshën e traditës. Përballë martesës së imponuar me një bej plak – një përfaqësues i pushtetit, pasurisë dhe statusit – një vajzë e re zgjodhi të mos i nënshtrohej urdhrit, por të përjetësohej në rrëfim, duke e kthyer kanionin në varr dhe në altarin e saj. Në këtë përplasje të dhimbshme midis dashurisë dhe detyrimit, midis shpirtit të lirë dhe shoqërisë që lidhte lirinë me mëkatën, natyra e egër dhe e paprekur e kanionit nuk ishte thjesht sfond, por pasqyrë e trazimit të brendshëm, dhe strehë e aktit të fundit të rezistencës së heshtur.

Mesazhi

Sot, legjenda e Vashës në Kanionin e Holtës përfaqëson jo vetëm një trashëgimi të vyer shpirtërore, por edhe një figurë arketipale të lirisë dhe të drejtave të gruas. E vizituar nga turistë dhe studiues, kjo zonë jo vetëm frymëzon për shkak të natyrës, por edhe përmes kujtesës së trashëgimisë që ajo bart. Legjenda mund të shërbejë si pikënisje për dialog kulturor mbi të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe fuqinë e trashëgimisë gojore në formësimin e ndërgjegjes kolektive. Ajo është pjesë e identitetit lokal të Gramshit dhe një thesar për brezat e ardhshëm që kërkojnë të kuptojnë emocionin dhe shpirtin e popullit të tyre.

Bibliografia

- Çabej, Eqrem. “Studime për Folklorin.” Tiranë: Toena, 2002.
- Domi, Mahir. “Gjuha dhe Letërsia Popullore.” Tiranë: Universiteti i Tiranës, 1984.
- Instituti i Kulturës Popullore. “Trashëgimia gojore shqiptare”, Tiranë: 1996.
- Maliqi, Ardian. “*Kanionet e Shqipërisë dhe trashëgimia e padukshme*”, revista *Kultura Popullore*, Nr. 4, 2018.

Kepi i Rodonit, një vend i heshtur që ruan historinë, besimin dhe shpresën

Thuhet se në netë të errëta, kur era fryn nga veriu dhe dallgët godasin shkëmbinjtë, në Kepin e Rodonit ndjen sikur koha është ndalur, e po të përdorësh imagjinatën mund të përfytyrosh ngjarje e personazhe të të gjitha kohërave. Legjenda të hershme rrëfejnë për një dritë të pashpjegueshme që ndizet aty mbi shkëmb, si një udhërrëfyes për ata që humbin rrugën në det. Kjo dritë, që njëherë besohej si bekim i hyjnive të panjohura, më pas u pa si shenjë e mbrojtjes hyjnore dhe e shpresës. Jo rastësisht, në këtë vend u ndërtuan më vonë dy prej monumenteve më të rralla të trashëgimisë shqiptare si Kalaja e Skënderbeut dhe Kisha e Shën Ndout.

Rreth vitit 1451-1452, pas një periudhe lufte e paqeje me Perandorinë Osmane, Skënderbeu zgjodhi këtë vend të vetmuar e pranë kryeqendrës së tij, Krujës, për të ngritur një kështjellë. Kalaja do të shërbente si dalje e sigurt drejt detit pa ndërmjetësinë e Republikës së Venedikut, nëse ushtria do të duhej të tërhiqej apo të lidhej më lehtë me aleatët në perëndim. Marin Barleti thotë se Skënderbeu kishte nisur të ngrinte një qytet aty, të cilin e kishte quajtur “Kjurilë” ose “Chiurilium”. Këtë qytet osmanët e gjetën të pabanuar, ende të pambaruar dhe e shembën nga themelet. Po ashtu Barleti sqaron se Skënderbeu një një rast kishte shkuar në Rodon bashkë me të shoqen për të kaluar një pjesë të verës dhe të vjeshtës me gjueti dhe me dëfrime të tjera të këtij lloji, në një kohë kur çështjet e luftës nuk kërkonin domosdoshmëri prezencën e tij.

Kështjella u ndërtua mbi një truall të fortë, me mure të trasha që zbresin nga kodra drejt bregut, për t’u bërë mburojë ndaj çdo sulmi. Udhëtarët venecianë dhe më pas studiuesit shqiptarë e kanë përshkruar si një vepër të menduar me mençuri ushtarake, por që sot ka mbetur vetëm një pjesë e saj, si gjurmë që sfidon kohën. Muri mbrojtës 100 metra i gjatë përfundonte me të dy skajet në det me nga një kullë të rrumbullakët. Kështjella u rrënuar nga osmanët në vitin 1467 dhe u ndreq nga venedikasit në vitin 1500.

Disa qindra metra larg nga kalaja, në një pozicion të mbrojtur mes dy kodrave, ndodhet Kisha e Shën Ndout. E ndërtuar në mesjetë, ndoshta mbi një vendbanim më të hershëm, kisha u bë qendër pelegrinazhi dhe lutjeje për qindra besimtarë. Për shumë shqiptarë katolikë, dita e Shën Antonit është dita kur ata kthehen aty, për të kërkuar shërim, bekim dhe paqe shpirtërore. Pranë kishës dikur ngrihej një manastir. Nga dokumentet historike haset përmendja e Manastirit të Shën Mërisë, por edhe e Manastirit të Shën Ndout. Kisha rezulton të jetë një nga kuvendet më të hershme franceskase, që nga viti 1599. Murgjit që jetonin aty ishin të njohur për urtësinë dhe për lidhjen e tyre me natyrën. Ata ndihmonin fshatarët, luteshin

për detarët dhe i jepnin vendit një ndjesi të shenjtë. Rrëfime të hershme tregojnë se murgjit ndiznin qirinj në net me stuhi, që drita e tyre të shërbente si udhërrëfyes për ata që lundronin në errësirë, një gjest që ndoshta vijonte një traditë më të vjetër, kur në të njëjtin vend digjej zjarr për të udhëhequr anijet.

Në këtë mënyrë, në një copë toke të vetmuar mbi det, ndërlidhen lufta dhe paqja, dhe shpirtërorja. Aty ku Skënderbeu ndërtoi kështjellën për të mbrojtur tokën, besimtarët ngritën kishën për të mbrojtur shpirtin. Dhe mes këtyre dy monumenteve, fryn ende era që sjell me vete zërat e kohëve të ndryshme.

Periudha kohore që i përket: Nga lashtësia deri në shekullin XX

Përmbledhje historike e periudhës:

Kepi i Rodonit ose siç njihet ndryshe Kepi i Muzhilit të Skënderbeut, i vendosur në bregun e Adriatikut, ka qenë për shekuj me radhë një nyje që ka lidhur natyrën, mbrojtjen dhe besimin. Me formën e tij të zgjatur si gadishull në det dhe tokën e tkurrur prej shekujsh nga era dhe uji, ky kep ka tërhequr vëmendjen e banorëve të çdo epoke, nga detarët e lashtë e deri te luftëtarët dhe murgjit e mesjetës. Sot aty ruhen gjurmët e një kalaje që besohet se u ndërtua nga vetë Skënderbeu sipas Marin Barletit, si dhe rrënojat e Kishës së Shën Ndout, një prej vendeve më të shenjta për pelegrinët katolikë shqiptarë.

Kushtet që sollën lindjen e ngjarjes:

Pozicioni i Kepit të Rodonit është një dhuratë natyrore për këdo që ka dashur të shohë larg në horizont, të mbrohet nga armiku apo të kërkojë strehë për shpirtin. Rrethuar nga deti në tri anë dhe i izoluar nga tokat përreth nga terreni kodrinor e i pyllëzuar, ky gadishull i ngushtë ka qenë gjithmonë vend i mbrojtur dhe i fshehtë, ideal për ndërtime strategjike. Erozioni i detit ka ndryshuar pamjen e tij në kohë, por nuk ka zhdukur dot historitë që ka ruajtur toka e gurët e tij.

Mesazhi

Kepi i Rodonit mishëron vazhdimësinë e historisë shqiptare, nga koha e përpjekjeve për mbrojtje e qëndresë, te kërkimi për qetësi dhe besim. Ai nuk është thjesht një pikë gjeografike, por një vend ku njeriu lidhet me tokën, me detin dhe me diçka që i tejkalon të dyja.

Sot Kepi i Rodonit është një nga vendet më të vizituara në Shqipëri jo vetëm për bukurinë natyrore, por edhe për rëndësinë e tij historike dhe shpirtërore. Ai fton çdo vizitor të ndalet, të vështrojë përtej horizontit dhe të dëgjojë rrëfimin e gurëve, që flasin mbi historinë e vendit që i përket të gjithëve.

Bibliografia:

- Barleti, Marin. Historia e Skënderbeut, përkthim dhe botim nga Instituti i Historisë, Tiranë, 1967.
- Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 1985

Penda prej Argjendi

Argjendarët shqiptarë dhe filigrani: mjeshtëri, identitet, trashëgimi

Shkodra e pranverës së vitit 1881 gumëzhinte nga zhurmat e tregut dhe njerëz të shumtë që lëviznin si rryma detare në rrugicat e ngushta. Punishtet e argjendarëve dukeshin si vatra të ngrohta e të vogla drite. Flakët e furrave, shndritja e fletëve të metalit, fëshfërima e telave të hollë që përdridheshin mbi kallëpe i jepnin një tis magjie këtyre punishteve të mrekullueshme. Në ajër ndjehej një pritje e pazakontë. Një lajm kishte ndezur qytetin. Treqind vajza të Shkodrës kishin vendosur t'i dhuronin princeshës Elena Gjika (Dora d'Istria) një pendë shkrimi të punuar tërësisht në filigran argjendi. Për vajzat, kjo ishte më shumë se dhuratë. Dora d'Istria, shkrimtare, publiciste dhe mbrojtëse e palodhur e çështjes shqiptare dhe e të drejtave të gruas, duhej të merrte një simbol të vlerësimit e mirënjohjes, të shkruar me gjuhën e atdheut.

U thirrën mjeshtrit më të mirë të qytetit. Punishtja e Kolë Prenushit, e njohur për filigranin e njomë si dantella, u kthye në një skenë të përbashkët. Ditë e natë, mjeshtrit tërhiqnin telat e argjendit në hollësi sa fijet e flokut, i përdridhnin në spirale, yje e rozeta. Çdo motiv mbante brenda një urim të fshehtë për princeshën: guxim për fjalën e lirë, dritë për mendjen e lirë, bekim për kombin. Kur penda mori formë, ajo dukej sikur ishte krijuar nga ajri dhe drita: një “dantellë argjendi” që rrezatonte si fjala e shkruar. Trupi i saj i lehtë mbante një strukturë të gërshetuar ku boshllëku i tejdukshëm bëhej pjesë e dizajnit – ashtu si mendimi i lirë që kalon përmes kufijve.

Dita e dhurimit u kthye në festë qytetare. Treqind vajza, të veshura me kostume popullore, e shoqëruan pendën nëpër rrugët e gurta të Shkodrës, duke kënduar këngë mirënjohjeje. Drita e diellit binte mbi argjend si mbi ujë, ndërsa në sytë e të gjithëve ky objekt nuk ishte më thjesht mjet shkrimi, por një letër e gjallë e Shkodrës drejtuar Evropës.

Periodha kohore që i përket Nga Mesjeta e vonë deri në fillim të shek. XX, me kulmin e lulëzimit gjatë shekujve XVIII–XIX dhe vijimësi në shek. XX e deri në ditët tona përmes punishteve artizanale.

Kushtet që sollën lindjen e mjeshtërisë

Zhvillimi i argjendarisë shqiptare dhe shndërrimi i saj në një degë të rëndësishme të ekonomisë, lidhet ngushtë me zgjerimin e tregtisë, qarkullimin e metaleve të çmuara dhe konsolidimin e kulturës urbane që kërkonte objekte të hijshme të punuara me materiale të çmuara e të përdorshme në rite familjare e fetare. Organizimi i kësaj mjeshtërie në esnafë me rregulla të përcaktuara qartë, garantoj formim shumëvjeçar të mjeshtërve, standarde pune dhe cilësi, ndërsa qarkullimi ballkanik dhe mesdhetar i motiveve dhe teknikave u përthith e u rikompozua sipas shijeve vendore. Kështu u krijua një repertor origjinal formash dhe zbukurimesh që i dha argjendarisë shqiptare profil të dallueshëm.

Përmbledhje historike

Argjendaria ka qenë një nga shtyllat e zejeve qytetare shqiptare dhe një shenjë e ndërthurjes së shijes estetike me ekonominë urbane. Që nga Mesjeta e vonë e deri në shekullin XX, qytete si Shkodra, Prizreni, Gjakova, Elbasani dhe Berati u shndërruan në qendra prodhimi të objekteve luksoze në ar dhe argjend, të destinuara si për përdorim të përditshëm, ashtu edhe për ceremoni. Me rritjen e qyteteve dhe rolit të tyre ekonomik e politik dhe me organizimin e esnafëve, punishtet u shtuan dhe u specializuan aq sa në fund të shekullit XVII shumë familje në Shkodër dhe Elbasan jetonin nga kjo mjeshtëri, ndërsa në Prizren regjistrohen rreth dyzet e shtatë punishte të vendosura në qendër të qytetit. Tregjet e mëdha të shekujve XVIII–XIX, si psh bezistani i Shkodrës, pasqyrojnë rolin e këtyre qyteteve si nyje tregtie për mallra të çmuara dhe punime të rafinuara të dorës. Në punishtet e argjendarëve përdoreshin teknika të ndryshme si rrahja e fletës metalike mbi kallëp, derdhja, gdhendja dhe inçizimi, granulimi dhe punimi i telit të hollë. Kulmi estetik dhe shenja dalluese u bë filigrani, një punim “si dantellë” me fije shumë të holla argjendi ose ari, të përdredhura e të bashkuara me saldim të imët me motive të ndërthurura.

Po si punohet filigrani (nga lat. filum “fije” + granum “kokërr”)? Në thelb, mjeshtri tërheq fijen e argjendit deri në diametër mikroskopik, fijen përdridhen në çifte, formohen motive si spirale, rozeta, gjethe, rrjeta romboide, pastaj vendosen mbi një kornizë ose mbi një bazë dhe bashkohen mesaldim të kontrolluar, shpesh duke shtuar “kokrra” të vogla për të theksuar nyjet. Rezultati është një sipërfaqe me dritë-hije të imta, ku ajri bëhet pjesë e kompozicionit, një estetikë e tejdukshme që lidhet bukur me veshjet e bardha të kostumeve të veriut dhe me mëndafshin e ngjyrave të jugut. Ky është edhe shkaku pse filigrani shpesh njihet edhe si “dantella e argjendit”.

Prodhimet e argjendarëve shqiptarë ishin të shumta dhe të larmishme. Për përdorim personal përfshiheshin byzylykë, vëthë, unaza, gjerdanë, varëse me monedha, pafta brezash, qostekë sahati e kunja flokësh a kapelash. Në sferën rituale dhe fetare spikasin kryqet, ikonat e veshura me argjend, kandilet dhe shandanët. Filigrani zbukuroi edhe armët dhe pajimet e kalit, ku argjendi shtonte jo vetëm shkëlqim, por edhe statusin shoqëror.

Roli i argjendarëve në zbukurimet e armëve dhe pajimeve del rregullisht në përshkrimet e traditës në zonat e Shkodrës, Prizrenit dhe Gjakovës. Janë mjaft të njohura zbukurimet e filigranit mbi armët e shqiptarëve, që sot gjendet në shumë muze brenda e jashtë vendit. Në shtëpi kishte filxhanë, tabaka, pasqyra, korniza, dhe detaje mobilimi që zbukuroheshin e merrnin finesë të veçantë nga kjo teknikë. Në kulturën qytetare shqiptare, një send i punuar në filigran komunikonte njëherazi mundësinë ekonomike të familjes dhe shijen estetike, shpesh me motive të trashëguara brenda njësive artizanale.

Kjo mjeshtëri nuk ishte e izoluar veç ndër shqiptarë sepse filigrani ballkanik është pjesë e një tradite më të gjerë mesdhetare e lindore, e dokumentuar që nga antikiteti dhe e popullarizuar gjërisht gjatë shekujve të sundimit osman. Në këtë horizont të gjerë, repertori i motiveve si



rozeta, hardhi, valëzime “arabeske”, yje etj është i krahasueshëm, por shija lokale shqiptare u shpreh në ngjyrimin e kompozimeve dhe në raportet e holla të linjave. Për shembull, tradita prizrenase, me rrjeta tepër të imta, u dallua nga punimet e tjera ballkanike dhe u bë markë identitare e qytetit. Në shekullin XIX, përhapja e filigranit u bë aq e gjerë, sa shumë teknika të tjera të stolisjes u lanë mënjanë dhe filigrani u bë estetika mbizotëruese e zejes së argjendarëve. Kjo nuk ishte vetëm çështje mode pasi punimi i telit të hollë kërkonte përsosmëri teknike dhe artistike duke e ngritur mjeshtërinë e argjendarit në rang arti. Sot plot muze etnografikë apo edhe argjendari na ndihmojnë ta shohim nga afër këtë trashëgimi. Përveç tabakave dhe brezave të punuar me filigran në Berat, koleksionet etnografike në Shkodër, Gjirokastër e Prizren ekspozojnë objekte ku filigrani lidhet me tekstilet, drurin ose gurin, duke dëshmuar bashkëjetesën e zejeve. Këto objekte i japin zë një ekonomie artizanale të ndjeshme ndaj modës, por të trupëzuar në teknika e mjeshtëri të trashëguara prej shekujsh. Më shumë se një teknikë, filigrani është gjuhë vizuale e një shoqërie qytetare që e lidhi të bukurën me etikën e punës dhe me prestigjin social. Si trashëgimi e prekshme, ai ruan kujtesën e punishtes, të punës me dorë, të “ritmit të flakës”; si trashëgimi shpirtërore, ai bart kodet e shijes, të ritualit dhe të vetëpërfytyrimit estetik. Sot, ndërsa turizmi kulturor rrit kërkesën për objekte me prejardhje vendase, filigrani shqiptar ka potencial të jetë markë kulturore: një “dantellë” metali që tregon historinë e qyteteve tona, të tregjeve dhe të mjeshtërive që punuan me sy të mprehtë, dorë të sigurt dhe frymëzim artistik.

Mesazhi

Sot filigrani shqiptar mbetet një trashëgimi e gjallë dhe markë kulturore, ku punishte familjare në Shkodër, Prizren, Gjakovë, Elbasan e Berat vazhdojnë të krijojnë stoli e objekte me teknikat shekullore, ndërsa artistë e rikompozojnë në bizhuteri e art bashkëkohor. Ai shërben si gjuhë përfaqësimi kombëtar, përdoret në dhurata protokollare dhe suvenire turistike, dhe mbrohet përmes muzeve, qendrave artizanale dhe nismave për ta regjistruar si trashëgimi jomateriale në UNESCO. Kështu, filigrani bashkon kujtesën e qyteteve shqiptare me ekonominë krijuese të shekullit XXI, duke mbetur një simbol i shijes estetike, i identitetit kulturor dhe i mjeshtërisë që lidhet me dorën e njeriut.

Bibliografi

- Zija Shkodra, Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1984
- Historia e popullit shqiptar, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botimet Toena, Tiranë 2002

Kostumet popullore shqiptare, mjeshtëri, identitet, kujtesë e gjallë

Në një fshat të thellë të Malësisë së Madhe, pranvera vinte gjithmonë e shoqëruar me këngë dhe erë leshi të freskët. Në prag të çdo dasme, oborret shndrisnin nga zjarre të mëdha dhe nata para dasme quhej “Nata e Xhubletës”. Ashtu si rrëfejnë gojëdhënat kjo nuk ishte vetëm një natë gëzimi, por një rit i lashtë, ku çdo hap kishte domethënie. Në mbrëmje, gratë më të moshuara vendosnin vegjë të zjarrit. Fijet e leshta, të ngjyrosura me lëvore arre e marenë, shkëlqenin nën dritën e flakës. Vajzat e reja, ndër to edhe nuset që do të martoheshin, përthurnin gajtanë të zinj mbi copa të bardha, duke i shoqëruar me këngë të vjetra nusërie. Secili varg ishte si një uratë, një mbrojtje për martesën që do të niste. Thoshin se këngët “e lidhin veshjen me zemrën”.

Në mesnatë, rapsodët merrnin fjalën. Ata këndonin për Nusen e Malit, heroinën e legjendës që, sipas besimit, kishte sjellë në këto anë modelin e parë të xhubletës. Thuhej se ajo e kishte veshur këtë kostum për të ruajtur forcën e malit dhe për të bekuar çdo shtëpi ku këndohej emri i saj. Sa herë tingëllonte kënga, gajtanët në veshje sikur lëviznin lehtë, duke mbartur fuqinë e asaj figure mitike.

Kur nata thyhej, dritat e para të agimit gjenin nuset të veshura me xhubletën që ato vetë e kishin punuar. Veshja nuk ishte vetëm rrobë: çdo vijë, monedhë apo shkallëzim mbante një kujtim, një lutje dhe një shenjë identiteti. Siç e përshkruan edhe UNESCO në dosjen e vitit 2022, xhubleta bart kode simbolike dhe shoqërohet me këngë e rrëfime që ruajnë identitetin e komunitetit. Edhe sot ky ritual vazhdon në shumë fshatra të Malësisë. Punishtet hapen, këngët e vjetra ringjallen, dhe brezi i ri mëson të lexojë shenjat e xhubletës si gjuhë të gjallë. “Sa kohë që këndohet kënga e Nuses së Malit, xhubleta nuk vdes,” thonë të moshuarat, duke e kthyer “Natën e Xhubletës” në një kujtim të përhershëm që bashkon artin, dashurinë dhe identitetin.

Periudha kohore që i përket

Nga Mesjeta e vonë deri në mesin e shekullit XX, me shkëlqimin gjatë shekujve XVIII–XIX në qendrat urbane dhe në trevat me tradita të forta të punimit të tekstileve. Ka vijimësi të dukshme edhe në shekullin XXI përmes muzeve, punishteve artizanale dhe skenës kulturore

në vend e jashtë tij.

Përmbledhje historike

Krahas punimit të tekstileve prej leshi, mëndafshi e pambuku, një vend të veçantë zuri mjeshtëria e qepjes së veshjeve popullore dhe zbukurimi i tyre me fije ari a argjendi, me gajtanë e shirita dekorativë. Përkrah këngës, valleve dhe muzikës, veshja u bë një prej shfaqjeve më të dukshme të artit popullor që e dallonte botën shqiptare në hapësirën ballkanike. Që nga ikonat dhe afresket mesjetare, ku shfaqen veshjet e shtresave të larta, e deri te periudha osmane, kur në qytete u përhapën kadifet e kushtueshme dhe fijet e arta, veshjet u formësuan si një mozaik krahinor ku çdo element kishte kuptim. Udhëtarë dhe intelektualë evropianë nuk mbetën indiferentë. Lord Byron dhe shoku i tij John Cam Hobhouse (Lord Broughton) shkruan me admirim për kostumet shqiptare. Portreti i Byronit i veshur me kostum shqiptar u bë ikonë e shekullit XIX për të gjithë Europën e lëvizjen romantike. Në fillim të shekullit XX, Faik Konica zgjodhi po të njëjtën gjuhë vizuale të përfaqësimit pasi u fotografua me kostumin kombëtar të jugut në ambiente zyrtare dhe në një ceremoni, duke e shndërruar veshjen në diplomaci të heshtur por me mjaft ndikim.

Mjeshtëria e veshjeve popullore u ndikua nga rritja e qyteteve, zgjerimi i tregjeve dhe qarkullimi i lëndëve të para. Esnafet e terzinjve dhe qëndistarëve vendosën rregulla të forta për marrjen e mjeshtërisë, një hierarki (çirak–kallf–mjeshtër) dhe standarde të larta cilësie. Në fshatra puna me vegjë e trashëguar nga nëna te bija ruajti vazhdimësinë e teknikave shtëpiake. Ndikimet mesdhetare sollën motive të reja si arabeska e rozetat, por ato u përthithën dhe u rimenduan me shijen vendore duke krijuar gajtanë të zinj mbi të bardhë, fijet e arta mbi kadife të kuqe, kontraste të forta që lexohen edhe sot në koleksionet muzeale.

Ngjarjet shoqërore si fejesa, martesja, festa kalendarike e ritet fetare, e ngritën veshjen në kapital simbolik dhe ekonomik. Një kostum i bukur nuk ishte thjesht “veshje e re”, por ishte kartëvizitë e shtëpisë, dëshmi e punës dhe e mundësive ekonomike. Procesi i krijimit të veshjeve popullore nis me materialin. Leshi punohet e thuret në vegjë për tirq, xhubletë ose funde. Pambuku dhe mëndafshi përdoren për këmisha, përparëse e qëndisma. Ngjyrat përftohen me bojëra natyrale si lëvore arre, marenë e indigó që japin jetë e qëndrueshmëri. Terzinjtë vizatojnë e presin sipas masës e tipologjisë krahinore ndërsa qëndistarët e zbukurojnë sipërfaqen me fije ari e argjendi, kordele mëndafshi dhe gajtanë të ngushtë që kthjellojnë arabeska, rozetë, gërsheta, shirita paralelë. Vendosja e monedhave, e kopsave prej argjendi dhe i telit të hollë (deri edhe filigrani në detaje) krijon relief, ritëm e dritë.

Në fund, hekurosja dhe fiksimi i elementeve e bëjnë veshjen të qëndrojnë mbi trup me një elegancë që nuk është rastësi, por orë e orë të tëra pune të padukshme. Në veri, tirqit e zinj me gajtanë të dendur dhe xhubleta e grave përbëjnë një alfabet të tërë shenjash.

Xhubleta me formën e saj “zile”, me shkallëzimet, rripat shumëngjyrësh dhe metalet dekorative, është një prej veshjeve më të vjetra të hapësirës shqiptare. Në vitin 2022 ajo u regjistrua në Listën Përfaqësuese të Trashëgimisë Jomateriale të UNESCO-s, duke i dhënë një status ndërkombëtar dijes së brishtë të punimit të saj dhe duke mobilizuar komunitetet malësore për ta mbajtur gjallë.

Në qendër dhe në jug, fustanella është emblemë mashkullore që shoqërohet me xhamadan të qëndisur, brez të gjerë dhe këpucë me xhufka. Qendrat urbane si Shkodra, Berati, Elbasani, Korça e Gjirokastra krijuan “shkolla” të qepjes e qëndisjes. Fotot e shumta të familjes Marubi, bashkë me koleksionet etnografike, dokumentojnë qartë hartën vizuale të stileve që lëviz nga eleganca e jelekut qytetar te solemniteti i kostumit të dasmës. Dekori që përdorej për zbukurimin e veshjeve nuk ishte vetëm estetik pasi ai komunikonte moshën, gjendjen civile,



pozitën ekonomike dhe përkatësinë krahinore. Për një nuse, kostumi i dasmës ishte shfaqja e kulmit të mjeshtërisë dhe e krenarisë familjare. Kostumi ruhej në arkë, riparohej e riqepej dhe shpesh i kalonte brezave si relike e gjallë. Stolisja e rrobave dhe e armëve me filigran ishte gjithashtu një kërkesë e kohës. Terzinjtë bashkëpunonin rëndom me argjendarë sepse paftat e brezave, qostekët e sahatit, kopsat e argjendta dhe aplikimet me tel të hollë i jepnin kostumit një shkëlqim tjetër.

Mesazhi

Sot kostumi popullor është i pranishëm dhe i kërkuar. Muzeu Etnografik i Krujës, ai i Kavajës dhe i Elbasanit ekspozojnë veshje origjinale, shpjegojnë teknikat e punimit dhe dokumentojnë variantet krahinore. Këto institucione janë klasa të hapura ku fëmijët e të rriturit mund të “lexojnë” shenjat e së shkuarës. Në shumë qytete, artizanë të shumtë vazhdojnë të qepin e të qëndisin me porosi. Pazari i Krujës shquhet për punishtet ku ende sot prodhohen veshje, qeleshe e papuçe sipas motiveve dhe teknikave të vjetra. Me një qasje bashkëkohore, mjaft stilistë dhe trupa skenike përdorin elemente tradicionale të veshjeve në kohëra të reja. Kjo është një dëshmi se kjo trashëgimi nuk është muze e mbyllur, por një praktikë që jeton e përshtatet me kohën.

Bibliografi

- Andromaqi Gjergji Veshjet shqiptare në shekuj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2019.
- Zija Shkodra, Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë.